



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI" KORÇË
FAKULTETI I EDUKIMIT DHE FILOLOGJISË



DRITËRO AGOLLI

"DOCTOR HONORIS CAUSA"

(Përmbledhja e materialeve të konferencës kushtuar shkrimtarit dhe akademikut Dritëro Agolli me rastin e dhënies së titullit "Doctor Honoris Causa" nga Universiteti "Fan S. Noli" i Korçës në 80-vjetorin e lindjes).

Korçë, tetor 2011

DRITËRO AGOLLI

“DOCTOR HONORIS CAUSA”

(Përmbledhja e materialeve të konferencës kushtuar shkrimtarit dhe akademikut Dritëro Agolli me rastin e dhënies së titullit “Doctor Honoris Causa” nga Universiteti “Fan S. Noli” i Korçës në 80-vjetorin e lindjes).

BOTIM I FAKULTETIT TË EDUKIMIT DHE FILOLOGJISË

Miraturar për botim me vendim të Këshillit të Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë

Redaksia e botimit: prof. dr. Ali Jashari, dr. Anyla Maxhe

Përgatitja kompjuterike: EDIOLA NASE, BENISA KOKONOZI

ISBN:

Botime “FEF”, SCRIPTA MANENT, 1

Korçë, shtator 2012

PËRMBAJTJA

- **FJALA PËRSHËNDETËSE ME RASTIN E DHËNIES SË TITULLIT “DOKTOR HONORIS CAUSA” SHKRIMTARIT DRITËRO AGOLLI NGA PROF. GJERGJI MERO- REKTOR I UNIVERSITETIT “FAN S. NOLI” KORÇË**
- **VLERËSIMI NGA AKAD. FLORESHA DADO**
- **VLERËSIMI NGA PROF. DR. ALI JASHARI**
- **FJALA E SHKRIMTARIT DRITËRO AGOLLI**
- **KONFERENCA SHKENCORE KUSHTUAR JETËS DHE VEPRËS SË DRITËRO AGOLLIT NË 80-VJETORIN E LINDJES**
 1. **Akad. Jani Thomai** - Aromë popullore në ligjërimin poetik të Dritëro Agollit
 2. **Prof. dr. Gjovalin Shkurtaç** - “Balta e arave” si shtegu i prurjeve gjuhëpasuruese dhe gjuhëdashëse të Dritëro Agollit
 3. **Prof. dr. Ymer Çiraku** - Legjendë e gjallë e fjalës shqipe
 4. **Dr. Elona (Biba) Çeçe** -"Kompetenca komunikative" e poetit Dritëro Agolli në përmbledhjen me poezi "Lypësi i kohës"
 5. **Dr. Jonela Spaho** - Dimensioni i dhimbjes dhe i humanizmit në udhëtimin poetik të poetit ndër vite
 6. **Prof.as.dr. Rahim Ombashi** - Famë-Agolli më shumë nga lexuesit se nga kritika
 7. **Prof. as. dr. Dhimitri Bello, dr. Raqi Bello** -Vepra e Dritëro Agollit në Bullgari
 8. **Prof. as. dr. Kastriot Gjika** - Satira në veprën letrare të Dritëro Agollit
 9. **Dr. Eldon Gjikaçaj** - Veçoritë e veprës së Dritëro Agollit në sistemin letrar shqiptar
 10. **Prof. as. dr. Adem Jakllari** - Mjeshtër i madh i narracionit artistik
 11. **Msc. Ilir Shyta** - "Zyra", qendër e burokracisë botërore (qasje me romanin "Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo")
 12. **Dr. Anyla Maxhe** - Ngjyrimet lokale përmes antroponimisë në prozën e Dritëro Agollit
 13. **Dr. Dion Tushi** - Tipari humanist i prozës së Agollit si veçanti dhe vijueshmëri origjinale e krijimtarisë së tij
 14. **Msc. Neli Naço**- Përsiatje mbi vëllimin "Pelegri i vonuar"
 15. **Msc. Andon Andoni** -Balta e poezisë së Dritëroit, e ëmbël si mjalta e Naimit
- **INTERVISTË E SHKRIMTARIT DRITËRO AGOLLI DHËNË TELEVISIONIT “SOT7”**

- **VENDIMI I SENATIT AKADEMIK**
- **VENDIMI I KOMISIONIT TE VLERËSIMIT TË TITUJVE**
- **ALBUM ME FOTOGRAFI NGA CEREMONIA**

**FJALA PËRSHËNDETËSE ME RASTIN E DHËNIES SË TITULLIT “DOKTOR
HONORIS CAUSA” SHKRIMTARIT DRITËRO AGOLLI NGA PROF. GJERGJI
MERO- REKTOR I UNIVERSITETIT “FAN S. NOLI” KORÇË**

I nderuar miku ynë Dritëro Agolli!

E nderuar zonja Nora Malaj, zv/Ministre e Arsimit dhe Shkencës!

Të nderuar personalitete të pushtetit vendor!

Të nderuar kolegë, pedagogë, studentë e të ftuar!

Të nderuar miq të Dritëroit, që na nderoni sot në këtë veprimtari!

Të nderuar pjesëmarrës!

Më 13 tetor të këtij viti akademiku dhe shkrimtari Dritëro Agolli mbushi 80 vjet. Siç dihet prej të gjithëve, Dritëro Agolli është një personalitet i shquar në fushën e letrave, duke u spikatur me dhjetra vepra letrare dhe publicistike që ka botuar në gjini e lloje të ndryshme, duke krijuar një shkollë të tërë letrare dhe estetike në Shqipëri. Dritëro Agolli dhe vepra e tij ka qenë dhe mbetet pjesë e pandarë e procesit mësimor në shkollat dhe universitetet shqiptare, sepse krijimtaria e tij letrare, që prej fillimeve të saj deri në ditët e sotme, është bërë pjesë shpirtërore e gjithë lexuesve, nxënësve dhe studentëve të specialiteteve të ndryshme.

Krijimtaria e tij ka përcjellë në shkollat tona, të të gjitha niveleve, ide dhe parime morale që kanë të bëjnë me formimin shpirtëror të brezit të ri, si bazë për ndërtimin e një shoqërie të shëndetshme.

Vepra e tij është model për përdorimin e fjalës shqipe. Studentët dhe nxënësit kanë gjetur në prozën dhe poezinë e Dritëro Agollit dashurinë për gjuhën shqipe, intuitën e përdorimit të saj në mundësitë e brendshme të pafund, si dhe përdorimin mjeshhtëror të leksikut të hapësirave mbarëshqiptare. Ai ka dhënë një ndihmesë të vyer për gjuhën tonë amtare, duke nxjerrë në pah dhe duke i bërë të gjithëpërdorshme shumë e shumë fjalë e shprehje që më parë nuk njiheshin ose njiheshin fare pak në ligjërimin e shqipes, çka do të shpaloset përmes kumtesave në simpoziumin shkencor kushtuar veprës së DritëroAgollit në seancën e dytë të kësaj veprimtarie, ku do të

kumtojnë pedagogë e studiues nga Universiteti i Korçës, Universiteti i Tiranës dhe institucione të tjera.

Te Dritëro Agolli ne gjejmë filozofinë e lidhjes së gjithë veprës letare me misionin dhe figurën e tij në zhvillimet ideore dhe sociale të shoqërisë sonë.

Figura e këtij personaliteti ka lidhje të ngushta, të tërthorta apo edhe të drejtpërdrejta me gjithë brezat që janë arsimuar dhe po arsimohen në Universitetin “Fan S. Noli” të Korçës, si dhe në mbarë shkollat dhe universitetet shqiptare.

Universiteti i Korçës sot po i jep Dritëro Agollit titullin “Doktor Honoris Causa”.

Mendoj se vlerësimi me këtë çmim është një detyrim moral i universiteteve tona, që ka të bëjë me filozofinë e lidhjes së veprës së këtij personaliteti me misionin dhe figurën e tij në zhvillimet ideore e sociale të shoqërisë sonë. Një mendje e hapur, e pakompromentuar, një kurajo qytetare që pozicionohet ndershëm në problematikën shqiptare, jashtë komplekseve të përshtatjes mbi interesin të ngushtë personal, besnik i ndershëm i ideve që e udhëheqin në jetë, mendimtar i urtë, që synon të shkojë përtej situatave konfliktuale, që synon të ndikojë me largpamësinë zhvillimet e vendit të tij etj. Dhe të gjitha këto qëndrime, nuk kanë asgjë të përbashkët me bujën mediatike, me kompleksin e të dukurit sa më interesant dhe dogmatik. Dritëro Agolli ka sjellë një model të ri, thellësisht origjinal, të papërsëritshëm, të komunikimit mediatik dhe bisedor: thjeshtësinë, shprehjen e drejtpërdrejtë, humorin e vetvetishëm, ndaj të cilit askush nuk mund të mbetet indiferent. Kjo mënyrë e drejtpërdrejtë, që ka në themel besnikërinë ndaj një morali të ndershëm njerëzor, është modeli më i suksesshëm për formimin e brezave të rinj, që sidomos në realitetet e sotme, duhet të gjejnë brenda vetes vlerat e vërteta, parimet e moralshme, mbi bazën e të cilave duhet të ndërtojnë marrëdhëniet e gjata me shoqërinë shqiptare, por në radhë të parë edhe me vetveten.

Duke vlerësuar shumë shkurt personalitetin e Dritëro Agollit, mendoj se dhënia e titullit “Doktor Honoris Causa” nga Universiteti i Korçës është, pa diskutim, një nderim edhe për Universitetin tonë, i cili ka dëshmuar faktin se figura e këtij personaliteti ka lidhje të ngushta, të tërthorta, por edhe të drejtpërdrejta me brezin e ri që arsimohet në këtë Universitet, por dhe në gjithë shkollat dhe universitetet shqiptare. Ky është një nder që sigurisht i takon personalitetit të shquar të kulturës sonë, por që, njëkohësisht dëshmon se sa e rëndësishme është edhe kuptimi i vlerave dhe nderimi i këtyre figurave nga shoqëria shqiptare.

Dritëro Agolli është një mik i madh i Korçës dhe i gjithë trevave të saj, duke qenë i pranishëm në shumë veprimtari që janë organizuar në Qarkun e Korçës, por edhe mik i shumë familjeve korçare, devollite, kolonjare, pogradecare edhe më tej, ai prej kohësh ka shfaqur dëshirën të jetë pranë studentëve edhe pedagogëve të Universitetit “Fan S. Noli” të Korçës, dëshirë që po realizohet pikërisht në këtë përvjetor të ditëlindjes së tij.

Në përfundim në emër të Rektoratit, Senatit, stafit të pedagogëve dhe studentëve të Universitetit të Korçës, dua t’i përcjell shkrimtarit Dritëro Agolli urimin tonë të përbashkët:

Gëzuar ditëlindjen Dritëro, jetë të gjatë dhe të lumtur, të mbushur me sa më shumë ngjarje të tilla të bukura. Ta gëzosh titullin “Doktor Honoris Causa” dhe marrç sa më shumë të tillë!

Dua të falenderoj në mënyrë të veçantë të gjithë miqtë, kolegët dhe shokët e Dritëroit, por edhe të Universitetit tonë që na nderojnë me prezencën e tyre në këtë eveniment mjaft të rëndësishëm.

Ju faleminderit të gjithëve.

Akad. FLORESHA DADO

VLERËSIM MBI PERSONALITETIN E DRITËRO AGOLLIT

Për dhënien e titullit “Doktor Honoris Causa” nga Universiteti i Korçës

Ka personalitete të kulturës sonë që, me kompleksitetin e veprës së tyre dhe, duke qenë pjesë e pandarë e jetës sonë shpirtërore, e bëjnë të vështirë ripërsëritjen e atyre vlerësimeve që ata kanë marrë nga lexuesi i tyre, nga qytetari i thjeshtë, nga çdo shqiptar, që ndjek prej vitesh vlerat dhe figurat morale të këtyre personave. Vështirësia, në rastin e vlerësimit kompleks të shkrimtarit, intelektualit të shquar Dritëro Agolli, vjen prej faktit se çdo gjë që të thuhet sot duket se është gjithnjë e njohur, se kudo dhe kurdo ne kemi ndjekur një figurë me vlera të spikatura, si në fushën e letërsisë, ashtu dhe në jetën morale e sociale. Është e natyrshme që nderimi i këtij personaliteti me çmimin “Doktor Honoris Causa” të afirmohet nga një prej universiteteve tona, sepse, nëse flitet për vlera të sferës njerëzore e kulturore, është në radhë të parë sistemi universitar ai që lidhet në mënyrë më të drejtpërdrejtë me rolin dhe vendin që u takon figurave të tilla. Është pikërisht universiteti shqiptar që ndërton drejtpërdrejt, por edhe tërthorazi, një sistem vlerash origjinale, si të sferës letrare, ashtu dhe të sferës moral-shoqërore.

Duke u ndalur shkurt në arsytet pse dhënia e titullit të lartë është një vlerësim absolutisht i merituar, do të vija në dukje disa argumente themelore:

Së pari, Dritëro Agolli është ndër ata shkrimtarë që ka qenë edhe mbetet pjesë e pandarë e gjithë procesit mësimor të shkollave, por edhe të universiteteve shqiptare. Krijimtaria e tij letrare, që prej fillimeve të saj e deri në ditët e sotme, është bërë pjesë shpirtërore e gjithë lexuesve, studentëve të drejtimeve dhe specialiteteve të ndryshme. Në aspektin e formimit humanitar vepra e Dritëro Agollit është në grupin e shkrimtarëve më të preferuar. Krijimtaria e tij letrare ka përcjellë në shkollat tona, të të gjitha niveleve, ide dhe parime morale, që kanë të bëjnë me formimin shpirtëror të brezit të ri, me vlerësimin e aspekteve të tilla formuese, që përbëjnë bazën e ndërtimit të një shoqërie të shëndetshme, që ka parime në konceptimin e jetës së individit, dhe të gjithë shoqërisë. Proza dhe sidomos poezia e Dritëro Agollit ka reflektuar vazhdimisht ndjesi të fuqishme të dashurisë për vendin, për të ndershmen, për raporte njerëzore midis njerëzve, për sinqeritetin dhe ndershmërinë e komunikimit. Vepra e Agollit, duke qenë në grupin e autorëve më të shquar të letërsisë shqiptare, përcjell gjithnjë mesazhe njerëzore, parime të një morali dhe marrëdhënieje të qytetëruar. Përmes një komunikimi origjinal, herë përmes humorit, herë përmes

dëshpërimin njerëzor, herë përmes afirmimit të idealeve sociale, shkrimtari ynë ndërton një marrëdhënie krejt të veçantë me shqiptarët e tij, ku mbizotëron, nga njera anë thjeshtësia, mënyra e drejtpërdrejtë e shprehjes, nga ana tjetër filozofia e thellë njerëzore mbi thelbin e jetës dhe të njeriut. Është pikërisht kjo filozofi e brendshme, që vjen thjesht e pa bujë, që depërton në shpirtin tonë. Kështu studentët e universiteteve tona, në mënyrë të drejtpërdrejtë, por edhe të tërthortë, përthithin filozofinë jetësore ashtu thjesht, por thellësisht të prekshme. Dhe ne e dimë se një autor pëlqehet, bëhet pjesë e jetës sonë shpirtërore, atëherë, kur tërthorazi ai godet në thellësitë e ndjenjave; ne buzëqeshim, vrejtemi, mrekullohemi sepse Agolli arrin të na pushtojë pa u ndjerë. Prandaj një ndër arsytet që Universiteti ndjen detyrimin moral për ta vlerësuar këtë personalitet të kulturës është marrëdhënia aq njerëzore që ka ndërtuar prej vitesh, me botën shpirtërore të rinisë sonë, në të gjitha nivelet e arsimit të saj.

Arsyeja e dytë, që unë mendoj se vlerësimi me këtë çmim është një detyrim moral i universiteteve tona, ka të bëjë me modelin që përcjell krijimtaria e këtij autori lidhur me vlerat e pashtershme të përdorimit të fjalës shqipe. Studentët dhe nxënësit e të gjithë niveleve kanë gjetur në prozën dhe poezinë e Agollit dashurinë për gjuhën shqipe, intuitën e përdorimit të saj në mundësitë e brendshme të pafund, përzierjen mjeshtrërore të leksikut të hapësirave të gjera. Kjo i ka zbuluar atyre vlerat e gjuhës shqipe, sidomos në spontanitetin e shprehjes së ndjenjave më të thjeshta njerëzore, komunikuar shpesh përmes një humori të këndshëm. Kjo i ka dhënë ligjërit të Agollit një forcë të brendshme komunikuese dhe depërtimi në shpirtin njerëzor.

Arsyeja e tretë, që unë mendoj se vlerësimi me këtë çmim është një detyrim moral i universiteteve tona, ka të bëjë me filozofinë e lidhjes së veprës së këtij personaliteti me misionin dhe figurën e tij në zhvillimet ideore e sociale të shoqërisë sonë. Një mendje e hapur, e pakompromentuar, një kurajo qytetare që pozicionohet ndershëm në problematikën shqiptare, jashtë komplekseve të përshtatjes apo interesit të ngushtë personal, besnik i ndershëm i ideve që e udhëheqin në jetë, mendimtar i urtë, që synon të shkojë përtej situatave konfliktuale, që synon të ndikojë me largpamësi në zhvillimet e vendit të tij, etj. Dhe të gjitha këto qëndrime, nuk kanë asgjë të përbashkët me bujën mediatike, me kompleksin e të dukurit sa më interesant dhe dogmatik. Dritëro Agolli ka sjellë një model të ri, thellësisht origjinal, të papërsëritshëm, të komunikimit mediatik dhe bisedor: thjeshtësinë, shprehjen e drejtpërdrejtë, humorin e vetvetishëm, ndaj të cilit askush nuk mund të mbetet indiferent. Kjo mënyrë e drejtpërdrejtë, që ka në themel besnikërinë ndaj një morali të ndershëm njerëzor, është modeli më i suksesshëm për

formimin e brezave të rinj, që sidomos në realitetet e sotme, duhet të gjejnë brenda vetes vlerat e vërteta, parimet e moralshme, mbi bazën e të cilave duhet të ndërtojnë marrëdhëniet e gjata me shoqërinë shqiptare, por në radhë të parë edhe me vetveten.

Duke vlerësuar, shumë shkurt, personalitetin e Dritëro Agollit, mendoj se dhënia e titullit “Doktor Honoris Causa” nga Universiteti i Korçës është, pa diskutim, një nderim edhe për vetë këtë Universitet, i cili ka dëshmuar faktin se figura e këtij personaliteti ka lidhje të ngushta, të tërthorta, por edhe të drejtpërdrejta me brezin e ri që arsimohet në këtë Universitet, por dhe në gjithë shkollat dhe universitetet shqiptare. Ky është një nder që sigurisht i takon personalitetit të shquar të kulturës sonë, por që, njëkohësisht dëshmon se sa e rëndësishme është edhe kuptimi i vlerave dhe nderimi i këtyre figurave nga shoqëria shqiptare.

Maj, 2011

Prof. dr. ALI JASHARI

VLERËSIM PËR AKADEMIKUN DHE SHKRIMTARIN DRITËRO AGOLLI

Për dhënien e titullit “Doktor HONORIS CAUSA” nga Universiteti “Fan S. Noli” i Korçës

Më së pari dua të theksoj se e quaj një privilegj të veçantë dhe e kam për nder që të jap këtë vlerësim për t’i dhënë titullin “Doktor HONORIS CAUSA” akademikut dhe shkrimtarit Dritëro Agolli, çka ka qenë një dëshirë e kahershme e shumë intelektualëve dhe njerëzve të tjerë, si dhe imja personalisht.

Rekomandimin tim e mbështes në disa anë:

Së pari, siç dihet, Dritëro Agolli është një personalitet i shquar në fushën e letrave, duke u spikatur me dhjetra vepra letrare dhe publicistike që ka botuar në gjini e lloje të ndryshme, duke krijuar një shkollë të tërë letrare dhe estetike në Shqipëri, si dhe duke dhënë një ndihmesë të vyer për gjuhën tonë amtare, për të nxjerrë në pah dhe për t’i bërë të gjithëpërdorshme shumë e shumë fjalë e shprehje që më parë nuk njiheshin ose njiheshin fare pak në ligjërimin e shqipes.

Vepra letrare e Dritëro Agollit krijoi traditën e re të letërsisë shqiptare. Ajo na bën të ndihemi me dinjitet përballë botës mbarë. Shkrimtar i madh i një “gjuhe të vogël”, siç e ka quajtur dikush, ai është po aq i dashur prej lexuesve bashkëkombës, sa dhe në qendrat më të mëdha të kulturës botërore. Dritëro Agolli hyri në historinë e letërsisë shqiptare si një poet popullor, që s’mban kurrfarë distance me lexuesin e thjeshtë, që dhimbjen, gëzimin dhe dobësinë njerëzore i merr si ndjenja universale dhe i shkrin me filozofinë e jetës së përditshme.

Lista e veprave të Dritëro Agollit është shumë e gjatë dhe vazhdon të mbushet me të tjera, si në poezi: *Në rrugë dola*, 1958; *Hapat e mia në asfalt*, 1961; *Shtigje malesh e trotuare*, 1965; *Mesditë*, 1969; *Pleshti*, 1971; *Nënë Shqipëri*, 1974; *Fjala gdhend gurin*, 1977; *Udhëtoj i menduar*, 1985; *Pelegrini i vonuar*, 1993; *Lypësi i kohës*, 1995; *Vjen njeriu i çuditshëm*, 1996; *Shpirti i gjyshërve*, 1996; në tregime: *Zhurma e erërave të dikurshme*, 1964; *Njeriu i mirë*, 1973; *Njerëz të krisur*, 1995; në drama: *Mosha e Bardhë*, 1974; romane: *Komisari Memo*, 1970; *Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo*, 1973; *Njeriu me top*, 1980; *Trëndafili në gotë*, 1980; *Dështaku*, 1991; *Kalorësi lakuriq*, 1996; *Arka e Djallit*, 1997 etj.

Së dyti, Dritëro Agolli, si njeri me dije të gjera dhe njohës i disa gjuhëve, ka sjellë në shqip vepra të autorëve të mëdhenj të letërsisë botërore, që është një ndihmesë e vyer në fushën e

përkthimi etj. Nga ana tjetër, mjaft vepra të tij janë përkthyer në gjuhë të ndryshme, si: *Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo; Njeriu me top; Nënë Shqipëri; Pelegrini i vonuar; Komisari Memo* etj.

Së treti, Dritëro Agolli është një humanist i madh dhe veprimtar i shquar në shoqërinë shqiptare, si drejtues i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë, si deputet, çka e ka dëshmuar me veprimtarinë e tij politike dhe shoqërore për vite e vite me radhë.

Së katërti, Dritëro Agolli është një pedagog i shquar në fushën e publicistikës dhe ka ndihmuar në përgatitjen e dhjetra e dhjetra gazetarëve në Shqipëri dhe mund ta quajmë me plot gojë: shkolla e publicistikës agolliane.

Së pesti, Dritëro Agolli është një mik i madh i Korçës dhe i gjithë trevave të saj, duke qenë i pranishëm në shumë veprimtari që janë organizuar në Qarkun e Korçës, por edhe mik i shumë familjeve korçare, devollite, kolonjare, pogradecare dhe më shumë. Ai prej kohësh ka shfaqur dëshirën të jetë pranë studentëve dhe pedagogëve të Universitetit “Fan S. Noli” të Korçës, dëshirë që po realizohet pikërisht në këtë përvjetor të ditëlindjes së tij.

Së gjashti, vlerësimi im mbështetet edhe në njohjen vetjake që kam me Dritëro Agollin qysh nga viti 1981. Unë kam patur fatin që të kem qenë pranë tij sa herë ai vinte në Devoll, si deputet dhe shkrimtar, apo në Korçë e Pogradec e Tiranë. Bisedat e gjata me të më kanë ndihmuar vazhdimisht në punën time krijuese në fushën e gjuhësisë, ndaj dhe *Fjalorin leksiko-frazeologjik të Devollit*, me rreth 12 mijë fjalë e njësi frazeologjike, i cili është përgatitur për shtyp, një punë gati tridhjetëvjeçare, ia kushtoj pikërisht akademikut dhe shkrimtarit Dritëro Agolli, në 80-vjetorin e lindjes së tij.

Së fundi, mendoj se është shumë kuptimplotë fakti që Dritëro Agolli të bëhet “Doktor Honoris Causa” i një universiteti në Shqipëri, që mban emrin e Nolit të madh.

Korçë, maj, 2011

FJALA E SHKRIMTARIT DRITËRO AGOLLI ME RASTIN E MARRJES SË TITULLIT “DOCTOR HONORIS CAUSA”

Unë falenderoj Universitetin e Korçës “Fan S.Noli” që më jep këtë titull të nderuar. Falenderoj zv. ministren e Arsimit dhe të Shkencës, znj. Nora Malaj, me të cilët unë njihem prej kohësh, sepse vendi ynë nuk është aq i madh dhe shqiptarët mund të njihen me emër gati të gjithë, jo vetëm aq, po gjithandej shqiptarët janë kushërinj, kushërinj të parë, të dytë, të tretë, të katërt. Nuk gjen ndonjë shqiptar që të shkojë në ndonjë qytet dhe të mos ketë kushërinj, qoftë në Veri, qoftë në Jug. Unë jam nga kjo anë, edhe ndofta këtu kam më shumë kushërinj se në ndonjë qytet tjetër, por gruaja ime është nga Shkodra, edhe atje kam kushërinj, por edhe të tjerë deri në Tropojë, e ku s’kam, po edhe në Gjirokastrë që kam studiuar, jo studiuar, po mësuar në shkollën e mesme; po në Bilisht që kam bërë shkollën unike, që quhej atëherë, se në atë kohë ishte shkolla fillore 5-vjeçare dhe pastaj unikja, unikja ishte gjysmëgjimnazi dhe meqë kishte pak kuadro arsimorë, prej unikes një pjesë e madhe e atyre kolegëve të mi shkuan mësues, pastaj e vazhduan me korrespondencë mësimin e tyre.

Po në këto raste kur njeriu merr një titull vihet në mendime, thotë: A jam i zoti ta mbaj një titull të tillë apo nuk jam, se mos turpërohem. Po unë jam tashti 80 vjet dhe nuk kam kohë të turpërohem. Vetëm kam kohë të shkoj në një botë tjetër, të kthehem në një materie tjetër, se unë jam ateist, si pjesa më e madhe apo si të gjithë ju që merreni me shkencë dhe letërsi dhe vetëm mund të kthehem në një qenie tjetër, në një krimb apo pas krimbit pastaj bëhem flutur, se kalojnë ato larvat në flutur dhe jam i gëzuar nga kjo anë që nuk mbetem krimb, po bëhem një flutur dhe fluturoj, krahët s’e di si mund t’i kem të kaltër apo të bardhë, por kështu është materia, asgjë nuk humb, vetëm transformohet.

Më duket se Lavuazieri, shkencëtar i madh francez e ka thënë këtë, nëse nuk i ngatërroj, sepse në këtë moshën time njerëzit bëhen edhe matufë, i ngatërrojnë jo vetëm emrat e shkrimtarëve, por ndonjëherë harrojnë edhe emrin e tyre, por gjer tashti nuk më ka ndodhur ky fenomen, vetëm fjalët më ngadalësohen dhe njëherë, bile, m’u ngadalësuan fare se piva dy kokrra, ishin të çuditshme ato kokrra, ilaçe për t’u qetësuar, por mesa duket ai mjeku m’i dha për të fjetur dhe duke folur në një intervistë që u dha, unë s’e dëgjova sepse më vinte turp ta dëgjoja, por një fjalë e thosha pas një minute ndofta. Kështu që njeriu kur vete 80 vjet vetëm kështu mund t’i ndodhë përpara këtyre fakteve, mund të ndodhë që edhe gënjehemi ndonjëherë shpejt,

megjithëse unë rrjedh nga fshatarësia dhe fshatarët janë tepër të zgjuar, nuk gënjehen aq kollaj dhe janë edhe produkt i kulturës së fshatarësisë.

Unë nuk vij drejt nga librat, por vij nga kultura e fshatarësisë, vij nga mjeshtrat e mëdhenj të lërimit të tokës, por vij edhe nga mjeshtrat e tjerë të këngës popullore të popullit, bile kur flas këtu para jush, ndonjëherë më vete mendja t'ia them një njëherë një kënge devolliçe, por duhet të ketë ndonjëri që të ma mbajë, po këtu e kam fjalën që kurrë studentët të mos bëhen mendjemëdhenj, por ta duan vendin e tyre, në fillim të dinë nga kanë ardhur, nga ç'krahinë e nga ç'fshat, t'i duan më përpara ato dhe pastaj bashkohen të gjitha këto dashuri në një dashuri të vetme, me dashurinë për Shqipërinë që, ma merr mendja, do ecë përpara dhe do bëhet një nga vendet më të preferuara dhe për të tjerë vende, sepse është pothuaj e virgjër. E virgjër unë nuk e them në atë kuptim që të vijë dikush nga jashtë dhe të nga çvirgjërojë, por të na ndihmojë e jo të na bëjë gjëra të pabëra.

Pra, unë i dua me gjithë shpirt të gjithë qytetet dhe vendet e Shqipërisë, por veçanërisht e dua Korçën, Bilishtin, po edhe Kolonjën se jam nip nga Kolonjë. E kam thënë dhe herë tjetër këtë, po njëri m'u zëmërua, unë thashë që si devolli unë nuk jam aq i mençur, thashë se nënën e kam nga Kolonja, që kolonjarët janë shumë të zgjuar dhe babanë nga Devolli, se devollinjët hiqen si budallenj, po në fakt nuk janë të tillë, se njerëzit që punojnë kurrë nuk mund të jenë budallenj. Po unë e shkela aty se këtë ia thashë një mikut tim që edhe ai, po kështu të jatin e kish nga Hoçishti edhe të ëmën nga Kolonja, Luarasi. Edhe i thashë se ne të dy, në bazë të fizikës e të matematikës jemi te zeroja, se plus- minus bëjnë zero, se njëri i mençëm, tjetri jo i mençëm, po këtë e thashë me shaka.

Nuk ka vend më punëtor sesa Korça, Devolli etj., po veçanërisht Devolli dhe, nëse do të bëhej një monument, e kam thënë edhe herë tjetër, për lavdinë e punës, duhej të bëhej me figurën e një devolliu, një monument i madh. Po janë të mençëm ata që bëjnë shaka me vetveten. Ka disa fshatra në Devoll që bëjnë shaka me vetveten, si Babani dhe shumë të tjerë, domethënë në Shqipëri ka më shumë që i nxjerrin vetë, nuk ua nxjerrin të tjerëve, vetë i nxjerr vetvetes, kështu atëherë një më i mençur, si Nastradini, ia nxirrte vetvetes ose të tjerë që janë të njohur në historinë e letërsisë.

Ja edhe unë po nga ky vend që nxjerrin anekdota jam, bile dhe këto pak fjalë që thashë i bëra përshesh, sepse njëherë u futa këtej, njëherë dola andej, po tashti jemi mësuar me shumë

fjalime se kemi gjithnjë zgjedhje, po dëgjojmë parlamentin, po dëgjojmë, gjithë këto diskutime të gjata që sikur na i kanë pakësuar fjalët edhe neve.

Flasim kështu kur marrim ndonjë rrobë të tillë të nderuar dhe, edhe njëherë unë do t'u falënderoja të gjithëve që më thirrët, më dhatë këtë titull dhe do ta mbaj me nder, sepse, siç thashë në fillim, nuk kam kohë të turpërohem, po ta kisha marrë në moshën 40-vjeçare më mirë që s'e mora, se disa herë jam turpëruar, kurse tani s'turpërohem dot.

Faleminderit!

VIII. KONFERENCA SHKENCORE KUSHTUAR JETËS DHE VEPRËS SË DRITËRI AGOLLIT NË 80-VJETORIN E LINDJES

Akad. JANI THOMAI

AROMË POPULLORE NË LIGJËRIMIN POETIK TË DRITËRO AGOLLIT

I dashur Dritëro!

Pas këtyrë 80 vjetëve të jetuar, unë, si qindra mijë të tjerë që të njohin, që të kanë lexuar dhe të duan, të uroj me gjithë zemër edhe shumë e shumë vite të tjera të shëndetshme, të mbara e të frytshme, uroj që “të keshë mësuar të plakesh”, por të kesh harruar të vdesësh, megjithëse edhe ashtu e ke fituar përjetësinë.

Për mua është kënaqësi, madje krenari të them dy fjalë për Dritëronë, me moshë 80-vjeçare, por me zemër djaloshare, me thinja të argjendta edhe nga vitet, por më shumë nga një “sëmundje” e rëndë e komplekse që e ka munduar gjithë jetën, sëmundje, që fatkeqësisht nuk është infektive dhe nuk përhapet, sëmundja “e ndërjegjes së lartë”, e punës së palodhur, e shpirtit të pastër që vuan për të tjerët dhe e ndershmërisë tradicionale, e cila megjithatë i ka sjellë një të mirë të madhe, vlerësimin e lartë e dashurinë e sinqertë të të gjithë atyre që e kanë njohur mirë, e me ata jam edhe unë, por edhe një të keqe fare të vogël, smirën e ndonjë shpirtvogli, që është përpjekur të bëjë vetë përjetë sipas esesë së shokut Zylo: *“Ti je mur i lartë, por unë të heq gurin e fundit”*. Ndërkaq, në rastin Agolli nuk ka ndonjë përjashtim, kështu ka ndodhur e ndodh me shumë gjeni, sepse, siç thotë vetë Dritëroi, *“ka njerëz që hanë bukë me dhëmbë..., ka të tjerë që me dhëmbë të mbytin”*. Por Sami Frashëri, i cili ka ditur edhe si do të bëhet a më mirë si duhet të bëhet Shqipëria, ka pasur besim në vizionin e tij edhe për arsye se ka ditur që Shqipëria do të ketë gjithnjë njerëz të mëdhenj si Dritëroi dhe për këta na jep një këshillë të mirë: *“Mos i poshtëroni njerëzit e mëdhenj për një a dy fjalë të tyre, - thotë Samiu, - sepse diamanti, sado i prerë shtrembër të jetë, është më i vlefshëm se një gur i zakonshëm i prerë në formën e përsosur”*. Dritëroi ka qenë e ka mbetur një diamant, madje edhe i prerë në formën e përsosur.

Unë kam ndiesinë se Dritëroi në krijimtarinë e vet priret kah e mira, larg ligësive, urrejtjeve, sharjeve e banalitetëve të kohës sonë. Dy shtyllat më të mëdha, që mbajnë thujse gjithë peshën e brendisë së veprës së tij, sipas meje janë *Shqipëria* (vendi, toka, fshati, rrugët, arat,

fushat...) dhe *njerëzit* (baballarët, heronjtë, partizanët, miqtë, të varfrit...), të gjitha të vështruara me dashuri, me zemër të gjerë, me dëshirë të mirë, me shpresë të pashuar: *Mua më ndrit / Së largu veç shpresa*, - shkruan ai. Vetë titujt e dy poemave, "*Nënë Shqipëri*" dhe "*Baballarët*", si gjetje artistike, por edhe si mjete gjuhësore, përmbajnë atë ndiesi pozitive që përmenda, sjellin me vështrimin e parë dashuri e ngrohtësi shpirtërore, si te poema e Naimit "*Bagëti e bujqësia*". Edhe në krijimet letrare të viteve mjaft të rënda për ne, siç ishin 1966-1967, kur Dritëroi shkruan poezitë për "*Fletorka e mesnatës*", ka shumë dhimbje njerëzore, trishtim e vuajtje shpirtërore të një poeti të ndjeshëm, që në shumë raste i kapërcen me optimizëm e i spërkat me pak humor argëtues. Dhe këtu më duket vendi për të sjellë qoftë edhe katër vargjet e poezisë "*Dashuria për vendin*": *Koha kalon dhe vendin më tepër e dua, / Ndofta e dua se jetën e ka më të gjatë / Dhe jetë nga jeta e vendit marr hua, / Që jetës sime t'i shtoj dhe një ditë e një natë...*".

Si shumëkush, edhe unë e kam njohur Dritëronë si gazetar, si poet, si prozator e si personalitet shoqëror. "*Quo vadis*" i tij mbase që edhe një simbol e mësim për vete, tharmi i jetës së vet dhe i rrugës që duhej të ndiqte. Dhe shtylla kurrizore e Dritëroit nuk u përkul ndonjëherë, ai mbeti i njëjtë, besnik "kokëfortë" i vetvetes në jetë e në krijimtari, i drejtë, i ndershëm e i hapur me të gjithë, me shpirt të gjerë, mjaft popullor, por edhe kritik i guximshëm e miqësor, pavarësisht nga rrethanat politike e shoqërore. I drejtpërdrejtë siç ka qenë gjithnjë, prek zemrat e njerëzve me fjalë të buta a të hidhura, por gjithnjë me zemër të mirë. Gjithnjë ka bërë art për progres dhe, siç thotë Viktor Hygoi, "*Arti për art mund të jetë i bukur, por arti për progres është edhe më i bukur*".

Si e kam njohur e si e njoh unë Dritëronë më është krijuar ndiesia e një simboli e përfaqësuesi më popullor, në veten e vet e në krijimtari, në sjellje e në qëndrime. Në krijimtarinë letrare aroma popullore ndihet e këndshme jo vetëm në prozë, por edhe në poezi, të cilën e sjellin mjete leksikore, frazeologjike, semantike e sintaksore të bollshme popullore. Mbase nuk është e nevojshme ta dëshmoj këtë aromë popullore në ligjërimin poetik të Dritëroit, sepse gjithkush që zhytet në ujërat e tij, e ndien menjëherë se në brendi të vetë krijuesit ka diçka që receptohet paraprakisht dhe që transferohet besnikërisht në poezinë e tij, por receptimi është i njëjtë edhe në drejtim të kundërt: kush lexon veprën letrare të Dritëroit, qoftë edhe vetëm në ligjërimin poetik, njeh vetë Dritëronë, hyn në shpirtin e tij krijues, bindet se fenomeni Dritëro është i rrallë për nga shkrirja thujse e plotë e autorit me krijimtarinë e vet letrare, se prodhimi letrar është ind e majë vetë autori. Dritëroi nuk shtiret e nuk ka nevojë të sajojë poezi, ajo rrjedh vetë drejt e nga zemra e tij.

Për çfarë shkruan Dritëroi? Për gjithçka njerëzore, për çdo motiv popullor: për njeriun e mirë, për baballarët, për të parët tanë e për të rinjtë e sotëm, për zemrat e bardha e shpirtrat e dashuruar, për heronjtë, për shokët e miqtë, për dashurinë njerëzore e pastaj për Shqipërinë, për fushat e gjelbra e arat me misër, për baltën e fshatit, për rrugët plot jetë, për lulet dhe zogjtë, e për gjithçka na rrethon e përbën jetën tonë. Këto motive ngjizen në poema e vjersha dhe dendësohen e përqendrohen në fjalë kyçe, si: *Shqipëri, bukë, baltë, shi, gunë, raki* (“S’ka shkrimtar që të mos pijë” – thotë Dritëroi), *defterkë*, “*Kanë ndodhur shumë gjëra, o njeri, para se të vije ti*”, “*Zverdh hëna në perden e qiellit si buka e misrit*” etj. Por edhe në ligjërimin poetik Dritëroi nuk bie nën kufirin ku nis zona e folklorizmit, ai shkon me Naim Frashërin, Dhimitër Paskon, Jakov Xoxën e të tjerë dhe largohet nga Anton Zako Çajupi, Gjergj Fishta, Ali Asllani e të tjerë. Poema “Nënë Shqipëri” ngjan si jehonë e vargut naimjan “*Shqipëri, o mëma ime...*”. Ligjërimi letrar i Dritëroit është popullor jokrahinor, nuk mund të thuhet se ai shkruan “devolliçe”, siç mund të thuhet për një tjetër që shkruan labçe, dibrance a shkoderanisht.

Ngjyrimi popullor i ligjërimin poetik të Dritëroit mund të dëshmohej qoftë edhe me leksikon karakteristik të përdorur. Simbolikisht mund të themi se te ligjërimi poetik i tij nuk janë karakteristike fjalë të tilla si *furrnalta*, por të tilla si *hallemadhe*. Dhe sa për dëshmim me shembuj po përmend disa shtresa, klasa a grupe leksikore më të rëndomta:

1. Fjalë të leksikut popullor: *Në një qytet me **buba** dhe me minj; Dhe Dielli i Madh do qeshet e do zgërdheshet; Të heshtësh **fillikat** diku në kafe; Diku i fshehur, **tretur** e harruar; Me **rraqe** e **rrangulla** mbështetur pas murit; Është koha kur mblidhen **shuk** nën peshën e natës; U frymë, **u mufatëm** dhe plasëm të gjithë në rrugë; Plasi **për dreq** në mrizin e zanave të tua; Po ne, poetët e vjetër, jemi vërtet **namusqarë**; Me sy të **çaplyer**, plot **neps** e plot **epsh**; Dëgjoj **lebetitjen** e qengjit të butë; Dëgjo rënkimin e vicit **qyqar**; I zjeva në **poçe prej balte** e lëngun e trashë e nxora; Po presim të ngrihen, të marrin **çomogat**; Të gjithë djemtë i **përpiu** kurbeti; Në muret e gjumit **piklosur** si letër; Mbase me **shajak** më qep një **gunë**; Që prapa dritareve shiu do zgjatë **tërkuzët**; **Tuliten** zërat e vdekur prej kohësh; Dhe vjen një çast që zgjohen **vetëtimthi**; Po dhe një **pis** që fjete në atë dhomë; Që dalin, fshihen e papritur **feksin**; Në arkivol a me **tabut**; **Quheshin lugetër**; Dhe **shkrofëtinte** pak nga qejfi; Me lodrat dhe me **dhelet**; Humb një krua / Dhe **shkrënd** të mbetet vetja; Nënokja në **ugar** më polli, / Ndaj erë e **ugarit** më ndjek dhe mijëra fjalë të tjera të kësaj shtrese, kryesisht të botës fshatarake.*

2. Kësaj shtrese i takojnë edhe fjalët me burim nga turqishtja, arabishtja e persishtja, që kanë hyrë prej kohësht në leksikun popullor të shqipes, si: *Dhe lëngun e marr që ta kem për melhem të dobishëm; Dhe do dal kaçak në Kurvelesh; Zblonte dhëmbët prej sedefi; Në vend të mbretërve tutkunë; Se zoti mund t'ia mbushte hejbet plot, / Madje në varr t'i kishte plot sunduqet e dhjetëra fjalë të tjera. Vetë Dritëroi i çmon vlerat e veçanta shprehëse e ndjenjësore të orientalizmeve në shqipe, veçanërisht në folklore, kur thotë: “Nuk mund ta zëvendësojmë fjalën turke *ilaç* e të themi “*Bejkë e bardhë, bejkë e stanit / Ti je medikamenti i çobanit!*”.*

3. Po të shtresës popullore a bisedore janë edhe një numër i madh njësisish frazeologjike, fjalësh të urta e proverba, që, në të vërtetë, nuk janë mjete karakteristike për gjininë e poezisë: *Po varri kurrizdalin nuk e ndreq; Flutura pastaj të marrë dhenë; Nga era e qelbur vunë duart në kokë; Po, dashtë zoti, mos bëhen atje prostituta; Dhe vetëm pak pleq të zë syri pas lumit; Lundrimin në një det pa anë e fund; Sa keq që s'e besoi të madhin zot; Pemët i pjek behari, namin e merr vjeshta* etj.

4. Afër këtij grupi janë edhe disa mënyra popullore të thëni, që të futin në mjediset popullore, si: *Rakia nuk më pihet, / Thonjtë i kam, po nuk më kruhet, / Gjumi shkoi, - s'më flihet; Po unë i ziu më keq se ti; Mos më keq më kanë lënë; Drutë e lisit bëhen prush në vatër; Kur laja kalin tim në lumë* etj.

5. Aromë popullore kanë edhe disa krahasime me sende e modele popullore: *Dhe gishtat kërcasin si kokrra arrash të forta; Aq sa s'mbijnë atje as gjemba gomarësh; Dhe dridhen si fletë e lofatës; Se vendin tim me shpirt të grisur si branë...; Në grykat e tyre ra thatësira si shkrumbi; Një re... / Si pendë e një turtulli me ngjyrë; Dhe zgjohesh sikur po mbytesh në lumë; Spirti m'u bë Shahin Matrak; Si rrënjët nën një hi përcëllimë; Si zëri i ujërave nga gjiri i tokës* etj.

Ngjashëm me këto janë edhe disa mjete të shprehjes emocionuese, si, fjala vjen, thirrori: *O baballarë...; O mëmë Shqipëri...* etj. (si te Naimi: *O malet e Shqipërisë...*).

Mund të shkruhen qindra faqe për këtë tipar të ligjërimit poetik të Dritëroit, di që profesor Ali Jashari ka hartuar një fjalor të veprës letrare të Dritëroit, kurse unë po ndalem këtu dhe po e mbyll duke ju kujtuar se bindja e pavdekësisë vjen nga vetë zemra e poetit: “*Zemra vdiq, la zemra emër / Rrugës plot mundim*” – shkruan Dritëroi.

Prof. dr. GJOVALIN SHKURTAJ

“BALTA E ARAVE” SI SHTEGU I PRURJEVE GJUHËPASURUESE DHE GJUHËDASHËSE TË DRITERO AGOLLIT

Dritëro Agolli, ashtu si çdo mjeshtër i madh, duke ua vënë veshin këngëtarëve dhe bejtethurësve popullorë, mori prej tyre edhe “gjedhen” e mbarë të krijimit, po edhe zellin për të mos u ndalur vetëm në aq sa mori prej tyre, ai iu vu krijimtarisë letare me synimet largvajtëse dhe, në një farë mënyrë, na kujton thënien urtake që thotë: *“Ishin amatorët ata që ndërtuan varkën e Noesë dhe profesionistët ata që ndërtuan Titanikun”*.

Treva e Devollit paraqet interes të madh gjuhësor. Devolli është një krahinë me një folklor të pasur, gjë që dëshmon ndjeshmërinë e lartë të këtij populli. Leksiku, frazeologjia dhe fjalët e urta të asaj krahine, bashke me toponiminë e saj të larmishme përbënin pa dyshim vlera të kulturës popullore dhe të gjuhës shqipe, me të cilat Dritëroi jo vetëm u ushqye, por edhe mbeti përjetësisht i lidhur e nuk rreshti asnjëherë së qëmtuari e së përzgjedhuri si bleta në lulet e pranverës. Parimi i tij krijues, për sa i përket gjuhës, ka qenë ai që e ka formuluar në një artikullin porblemor me titull “Ka ardhur koha të flasim për gjuhën”, ku ai thotë në mënyrë proverbiale se gjuha duhet përpunuar, por nuk duhet tharë, **ajo duhet të jetë gjithmonë me lëng si një pjeshkë**. E kam cituar shpesh këtë thënie magjistrale të poetit dhe nuk mund të mos e përsërisja edhe sot në këtë datë të rëndësishme për jetën e tij. Jubileari ynë i nderuar dhe i dashur sot mbush 80 vjet dhe unë, si një prej adhuruesve dhe vlerësuesve të tij kam më se dyzet vjet që jam marrë vetë (ose kam yshtur e nxitur studentët dhe pasuniversitarët e mi të merren) me ligjërimin dhe vlerat e pasurinë e madhe të shkrimtarisë së tij, duke lakmuar të nxiret në dritë e të mbetet si model për të rinjtë zotësia e këtij mjeshtri për të ngjizur e shkrirë në mënyrë të harmonishme atë që vjen nga rrethinat e anët, nga gjuha e popullit të thejstë, me sa kërkojnë sot e në vijim kahet e ecjes e të përparimit të shprehjes letrare e përgjithësisht të shkrimtarisë në shqipen e sotme. Ashtu si shqiponja që ngjitet në lartësitë më të epërme, por pikërisht së andejmi vrojton e kap me sytë e saj të mprehtë atë çka i duhet për ushqimin e vet, ashtu edhe shkrimtari ynë, si kurrkush tjetër, pikërisht kur ishte lart, në krye të Lidhjes së Shkrimtarëve e bash kryetar i saj, në vargun e tij lapidar, të cilin e dinë përmendsh tashmë të mëdhenj e të vegjël, thirri me sa i jehonte zëri i tij pa asnjë ngurrim: “jam fshatar i Jugut” dhe jo “poet” dhe shpalli botërisht kredon e tij krijuese që

ngërthehet në pohimin e tij metaforik “paskam marrë baltën e arave të Devollit” për ta sjellë në Lidhjen e Shkrimtarëve.

Kam shkruar qyshkur dhe u jam kthyer sa e sa herë poezive dhe prozës së Dritëro Agollit dhe, gjithmonë më është dukur se kam gjetur gjëra të reja. Edhe për kumtesën time të sotme, nuk munda të mbetsha në ato që i kisha shkruar e thënë më parë. M’u desh ta rilexoja e ta ristudioja krejt shkrimtarinë e tij, ashtu si bujku që e thyen, pa e përzien a treton arën dhe, mbas disa lavrash njëren pas tjetrës, e leson dhe e mbjell...Shpresoj se, sidoqoftë, në ato që do t’i themi Dritëro Agollit ne jubileun e 80-vjetorit të ditëlindjes, së paku të mos jenë fjalë të rreshtuara pa u menduar thellë. A nuk na ka mësuar kështu vetë ai me “Udhëtoj i menduar”?!

Kam shkruar disa herë, së pari në gazetën “Drita”, pastaj edhe te revista “Lettres albanaises” për gjuhën dhe ligjërimin në veprat e D.Agollit gjithmonë në boshtin tematik, që synonte nxjerrjen në pah të tipareve kryesore të ligjërimit poetik të Dritëro Agollit.¹ Atyre që kam shkruar mund t’u shtoja edhe shumëçka, por vlerësimeve të larta që kam bërë për prurjet origjinale nga treva e vendlidjes së tij dhe, sidomos, për punën fisnikëruese që ai ka bërë dhe vijon ta kryejë edhe sot që i festojmë 80-vjetorin e ditëlindjes, nuk u heq asnjë presje. Për të bashkuar zërin tim me kumtesat e kolegëve të nderuar, aq të shumtë që kanë ardhur sot në Korçë për ta nderuar e vlerësuar me fjalë miradie, po lejohej të përmend vetëm disa prej atyre që ia kam blatur qysh këtu e 30 vjet më parë.

Së pari, pohimin se, të shkruash për ligjërimin poetik të D. Agollit është një kënaqësi me rreziqe të shumta. Kënaqësia, dihet, buron nga rrethana që vjershëria e tij nden material të bollshëm e të larmishëm, ka figura e fjalor poetik të nduernduershëm, të përzgjedhur mirë e të vënë në ligjërim me dorë mjeshtri, saqë, mendoj se nuk e teproj aspak po të them se, çdo vjershë e, sidomos, çdo poemë e tij, mund të meritonin analiza gjuhësore e stilistike më vete. Rreziqet, gjithashtu, burojnë nga ajo ngrehinë e hapët e ligjërimit poetik të tij, ku ndeshim aq shumë fjalë, togfjalësha, frazeologjizma e mënyra të thëni të reja në letërsinë tonë, para të cilave edhe mund të stepesh, t’u kalosh përkaj pa i rrokur siç duhet apo vetëm sa t’i përmendësh, pa arritur t’u ngjitesh të përpjetave të figuracionit aq të guximshëm ku e shpie ai "mushkën e tij xanaxare", pa le t’ia kapësh atë për freri e t’i thuash "kujdes nga ngjyresat e tepruara krahinore" apo se aksh fjalë e re që ke përdorur nuk më duket e ardhur edhe aq mirë. Por, më i madhi rrezik është që, sidomos në përmasat e vogla të artikujve për shtypin, të thuash për vlerat shprehëse të një poeti kaq të

¹ Botuar më parë në librin tonë: “*Ta duam dhe ta ruajmë gjuhën tonë të bukur*”, SHBLU, Tiranë, 1998, f.100-112.

madh, shumë më pak sesa ka realisht vjershëria e tij². Dhe rreziku i fundit, por që nuk është aspak për t' u shpërfillur, është se për poetët e mëdhenj, në çfarëdo vështrimi që ti drejtohesh krijimtarisë së tyre, nuk mund të shkruhet në mënyrë të zakonshme. Dritëroi hyn në radhën e krijuesve më në zë, pesha e fjalës së të cilit është aq e madhe e me vlerë në letërsinë shqiptare, saqë njeriu që merr penën të shkruajë për të, përshkohet nga një emocion i ngjashëm me atë që ka nxënësi kur i bie rasti të vlerësojë veprën e mësuesit të tij më të dashur. E them me bindje se shkrimtarë si ai janë vërtet mësues të kulturës gjuhësore, japin gjedhe madhështore se si mund të flitet bukur, se si mund të bëhet vjershëria e përimituar mirë, se si mund të gdhendet fjala shqipe në mënyrë që të shkëlqejë në poezi me tërë forcën e madhështinë e saj.

Së dyti, **konceptin për gjuhën letrare kombëtare dhe për ligjërimin artistik**. Në tërë krijimtarinë e tij letrare, si në poezi ashtu edhe në prozë apo në dramë, po edhe në shkrimet publicistike të kohës mjaft të gjatë që ai ka punuar si gazetar, mund të shihen qartë përkujdesja dhe puna e palodhur e D. Agollit për gjuhën. Ai është nga ata që, teorikisht dhe praktikisht, mëton për një gjuhë letrare të njësuar, por kërkon që ajo të jetë kurdoherë e njomë, e freskët, e re apo e përtëritur në mënyrë origjinale, e pasur e me të gjitha ngjyresat e vlefshme popullore, e pastër por, sigurisht, jo e "lëpirë". Ai flet ose fut spica a hedh romuze në disa prej vjershave e poemave të tij, po edhe ndërmer trajtesa të mirëfillta me karakter teorik e kritik, nga të cilat meritojnë vëmendje të veçantë artikulli "*Ka ardhur koha të flasim për gjuhën*" ("Drita", 26 mars 1972), pasthënia e librit "*Udhëtoj i menduar*" si dhe intervista me disa shkrimtarë tek revista "Gjuha jonë", nr.1, 1996. Në artikullin tek "Drita" Dritëroi theksonte: "Më ka marrë malli të shoh në faqet e shtypit letrar dhe të shtypit profesional të gjuhësisë, artikuj studimorë për evoluimin e gjuhës artistike në prozën tonë të viteve të fundit, në romanin, novelën, tregimin" dhe përmendte aty, me të drejtë, disa anë të rëndësishme të ligjërimin artistik që meritojnë të trajtohen më gjerë dhe më shpesh në faqet e shtypit letrar e shkencor. Me pak fjalë koncepti i autorit për ligjërimin artistik mund të përmbliidhej në kërkesat e mëposhtme: domosdoshmëria e ngushtimit të hendekut midis gjuhës apo ligjërimin artistik dhe gjuhës e të folurit të gjallë që ndeshim në jetën e përditshme; detyra që shkrimtarët, tok me një përmbajtje të re, përherë e më të përparuar e më largvajtëse nga pikëpamja ideoartistike, të krijojnë edhe një ligjërim artistik të përshtatshëm e me kërkesa gjithmonë e më të larta për bukuri, pasuri e larmi shprehëse. Si krijues me përvojë e dije

² Për gjuhën dhe stilin e D. Agollit, prej këtij studimi, është botuar vetëm një pjesë, në gazetën "Drita" të datës 19 prill 1987 dhe një shkurtore në revistën "Lettres albanaises".

të gjera ai argumenton se njësimi i gjuhës letrare dhe zbatimi i mirë i normave të saj, jo vetëm nuk e përjashton, por edhe e parakupton dhe e pranon nevojën e paraqitjes së ngjyresave (koloritit) me anën e gjuhës si dhe një përzgjedhje sa më të kujdesshme e funksionale të mjeteve gjuhësore që ndërthuren në ligjërimin artistik. Ja si thotë ai: "*Çështja është që studiuesit, gjuhëtarët, kritikët ta kthejnë fytyrën nga gjuha artistike, e cila është mjete numër një në duart e shkrimtarit, është thika e kirurgut dhe sëpata e druvarit*". Parimin e tij themelor që shkrimtari të mos e thajë gjuhën, por ta mbajë atë "me lëng si një pjeshkë", D. Agolli e mbështet në bindjen e patundur se "lëngu vjen nga gjuha e popullit" dhe gëzohet që "*sa vjen dhe më afër gjuhës së popullit po shkon gjuha e shkruar letrare*" (Shih: "Gjuha jonë", 1, 1986, f. 10).

Së treti, mjeshtërinë e poetit për të gjetur **fjalët, figurat dhe për ta pare ligjërimin si krijim të pandërprerë**. Fjala, togfjalëshi, vargu dhe e gjithë thënia në poezinë e D. Agollit kanë një organizim e strukturim të tillë ku shquan gdhendja mbi bazën e një ideje të qartë e të një mëtimi që kurdoherë të arrihet mbrujtja e natyrshme e dy shqetësimeve më parësore të poetit: ta verë poezinë e tij në shërbim të ideve të mëdha të kohës, po edhe të zotërojë mjeshtërinë e këtij arti të brishtë, deri në atë shkallë sa ligjërimi i tij të rrjedhë me origjinalitet e me "vulën" e personalitetit të tij. Bashkë me I. Kadarenë, F. Arapin, A. Shehun etj. ai është nismëtar i një shkolle të re të ligjërimin poetik, që do ta bëjë lexuesin për vete jo vetëm me atë që thotë, por edhe me mënyrën se si e thotë, me fjalën e thënë bukur e të gjetur mirë. D. Agolli është tashmë i mirënjohur si poet që flet hapur me lexuesit, si njeri i partishëm dhe që u bën jehonë me vetëdije e me përparësi përjetimeve të mëdha shoqërore e shndërrimeve në jetën e në mendësinë e njeriut të sotëm, si zyrtari që i ruhet burokratizimit dhe shtrohet rrafsh me njerëzit e punës, me bujqit e blegtorët dhe flet me ta njësoj si me kolegët e vet poetë dhe shkrimtarë. Së këndejmi vjen edhe ajo larmi tematike, po edhe ajo gjerësi e hapësirë e madhe e mjeteve të ligjërimin poetik, gjeografia e të cilave s' ka asnjë kufi të prerë kohor dhe krahinor. Poeti i njeh dhe i zbaton mirë normat e gjuhës letrare standard dhe është nga ata që i kanë shërbyer aq shumë njësimin, lëvrimit e pasurimit të saj të mëtejshëm, porse, si kudo, edhe në këtë lëmë, Dritëroi ka veçantinë dhe origjinalitetin e vet: si krijues që e di sa shumë i peshon fjala.

Së katërti, duhet të theksojmë se Poeti vjen nga anët e Devollit dhe vendlindjen, natyrën, njerëzit, punët e çdo gjë të mirë të saj do t' i përmendë aq dendur në vjershat e tij, porse **ai nuk është aspak poet fshatar**. Poezia e tij nuk mund të cilësohet si bukolike, edhe pse aq të shpeshta janë në të fjalët e termat e bujqësisë, të blegtorisë, emrat e kafshëve e të bimëve të arës, të

pemëve e të drunjve të pyllit, të gjithë shpezërisë. D. Agolli e ka fshatin si "bazë nisjeje" për të mësyre shtigjet më të epra të poezisë së lëvruar hijshëm dhe përfaqëson krijuesin ngulmues që "mundohet e heq mbi poezinë", që "vuan mbi rrokje e vargje" dhe që nuk kënaqet me pak. Dashuria që ka ai për poezinë, të cilën e quan "e dashura ime e parë" e nxit t' u turret kullave të saj për të gjetur "muzën" poetike e për të ndjekur atë në çdo vis që të jetë, pa u penguar nga asgjë, ashtu siç bën Halili për Tanushën e bukur në eposin e kreshnikëve. Për ta arritur këtë ai bën kërkime e sprova të shumta, lodhet e djersitet, stërvitet vazhdimisht që të ngasë "poezinë-mushkë", ashtu siç ngitnin Pegasin poetët e lashtë. Duke kundruar ligjërimin artistik të vjershave dhe poemave të këtij poeti, mendja na mbetet tek kalimet e fluturimet e kuptimeve të figurshme aq të guximshme po edhe aq të bukura e mbresëlënëse ku shquajnë sidomos metaforat e perifrazat, krahasimet dhe përngjasimet (similitudat), paralelizmat figurativë, metonimia, sinekdoka, simboli, ironia etj. Ja disa perifraza ose kalime kuptimore të figurshme të një bukurie të rrallë: *Lulet u ngritën nga shtrati i tokës/ Dhe i veshën fustanet më të bukura/ Për të shkuar në ballon e madhe të pranverës/ Ku luan orkestra e bilbilave / E mjeshtërve të violinës.* ("Vizatime në pranverë"). *Pranvera shkruan miliona libra gjelbërimi.* ("Fund dimri"); *Zogjtë me majën e sqepit firmosin e larg fluturojnë.* ("Vdekja e fshatarit"); *Retë shtynin shamitë mbi pemë.* ("Çerdhet e zogjve në dimër"); *Unë eci buzë liqenit të Drinit të lashtë/ Malet në pasqyrën e tij krehin mjekrat / Pishat qerpikët i lyejnë me ngjyrë të kaltër /Nusërojnë në këmbët e bardha mështeknat/* ("Udhëtoj i menduar"); *Natë e kaltër e mbjellë me yje/ Nata po bridhte nga shkrepat, nga pyjet/ nata po mbillte si grurin yjet.* ("Yjet"); *Në ujë lahen dielli, vaporët, vinçat, kanxhat? Me frymë mbush kraharorin deti / Direkët e vinçat puth mëngjesi i lirë.* ("Mëngjesi në port").

Dritaret e barakës/ i rreh kamxhiku i shiut me zhurmë. ("Nga fletorja e shënimeve"); *Hëna brirët lan në lumë* ("Mall"); *Këndon eukalipti nga suferinat / Këndon violina krenare e vjeshtës.* ("Mendime në vjeshtë"); *Korriku i ka pirë lumenjtë.* ("Peizazh pas shkretimës"); *Etja zvarriset nga shkrepat e gurët.* ("Peizazh"); *Retë shtrydhin shamitë mbi pemë.* ("Çerdhet e zogjve në dimër"); */ Gramozi përgjon në kufi vështrimin e lashtë / Dhe flet me Moravën me bluzë të gjelbër / Mali Ivan tund kokën e thinjur kashtë.* ("Nënë Shqipëri"); *Dielli ngrihet e zbret e vizaton me radhë ? Hijet e maleve dy herë në ditë / Mbi qilimin e grurit të verdhë.* ("Nënë Shqipëri"); *Me çarçafë të bardhë dimri afrohet i menduar.* ("Udhëtoj i menduar"); *Zbret lumi malit si dashnor i marrë / T' i puthë i etur buzët e luginës.* (f. 55); *Lumi gjuhën zgjat i lodhur dhe lëpin në heshtje*

brigjet. (f. 87); *Atje pas lumit një rrap / Hënën për briri e kap*. (f. 177); *Ku vareshin gërshetat e një shelgu*. (f. 178).

Për çdo dukuri e në përputhje të plotë me përpjesëtimet e heroit të tij lirik, autori gjen edhe krahasimin e metaforën përkatëse, kurdoherë me mënyra të reja e ku shquan origjinaliteti e fryma e thellë popullore. Me anën e krahasimit si dhe të figurave të tjera të shumta, autori sjell një pasuri të madhe e shumë të vyer që i jep hije jo vetëm vjershërisë së tij, po edhe përbën një pasurim të ndjeshëm të ligjërimin artistik të shqipes. Po të hyjmë në "laboratorin krijues" të këtij poeti do të shohim se si ai "zhonglon" me fjalën, përaftron e përqsas të njohurën me të panjohurën, të afërtën me të largëtën, konkretën me abstrakten, të zakonshmen me të papriturën më të çuditshme, të përveçmen me të përgjithshmën, "unin" e tij poetik me tërë universin për të krijuar, kështu, "rruzullimin" e tij poetik, porse gjithmonë pa shkaktuar pështjellime e pika të errëta, as në vargun e figurat e vjershave të tij, as në vizionin e gjallë poetik që i krijojnë ato lexuesit. Këtë autori e arrin sepse ka njohje të thellë e të sigurt të jetës, po edhe sepse kurdoherë si bazë nisjeje të çdo përgjithësimi ai ka tokësoren, realen, materialen, konceptimin e drejtë dhe të qartë të lidhjeve dialektike të dukurive natyrore dhe shoqërore. Mendoj se krahasimet popullore jo vetëm nuk e ulin, por, përkundrazi, e ndihmojnë poetin për t' u ngjitur sa më lart e për të qenë i sigurt në çdo lartësi. Sa herë e ndien se është ngjitur tepër lart dhe rrezikon të zbehet sadopak qartësia e shprehjes se tij poetike, autori e ul "flurudhën" dhe u afrohet pranë gjelbërimit të fushave, arit të grurit të praruar nga pjekja, dheut që prodhon bukë nga djersa e popullit etj. dhe, kështu, ai merr fuqitë e pashtershme si Anteu mitologjik kur prekte tokën. Sa herë, duke lexuar vjershat lirike të Dritëroit, më ngjan se ka njëfarë përngjasimi midis heroit lirik të poetit që ia hyp "*mushkës - xanaxare*" dhe udhëton në shtigje malesh, në fusha e në pyje, brenda e jashtë atdheut, që nga Devolli ku i regëtin së pari zemra për një fshatarkë të bukur e deri tutje në Anadoll tek turkesha e bukur, kurdoherë krenar edhe epik, dhe Halilit në eposin e Veriut, prototip i kreshnikut qejfli e zullumqar, që për dashurinë e besën që i ka dhënë Tanushës ia hyp gjogut dhe çan si vetëtima pa pyetur as për krajl as për mbret. Eposi popullor dhe krejt folklori i trevave shqiptare, këngët dhe vjershat e vendlindjes, krahas letërsisë shqiptare të traditës, i shërbejnë poetit kurdoherë si një tharm poetik, si indi lidhës i vjershave dhe i poemave të tij. Heroi i tij lirik, natyrisht, në një periudhë mjaft të gjatë kohe, prej më se tridhjetë vjetësh, që kur nisi shtegtimin e tij poetik ("*doli në rrugë*", hodhi "*hapat në asfalt*", shkeli në "*shtigje malesh e trotuare*") - vini re se si spikatet edhe në titujt e përmbledhjeve poetike të tij **ideja e udhës**, e vazhdës poetike-, por gjithmonë,

edhe në moshën e burrisë kur "*udhëton i menduar*", ai na shfaqet i veshur si me virtytet e tiparet shpirtërore të devolliut, ashtu edhe me leksemat më të bukura të së folmes së vendlindjes, të cilat përbëjnë atë ngjyresë të këndshme të ligjërimit poetik të Dritëro Agollit. Në mënyrë të figurshme këtë e ka dhënë aq bukur vetë poeti, qysh në vjershat e tij të para te libri "Në rrugë dola":

*"Vjersha ime erë ugari bie,
vargu im bie erë luleshqerrë".*

Fjalët më të dendura dhe sigurisht më të dashura për poetin janë: balta e arave, ugari, vreshta, era dehëse e vjeshtës, aroma e mollëve e dardhave, porse rrethi i fjalësit të fjalorit poetik të tij është me përmasat e gjera të një enciklopedie të vërtetë. Nuk di a ka ndonjë kafshë a pemë e bimë që të mos përmendet diku në vargjet e vjershave e të poemave të këtij poeti, prandaj edhe është e pamundur të renditen tërë ato vistra fjalësh në një trajtesë si kjo. Ajo mbetet detyrë për studimet e gjera në të ardhshmen, porse, me këtë rast, duhet të theksojmë se, më tepër sesa në vetë fjalët që përdor, fryma popullore e shndetshme e ligjërimit artistik të Dritëroit spikat në kalimet e figurshme aq të zhdërvjellëta, në zotësinë për të pranëvënë, përqasur e krahasuar, apo për të përdorur këmbyerazi fjalë që emërtojnë frymorë, sende dhe dukuri nga më të ndryshmet e duke i paraqitur edhe nocionet abstrakte e idetë e tij filozofike në këndvështrimin e me mjetet e një shprehjeje të figurshme sa më konkrete e që i përçon mirë ato te lexuesi. Kjo bën që në ligjërimitin e tij të pleksen leksema që emërtojnë objekte të ndryshme, si: *bukë, grurë, brazdë, hekur, beton, boing, zog, kallëz, mushkë, ftujë, mal, tokë, det, rërë, hënë, diell, yll, qiell* etj. Pleksen aty fjalë të gurrës popullore, krahinorizma e dysorë të ndryshëm, si: *kum-rërë, shalqi-karpuz, nënë-mëmë, kështjellë-kala* etj.; si dhe fjalë të sferës librore, terma të shkencave të ndryshme, emra njerëzish e toponime të vërteta apo të sajuara etj., të cilat, ndokujt mund t' i duken edhe teprime dhe ndonjë kritik, pa e tjerë gjatë, i ka parë dhe i sheh ato kategorikisht si elemente të shfrimit lirik për jetën e fshatit, kurse ato për poetin janë si "trampolina" për të shprehur më zhdërvjelltësi mendime për kohën dhe njeriun. Fjalët për poetin janë mjete, janë vegla pune, prandaj ai i njeh dhe i mat mirë, po edhe i lëviz aq shpesh e në mënyra të shumta, të pazakonta e, herë-herë, aq të çuditshme, duke kaluar nga objektivja në subjektiven (apo anasjelltas). Tipike janë, ndër të tjera, vargjet e vjershës "Dëshirë poetike":

*Ta marr fjalën e ta bëj plis ugari,
ta marr shkumën e ta bëj sheqer,
ta marr grurin e ta bëj letër cigari,*

*ta marr lumin e ta bëj ylber,
ta marr këngën e ta bëj turbinë,
ta marr malin e ta bëj hambar,
ta marr pikën e shiut e ta bëj balerinë.* ("Udhëtoj i menduar", Tiranë, f.11).

Gjithmonë në kërkim poeti i vërtetë është gjithmonë në kërkim të së resë në ligjërim e përgjithësisht në mënyrën e të shkruarit, me qëllim që përmbajtjes së re, ideve dhe mendimeve të reja të kohës së vet, t' u japë edhe formën e shprehjen më të përshtatshme. Në vjershën "Për poezinë" poeti i rrëfëhet çiltërsisht lexuesit:

*"Nuk dua të shtirem i përvuajtur para njerëzve,
por shpesh veten time kam ngrënë me dhëmbë,
Se poezia që kam kërkuar ka qenë e fshehur
Nën mburojë të rëndë".* ("Poezi", Tiranë, 1979, f. 409)

Së mbrami, dëshirojmë të themi se poeti D. Agolli, jo vetëm që e deklaroi kërkimin për veten e për të tjerët, por edhe e zbaton atë në përmasat më të gjera. Kjo bën që edhe në planin ligjërimor të na zbulohet një hapësirë ashtu e gjerë dhe e pafundme. Vetëm në vjershat ku flet për vargjet e shohim se si, duke i përjetuar vazhdimisht ato kërkime të mundimshme, poeti thotë se ato mbajën, herë erë ugari, herë erë luleshqerrë, herë erë mendër, herë erë trëndelinë, herë kërkon që ato të pinë sisën e vjeshtës. Dhe, mënyra të thëni të tilla, në gjuhë janë të panumërta, sepse gjuha është vërtetë si një minierë e pashtershme. Ja si e shpreh këtë vlerësim vetë poeti: "*Me gjuhën shkrimtari i vërtetë bën mrekullira. Ajo është minierë e pafundme, minierë që nuk shteron kurrë, edhe sikur të mblidhen bashkë e të kërkojnë gjithë brezat njëherësh*". ("Gjuha jonë", 1, 1986, f. 6).

Thellimi në njohjen e vlerave gjuhësore e stilistike të ligjërimit artistik të autorëve tanë më të mirë dhe ndërmarrja e studimeve sa më të plota përmbi to përbën një fushë kërkimesh po aq të vlefshme e me rëndësi sa edhe ajo e studimeve kushtuar normës e kodifikimit gjuhësor, terminologjisë e proceseve të ndryshimit e zhvillimit të dialekteve etj. Hartimi, p. sh., i një studimi të hapët si dhe i një fjalori të veprave letrare të D. Agollit, ashtu si edhe i disa shkrimtarëve të tjerë të shquar të letërsisë shqiptare, do të ishte një nismë shumë e dobishme dhe e kohës. Lum kush do t' u përvishet atyre me zellin e përkushtimin e nevojshëm.

Korçë, 21 tetor 2011

Prof. dr. YMER ÇIRAKU

LEGJENDË E GJALLË E FJALËS SHQIPE

Duke e vështruar integralisht tërë krijimtarinë tejet të pasur, me larmi stilesh e zhanresh letrare të D. Agollit, mund të formulohen e të bëhen shumë qasje interpretimi, çka e sugjerojnë veprat me kualitete të larta.

Kjo vjen pasi vepra e tij nuk përcillet në struktura lineare, si konceptualisht - ashtu dhe stilikisht. Përkundrazi, ajo është polikromatike dhe me kryqëzime ndikimesh nga traditat e mëdha dhe nga risitë poetike.

Na tërheq vëmendjen, sidomos në poezinë e tij, shfaqja konstante e motivit *të udhës*. Këtë e ka vërtur dhe kritika e kohëve të ndryshme, por është minimizuar, duke e spieguar atë, kryesisht si pasojë të raporteve aktive që manifeston heroi lirik me jetën, ose e formuluar ndryshe, e shfaqur si një prirje dominante në këto tekste agolliane, e modelit militant - përkundrajt modelit meditant, të njohura këto në fakt si modelet principale të teksteve letrare në të gjitha kohërat. Por gjukojmë se ka vend për t'iu bërë një interpretim më i brendshëm këtyre teksteve, prej nga do të buronin për pasojë dhe konkluzione më bindëse.

Rruga, udhëtimi, lëvizja e përhershme në aktualitet dhe në histori, janë motivi kaq i shpeshtë e pothuaj obsesional, sa e ndeshim të stampuar dhe në shumë tituj librash, që nga ai i pari si p.sh. *Në rrugë dola* (1958), e pastaj më pas tek *Hapat e mia në asfalt* (1961), *Shtigje malesh e trotuare* (1965), *Udhëtoj i menduar* (1985), e në libra të tjerë të pas '90-ës si: *Pelegrini i vonuar*, *Lypësi i kohës*, *Vjen njeriu i çuditshëm*, të cilët, të tërë e kanë të pranishëm semantikën e udhës, të lëvizjes. Pa rënë në kurthin e influencës që mund të ketë ndikuar sindromi i kohës për artin e angazhuar, duhet treguar vëmendje për ta arsyetuar e për ta spieguar më thellë këtë zinxhir të pandalur të metaforës së udhëtimit, i cili, si dukuri estetike, kaq frekvente dhe në larmi formash e kumtesh poetike, i ka shoqet e rralla në letërsinë shqipe. Në këtë rast, besojmë se kemi të bëjmë me rishfaqjen e natyrshme të arketipit universal odisejan të *udhëtimit*, që në fakt, dëshmon prirjen e shtegëtimit dhe kërkimit të përjetshëm të njeriut, drejt të panjohurave e mistereve, brenda e rrotull tij.

Ky lloj udhëtimi centrifugal e centripetal, pra, së *brendshmi* (drejt thelbit të njeriut), dhe së *jashtmi* (drejt hapësirave të pafundme që e rrethojnë atë e ku ai ka një mision të caktuar), krijojnë gjithë atë atmosferë sovrane poetike, ku shndrijnë e thurren artistikish: si detaje nga më

jetësoret, ashtu dhe ato nga më të çuditshmet e më grotesket. Ky udhëtim ndihet i pandalur në aspektin e tipologjisë zhanrore (lëvroi poezinë, tregimin, novelën, romanin, dramën, shkroi publicistikë dhe ese, shqipëroi duke bërë të flasin shqip disa nga të mëdhenjtë e letërsisë botërore si Bërnsi, Bagricki, Pol Elyari...) Ndhjet gjithashtu ky lloj udhëtimit, apo kërkimi, në aspektin e tipologjisë stilistike: është i pranishëm stili lirik, por dhe ai epik, stili humoristik e satirik. Po kështu, ligjërimi i hapur, i drejtpërdrejtë, shpesh këmbëhet me atë tejet figurativ, deri dhe të ndërlikuar, në ato raste kur realizohet në të ashtuquajturën *gjuhë ezopike*, si p.sh. tek fabulat e tij aq të njohura, të cilat krijojnë parabola të mprehta e të guximshme, sa u bënë për njerëzit e asaj kohe referenca sfide. Ky udhëtim, shkon gjithashtu në diakroni dhe sinkroni të botës shqiptare, tek fshatari dhe dijetari, në stane dhe auditore, tek përditshmëria dhe të shenjtat që flenë nën dhe, tek gjestet sublime dhe paranojat donkishoteske të njeriut, tek ledhet e qëndresave dhe plojet e humbjeve në histori. Në këtë udhëtim, Agolli nuk harron të zbresë dhe tek protoletërsia shqiptare, pra, tek kënga popullore. Në librin e tij *Kënga e gjyshërve*, ai u ngjan atyre lulishtarëve të magjepsur të kopshteve të famshme babilonase, të endur mes luleve më të bukura, për të sjellë një tufë lirikash e baladash, pa i prekur ato në strukturat e tyre primare, autentike, por vetëm duke i shkundur paksa nga pluhuri i krijuar prej të mbeturit mënjane, si për t'i zgjuar e rifunksionalizuar.

Motivi i udhëtimit, ndeshur aq dendur në këtë krijimtari, ka për ekuivalencë dhe metaforën e pelegrinit, i cili është një figurë konceptuale dhe jo rastësisht mbartet dhe si titull i një përmbledhjeje poetike (*Pelegrini i vonuar*). Dihet se pelegrinët janë njerëzit e besimeve të thella, që kanë udhëtuar në shekuj e vazhdojnë të udhëtojnë, në shenjë nderimi e adhurimi drejt vendeve të shenjta. Ky raport, krijon marrëdhënie specifike tek pelegrini real e për pasojë, dhe tek pelegrini metaforik i poezisë. Ai ka prirjen e veprimt, të aksionit deri në vetmohim, për të mbërritur në destinacion, por është i pushtuar dhe nga meditimi, përkushtimi e thirrjet e pafundme të zërave të brendshëm. Në fakt, ky është dhe profili i kësaj poezie agolliane, e cila nuk shfaqet monokolor, por komplekse e shumëdimensionale.

Komplekse e shumëdimensionale shfaqet kjo krijimtari edhe për faktin se në aspektin estetik, megjithë besimet dhe utopitë e kohës, shkrimtari dinte t'i gjente hapësirat për ta shprehur lirinë e tij artistike, pikërisht në veprat e tij më të mira, të cilat vazhdojnë t'i qëndrojnë kohës, por dhe në ato që nuk i shpëtuan syrit dhe ndëshkimit të censurës zyrtare. Është pikërisht kjo arsyeja se përse vitet e pas '90-ës, e gjetën të përgatut Dritëro Agollin për t'i derdhur në disa libra

radhazi, ato që s`mundi t`i shkruante dot më parë, kryesisht motivet e përjetshme, universale dhe egzistenciale të njeriut, duke zbritur pra, në kufijtë delikatë e aq domethënës të dimensioneve metafizike.

Lëvizjet dhe kapërximet e mbara estetike, dihet që i bëjnë shkrimtarët e shquar dhe Dritëroi i bëri se është njeri prej tyre. Por ndërkaq, ato nuk i bëri dot ndonjëri që u ngut t`i hidhte baltë shkrimtarit në fillimin e viteve `90-të, i ankuar se vet nuk mundi të shprehej dot si duhej dikur, nga mungesa e lirisë, e kur ajo liri erdhi, u pa se nuk në fakt shkroi dot asgjë. Por poeti, siç e thotë gjithë humanizëm në një poezi të tij, e priti drejt e në gjoks këtë baltë dhe e bëri tokë dhe e gjelbëroi me pemë dashurie.

Dhe lexuesi shqiptar, besojmë se me po këtë kurorë nderimi e dashurie, ia çmon veprën këtij shkrimtari të shquar, apo këtij pelegrini të thekur, që nuk di të ndalet në udhën e tij së kërkuari, për të mbërritur tek e fundit, pra, për të zbuluar e zgjuar perlat e fjetura të fjalës shqipe, duke kryer kështu ritin e shenjtë poetik të adhurimit të tyre.

Dr. ELONA ÇEÇE

“KOMPETENCA KOMUNIKATIVE” E POETIT DRITËRO AGOLLI NË PËRMBLEDHJEN ME POEZI “LYPËSI I KOHËS”

Të diskutosh për kompetencën komunikative të një poeti apo shkrimtari nuk do të thotë të flasësh thjesht për gjuhën e veprës së tij, pasi kompetenca komunikative, në këndvështrimin sociolinguistik nënkupton aftësinë e individit për të komunikuar në kushte të përcaktuara nga situata dhe normat gjuhësore, shoqërore, psikike, pragmatike etj.³ pra, do të thotë që ta vështrosh gjuhën e veprës si një sjellje shoqërore. Dhe kjo për faktin se *teksti i shkruar, është një produkt gjuhësor tepër kompleks, ku takohen shkenca gjuhësore dhe jogjuhësore.*⁴ Pikërisht, përmbledhja, “Lypësi i kohës”, e poetit Dritëro Agolli, e cila është një bashkim i poezive të tri cikleve: “Lutjet e kabanës”, “Tingujt e gurit” dhe “Lotët e tokës” është fokusi i kësaj kumtese për arsye se kjo vepër të krijon mundësinë e një analize gjuhësore, jo vetëm për faktin se poezitë e saj janë poezi të reja, të shkruara kryesisht pas viteve ’90, por për faktin që kompetenca komunikative e poetit tashmë është e një niveli të lartë.

Përmes spektrit të funksioneve të gjuhës: **referencial, shprehës, metalinguistik poetik, mbartës, faktik**, mund të gjykojmë për “kompetencën komunikative”.

Funksioni fatik, i cili lidhet me kontaktin psiko-fiziologjik, pra me kanalën e komunikimit, realizohet posa poeti shkruan poezitë, posa vepra del në dritë për lexuesin.

Çdo poezi e parë në këndvështrimin sociolinguistik përbën një ndodhi gjuhësore, një *sekuencë të akteve gjuhësore të lidhura në kontekstin e një situatë shoqërore.*⁵ Por *gjuhësorja dhe jashtëgjuhësorja pleksen më dukshëm se kudo, pikërisht në atë që quhet kompetencë komunikative.*⁶ Përmes çdo poezie realizohet dhënia e një realiteti të jashtëm konkret, por dhe të përfytyruar.

Mjeshtëria e poetit shpërfaqet me *koherencën tematike*. Rrafshi filozofik që përfaqësohet me konceptet *kohë, jetë, ai historik*, që përfaqësohet me ngjarje reale, ngjarjet politike të viteve ’90 si dhe me figura reale, si Selam Musai a luftëtarët e lirisë; rrafshi estetik, që shfaqet me konceptet *e bukur, madhështore, e shëmtuar*; dhe së fundi rrafshi etnografik, që vjen përmes

³ Gj. Shkurtaj, *Sociolinguistika*, Tiranë, 1999, f.123.

⁴ T. Topalli, *Gjuhësi teksti*, Shkodër, 2011, f. 179.

⁵ Po aty.

⁶ Gj. Shkurtaj, *Sociolinguistika*, Tiranë, 1999, f. 127.

mendësisë që përshkon të gjitha ciklet, krijojnë universin shqiptar. Tema kryesore “Sfida e jetës mbi vdekjen” është arritur kryesisht nga tema të ndërmjetme të cilat janë në lidhje hierarkike me temën qendrore duke realizuar kështu **funksionin referencial**.

Në mënyrë të natyrshme, funksioni referencial është i pandashëm nga funksioni **shprehës (ekspresiv)**, që përcjell tek lexuesi vullnetin e poetit, gjendjen e tij shpirtërore, pra sjelljen shoqërore,

Çdo poezi, vjen si një shfaqje e funksionit **metalinguistik të gjuhës**, që lidhet me kodin e përdorur, Çdo mesazh është një shfaqje e një “rivelacioni”, të kodit mbi të cilin është formuar. Dhe çdo poezi bart një mesazh në vetvete, ka një me organizimin të brendshëm, përmes të cilave poeti ka shprehur kreativitetin lidhur me kodin. Këtu duhet të përmendim se autori e gërsheton bukur ligjërimin në vetën e parë, si hero lirik a në kuadër të dialogut, me ligjërimin në vetën e tretë. Me mjeshtëri poeti gërsheton edhe rendin e drejtë me atë të zhdrejtë, të cilët lidhen me **gjymtyrëzimin aktual** të vargjeve. Tema është përgjithësisht argument i njohur, *përmbajtja informative*⁷ ndërkohë që rema përbën atë që thuhet për temën p.sh.:

Veten time se kam dashur kurrë,

(Tema)

Të veçuar skutave mënjanë,

(Rema)

Tema, mbi të cilën është thënë diçka, shpesh përfshin edhe remën brenda saj: *Më ftuan në darkën e fundit, më fyen e pa gota më lanë; Që para teje të isha i mundur, një shëlg i prerë a një plep.*

Rëndom në poezitë e kësaj përmbledhjeje tema del në fillim të thënies pra, kemi një rend të drejtë (asnjanës). Por nuk përjashtohen edhe rastet e **rendit (të zhdrejtë), emfatik** kur rema i prin vargut p.sh.:

Ndaj s’është aspak çudi e madhe/ Të tretesh në këto livadhe...

Kjo dukuri, natyrisht, shoqërohet edhe me koherencën semantike, pra harmoninë mes domethënies së fjalës.

Domethëniet e fjalëve që lidhen në vargje janë kompakte, p.sh. fjalët: *kohë, vdekje, jetë, dashuri, çmenduri*, që vijnë me kuptimin e tyre të drejtpërdrejtë, si dhe fjalë të tilla si: *dimër, luftë, meduzë, vatër* etj., që përdoren në kuptim të figurshëm.

⁷ Gj. Shkurtaj, *Sociolinguistika*, Tiranë, 1995, f.135.

Si një rezultante e funksioneve të përmendura më sipër vjen **funkcioni poetik**. Në këtë kumtesë jemi përqendruar në faktin se në ç'sasi dhe në ç'mënyrë shfrytëzohen figurat sintaksore, si mekanizma të ligjërimit artistik, për të realizuar mesazhin eksplicit. Ajo që duhet të theksojmë këtu është se alternohen poezitë me mesazh të drejtpërdrejtë, ajo që kritikët tanë e quajnë “poezia e inercisë poetiko-estetike” me poezi, ku realiteti përthyeret në shëmbëllesa metaforike. Megjithatë poeti nuk është në opozicion me standardet tradicionale, gjë që vërehet sot te poetët e rinj, mund të themi se poezitë e përmbledhjes “Lypësi ikohës” i përkasin një stadi të ri të krijimtariae së tij. Mënyra se si përcillet mesazhi, dëshmon mjeshtëri edhe për faktin se autori shfrytëzon të gjithë arsenalin e figurave sintaksore.

Dritëro Agolli mjeshtërisht përcjell te lexuesi si **mesazhin e shkoqur (eksplicit)**, ashtu edhe **mesazhin e mbuluar (implicit)**. Për përcjelljen e këtyre tipeve të mesazheve poeti përdor dendur figurat e ndërtimit, ose ndryshe figurat sintaksore.

Konkretisht, në disa poezi, si: “Kallëza e Misrit dhe Gjembë”, “Çmenduria”, “E rëndë është jeta”, “Poeti dhe vdekja” etj. poeti përdor **inversionin**, (si një përmbysje të rendit të fjalëve ose të pjesëve të fjalisë, në një rend të kundërt nga ai që është në bazë të gramatikës).

Konkretisht vërejmë:

a. zhvendosjen e përcaktorit para fjalës që përcakton p. sh.:

Krenar ky Gjembë i Gjëlber mbushte sheshin/Dhe kallëzës së Misrit po i thoshte... /Atje ku kupë e qiellit tretet,/Me tokën shpuzë e lemeri,/Atje pa hallet e pa dertet, /jeton e liga çmenduri.

b. të kallëzuesit (emërori foljor) para subjektit veprues (kryefjalës) p.sh.:

E rëndë është jeta!- kushdo pa druajtje ta thotë,

E nxori në breg një të mbytur deti...

c. të një gjymtyre plotësuese, si p.sh. të rrethanorit:

Veç me vdekjen s'jam takuar kurr,

ndaj e pres nderuar në shtëpi,

Për respekt – një qengj manar në furrë,

Për humor – një shishe me raki.

Rëndësi poeti i kushton edhe përdorimit të pyetjes retorike, pa e shpërdoruar atë. Si një rrjedhë e përdorimit të veçantë të fjalive pyetëse, të cilat të japin përshtypjen e ligjëratës së drejtë, p.sh. në poezitë: “Inflacion në shpirt”, “Frymëmarrja e lumit”, “Ligjërimi i ujkut plak”, “Dhimbja e gurit”, “ Duke kërkuar fjalën”.

Përmes efektit që sjellin këto ndërtime sintaksore, si tërheqja e vëmendjes, si dhe tërheqja e lexuesit drejt një reflektimi, poeti përpiket të përcjellë dilemat e shoqërisë shqiptare të viteve '90. Për nga nga ndërtimi gjuhësor do të theksonim se ato janë të tipit tërësore, pasi rrokin gjithë strukturën e vargut, d.m.th. i referohen njësisë foljore.

Po ku ta gjesh një shteg për dalje, / Dhe si t'i lutesh Jezu Krishtit? (Ky inflacion s'ka kryq për falje, / Është inflacion i madh i shpirtit.

Natën merr frymë lumi si gjëja e gjallë, / Gjëja e gjallë që brigjeve e heshtur kullot, / Mes kësaj frymëmarrjeje të rrallë. / Pse vallë ty të pagjunit të derdhet një lot?

Po ju, të thinjur në librat e trashë, ju folklorist, kritikë, poetë e shkrimtarë. / Me honoraret që merrni nga bëmat e mia Brenda dhe jashtë, / A nuk gëlltitni më tepër se unë mujëra vicër, dele e gomerë? / Dhimbjen e brezave tanë, a mund ta kërkoni?

Heshtja ose reticensa, në kuadër të mesazhit implicit, radhitet me figurat e rëndësishme gjen një përdorim të gjerë në këtë përmbledhje, p.sh. në poezitë: “Një minutë zemërimi”, “Nga pleqëria”, “Shfajësimi i vetes”, “Një diktaturë”, “Çmimi i vetëvrasjes”, “Kolla të ka zënë”, “Bisedë me heshtjen”, “Guri i shenjtë”, “Çezmë e Radonecit”, “Peizazh me një të dehur”, “Vitin tjetër”, “Përjetësisht”, “Poeti dhe shpirtrat”.

Dhe vërtet, përmes saj autori ka mundësuar: ndërprerjen e ligjërimit para një fjale me ngarkesë emocionale, mungesën e përgjigjes në dialog, mungesën e një fjale a shprehjeje, kur i është lënë lexuesit ta marrë me mend, si dhe lënien jashtë të një fjale a shprehjeje, të cilat s'mund të përmenden.

Mos e kuptosh as hoxhën kur këndon, / Është hoxha vetë, apo magnetofon... / (Madje dhe vetë perëndia / Një ditë vdes nga pleqëria) / Ndaj s'është aspak çudi e madhe / Të tretesh në këto livadhe...

Për ta “sendërtur” realien, për ta bërë më të prekshëm realitetin poetik poeti shpesh përdor **apostrofën**.

Moj sorkadhe qafëgjata, Ku të zuri nata?; “Psalm i ri për tokën”, “Në ndërtesën e fatit”

Për të shprehur gjendjen shpirtërore në varësi të situatës shoqërore, poeti shpesh shfrytëzon **pasthirmën**, me anën e së cilës shpreh ndjenja të tilla si: habia, moskënaqësia, mosaprovimi. Gramtikisht, pasthirrma shfaqet në të tri pozicionet e mundshme: në fillim, në mes dhe në fund të vargut. “Inflacion në shpirt”, “Pa kuptim”, “Vdekja” “Prostituta”; “Të gjithë kërkojnë”; “Peshqit” p.sh.: “Ah, ç'bën, si vete burrë i zoti, / Do kemi shi a mot dëbore?”

“Inflacion në shpirt” / E mban tavanin e çarë, /Mos bjerë mbi shtratin tim.../ Ah, ëndërr e natës së marrë; Fanitur krejt pa kuptim! Ah, vdekja! Ç’ t’i bësh! E heshtur siç hesht errësira!

Shpesh nga tërësia e fjalisë bien disa fjalë në atë mënyrë që mund të kuptohet domethënia e tërësisë së mbetur. Do të theksonim se në këtë përmbledhje vargjet ku është përdorur **elipsi** shfaqen si fjali të paplota eliptike, pra u mungon folja këpujë e kallëzuesit emëror. Një përdorim i tillë është jo vetëm i kapshëm nga lexuesi, por edhe mjaft i fuqishëm për nga ndikimi emocional. “Mëdyshjet e njeriut”, “Larg bukurisë së dëborës”, “Malli i poezisë”, “Zvarritje ditësh”. P.sh.:

Njeriu, () një rob i halleve,

Njeriu, () një peng i dertit,

Njeriu, () lugat i lagjeve

Njeriu, () bandill i sheshit...

Sivjet jam i braktisur dhe i varfër,

Se dua dimrin () sofrabez dëbore.

Pemë e ullirit () mbi trupin e paqes

Dhe () qetësi.

Në mesin e natës

Vreshhta e fjalës

Zien poezi!

Poeti Dritëro Agolli në vargjet e tij krijon renditje të fjalëve pa ndërlidhjen e tyre gramatikore, lidhëzën, gjë që i jep ritëm vargut, koncentron mendimin përmes theksimit të disa fjalëve, për të cilat ai kujdeset që të kenë një rëndësi të vecantë. Për këtë figurë (**asindetin**) do të theksonim se lidhëzat mungojnë si në ndërtimet që shprehin raporte barazie:

Të diel me natë

Të ngrihesh (dhe) të vish;

Të vish nga të vish,

Fushës të mos vish,

Fusha ka ushtarë,

Futesh- i fut zjarrë.

“Të diel me natë”,

ashtu edhe në ndërtimet që shprehin raporte varësie, p.sh.:

Të diel me natë

Të ngrihesh (dhe) të vish;

Të vish nga të vish,

Fushës të mos vish,

Fusha ka ushtarë,

Futesh- i fut zjarrë.

Kjo vërejtje vlen edhe për përdorimin e **polisindetit** i cili shfaqet me me renditjen e lidhëzave që nga ana gramatikore, nuk janë të nevojshme: “Psalm i ri për tokën”, “Ju desha”, “Në ara pas shiut”. Lidhëzat në vargjet: *Ju desha dhe akoma për ju dashurinë/ Në vatër s’e ka shuar shpirti im/ Po s’dua t’ju lëndo, t’ju marr qetësinë,/ Po s’dua t’ju mbush zemrën me trishtim.), por edhe parafrjalët (Kjo është e para pirje e madhe./ Me ëndrra, pa shishe dhe gota./ **Tek** ecin të lagur qengjat larg në livadhe./ **Tek** priten të shtrohen pas shiut sofrat e plota, shërbejnë për të lidhur vargjet- pjesë fjalish.*

Ndaj me bindje do të thoshim, se poeti ynë kujdeset që informacionet që na jep përmes poezisë, të kapen jo vetëm përmes paraqitjes gjuhësore, semantike, por edhe përmes elementeve teknike të ndërtimit. Pikërisht, figurat sintaksore, mbartin peshën kryesore në realizimin e funksionit poetik.

Duke parë nga këndvështrimi psikosocial, funksioni **mbartës (konativ)**, që lidhet me destinarin (lexuesin), apo me atë që synon poeti të nxjerrë prej tij, në rastin tonë nuk realizohet dukshëm, pasi komunikimi është i njëanshëm. i adresuari (lexuesi) duhet të shfrytëzojë për dekodimin rrethin e njhurive të tij.⁸ Pra, duke depërtuar te “enciklopedia e marrësit”, që e njeh mirë problematikën e viteve ’90, mund të themi se edhe ai e ndjen se në zgrip të kohës ashtu si poeti mund t’i kundërvihet monotonisë, varfërisë, mëdyshjes, dëshpërimit, dobësisë e madje vetë vdekjes.

Është e natyrshme të pranojmë dallimin mes *intentionis auctoris* (qëllimit të autorit), *intentionis lectoris* (qëllimit të lexuesit) dhe *intentionis operis* (qëllimit të veprës),⁹ por nga interpretimi që i bëjmë kompetencës komunikative përmes funksioneve të gjuhës, mund të themi me bindje se në përmbledhjen “Lypësi kohës” qëllimi i autorit është që jo vetëm t’i trgojë, por dhe ta udhëheqë lexuesin në një pozitë aktive, ta implikojë në zbulimin e domethënies. Kompetenca komunikative

⁸ T. Topalli, *Gjuhësi teksti*, Shkodër, 2011, f. 179.

⁹ M. P. Pozzato, *Semiotika e tekstit*, Shblu, Tiranë, 2005, f. 117.

dëshmon për **riciklimin e modelit të poetit misionar** që pas viteve '90 nuk merr shtysë vetëm nga rrethanat jashtëletrare, por ushqehet së brendshmi edhe prej mjeshtërisë së tij.

Së fundi, mund të themi se të gjitha funksionet e gjuhës që u përshkruan më sipër, lidhen me regjistrat e gjuhësorë. Në veprën në fjalë, ky aspekt dëshmon ndryshorët sociologjikë, si: klasën sociale dhe interesat e vetë autorit.

“Kompetenca komunikative” në këtë përmbledhje dëshmon një pushtet të padiskutueshëm të poetit, qoftë për brezin e krijuesve, qoftë atë të lexuesve. *Misionet e mëdha nuk lypen, nuk dekretohen, ato ngarkohen përmes talentit të njëmendët e një morie rrethanash të tjera letrare e jashtëletrare.*¹⁰ Në përsiatje të kësaj thënieje do të thoshim se është pikërisht, ky misioni i madh prej poeti, prej shqiptari për Shqipërinë, që premtion edhe jetëgjatësinë e tij si krijues.

Bibliografia

Agolli, D., *Lypësi i kohës*, Eldor, Tiranë.

Pozzato, M. P., *Semiotika e tekstit*, Shblu, Tiranë, 2005.

Shkurtaj, Gj., *Sociolinguistika*, Tiranë, 1999.

Topalli, T., *Gjuhësi teksti*, Shkodër, 2011.

Çiraku, Y., *Shqyrtime kritike nga historia e letërsisë shqipe*, Tiranë, 2011.

¹⁰ Y. Çiraku, *Shqyrtime kritike nga historia e letërsisë shqipe*, Tiranë, 2011.

Dr. JONELA SPAHO

DIMENSIONI I DHEMBJES DHE I HUMANIZMIT NË UDHËTIMIN POETIK TË POETIT NDËR VITE

Leximi i poezisë së Dritëro Agollit, shkruar dhe botuar përreth një harku gjysmëshekullor, vazhdimisht, të jep idenë e një udhëtimi të vazhdueshëm, gjatë të cilit, jo vetëm poeti, por edhe lexuesi duket sikur përjeton, në të njëjtat nivele, ndryshueshmëritë e gjendjeve shpirtërore, dhimbjet, vuajtjet, gëzimet dhe brengat e krijuesit. Kjo është arsyeja përse kjo poezi është pëlqyer dhe vazhon të pëlqehet, duke u receptuar gjerësisht nga lexuesit e moshave të ndryshme, sepse brenda universit të tij poetik gjen të gjitha etapat e jetës njerëzore në dialektikën e tyre, të përshkruara prej një filozofie, sa thjeshtësisht jetësore, aq edhe humane.

Kur ndjek këtë rrugë të gjatë të poetit, në vazhdimësi, gjithashtu, kupton se pjesë e sendërtimit të botës së tij artistike, është realiteti njerëzor gjithëkohor. Fuqia poetike e tij, përmes rrezatimit të brendshëm vë në lëvizje çdo gjë, duke u përpunuar në laboratorin e vet poetik. Në poezinë e tij gëlon një frymëmarrje epokale, një frymëmarrje njerëzore, e cila mban gjallë nervin poetik duke tendosur e çtendosur vargun, në varësi të dramacitetit që përjeton subjekti lirik i poezisë së tij.

Nëse krahasojmë poezitë e vëllimit të parë, “Në rrugë dola” me atë të fundit, “Fletorka e mesnatës”, shohim një poet dimension i kryesor i të cilit është humanizmi, dashuria për njeriun, një poet i cili nuk i ndryshon strukturat e vargut sa herë ndryshojnë stilet poetike, por ruan gjithnjë individualitetin e vet të papërsëritshëm, të tipizuar nga thjeshtëia, harmonia dhe muzikaliteti i vargut e për më tepër nga brendia emocionale, e cila, pavarësisht nga ndërrimet e sistemeve, në thelb reket të jetë vetvetja. Këtu nuk është fjala vetëm për probleme që kanë të bëjnë me historinë, me ideologjinë, me metamorfozat politike, por bëhet fjalë për atë poezi e cila e specifikon dukshëm poetin në dimensionin kryesor të tij, poezi e cila ka të bëjë me njeriun si mikrokozmos, me shqetësimet dhe brengat e tij të përditshme, me çastet e shkurtra, apo me intervalet e gjata njerëzore, kur shpirti i njeriut ndriçohet, hapet drejt së vërtetës, ndaj të pathënës, ndaj të bukurës, ndaj dashurisë, madje dhe ndaj vdekjes.

Duke e ndjekur poezinë e tij nëpër kohë, shpesh të ndodh që të hasësh një poet të trishtuar, të vetmuar, ndonjëherë të lodhur, por asnjëherë të mposhtur, sepse në të gjitha rastet ai

kërkon një dalje drejt një shtegu që ai e di se diku ekziston, një shteg nëpërmjet të cilit ai kërkon të vendosë një balancë midis shpirtit poetik dhe shpirtit njerëzor në përgjithësi, një harmoni të individit me botën ku jeton. Bukuria e kësaj poezie qëndron në bukurinë mitike të shpirtit dhe në fuqinë e urtësisë, e cila vjen si rezultat i dialogimit të gjatë me vetveten:

“Unë jam prej kohësh pelegrin, / Shtegtar i karvanit të humbur, / Dhe bart në kurriz një premtim, / Të dhënë në hirin e gjyshërve të mundur”.

Ky pelegrin ka kohë që udhëton, u bë gjysmë shekulli që udhëtimi i tij vazhdon drejt finales, drejt premtimit, drejt dritës, atje ku fjala poetike arrin të japë kumtin më të vërtetë të kohërave. Në këtë udhëtim, nëpër vite, nëpër kohëra të turbullta, të diellta apo me mjegull, poeti ecën si një pelegrin duke duruar mundimin e torturueshëm deri në amëshim, për të ndriçuar veten dhe të tjerët, sepse vetëm një poet e di se pa ndriçuar dhe shenjtëruar veten, nuk mund të ndriçosh e shenjtërosh të tjerët. Nëse poetëve ju ngarkohet shpëtimi i botës, ndoshta atëhere bota është vërtet e shpëtuar. Poetët mund të shpëtojnë botën. E para ishte fjala që krijoi botën, e para është fjala në poezi për t’i dhënë frymë dhe sendeve dhe drurëve dhe tokës.

D. Agolli e sheh veten dhe të tjerët në dualitetin e përjetshëm njerëzor; e sheh njeriun si ëngjëll dhe si djall, si Judë dhe si Krisht, si dritë dhe errësirë, si human dhe gjakatar dhe arrin në përfundimin se këto shtresime të kundërta, në luftën e tyre të përjetëshme, me triumfe e disfata të pjesshme, krijojnë njeriun e vërtetë: *“Hesht në prehje, rend në lodhje, / Njërin ndreq e tjetrin prish, / Kur mbledh lule dua rrodhe, / guvë e jetës Judë e Krisht”.* Nëpër këtë dualitet udhëton njeriu duke shkuar drejt vdekjes: *“Kalojmë një shteg, kapërcejmë një prag, / çdo ditë udhëtojmë e vdesim nga pak”.* Kështu, dy metaforat e tij më të pëlqyera, me të cilat ai përfiton një simbiozë poetike, janë jeta dhe vdekja, që ai preferon t’i quajë udhëtimi dhe vdekja. Udhëtimi për të është mënyrë e qenësisë individuale dhe kolektive, mënyrë e përsosjes dhe formimit të njeriut. Çdo gjë në poezinë e tij është në lëvizje. Kjo poezi mund të konceptohet si afresk i gjallë prej të cilit, pasi e mbaron së sodituri, të krijohet ndjesia e lëvizjes. Atje nuk janë vetëm retë që shtegëtojnë, dielli që fshihet pas malit në perëndim, zogjtë që nisen në fluturim, stinët që i lënë vendin njëra - tjetrës, dëborë që i lë vendin blerimit, por në poezinë e tij janë në një udhëtim të përjetshëm mendimi, ndjenja dhe e bukura. Ky udhëtim që nis prej vetvetes dhe më pas universalizohet si udhëtim i krejt jetës, deri të vdekja, ngërthen në vetvete një mal simbiozash që shoqërojnë dhe i japin kuptim kësaj lëvizje. Me udhëtimin ai lidh pritjen mallin, shpresën, zhgënjimin, gëzimin, vuajtjen, dhimbjen, etj. Edhe vdekjen ai e quan një udhëtim, një largim drejt një hapësire dhe

kohe tjetër, që ndryshojnë nga realja, po që shpesh autori, me sensin e tij të humorit të përhershëm, rreket ta kthejë në një përmasë reale dhe t'i japë dimensione si ato të botës njerëzore.

Bashkë me njeriun udhëton dhe koha, ndaj uni i tij poetik shpesh të jep idenë e tagjicitetit, kur ai sheh veten *“pelegrin të vonuar”* dhe *“lypës të kohës”*. Në të dyja rastet subjekti lirik është fatkeq, sepse e ka të vështirë të gjejë udhën dhe kohën, kur jeta nuk i premtun dhe shumë, por shpresa është ajo që ngrihet e fuqishme për të sfiduar pengesat dhe për t'i ndriçuar rrugën. Në labirintin e ngatërruar të jetës ka shumë dhimbje, por *“megjithatë nuk është e keqe jeta”*, madje mirë do të ishte të mos kishte dhe natë, se jeta natën i përngjan një fluturë që djeg veten rreth llambës, pa kuptim. Poeti mendon se dhimbja e fisnikëron njeriun. Përvojat e dhimshme dhe përballimi dinjitoz i tyre vetëm se e fisnikërojnë njeriun prandaj ai kumton me përvojën e qënies së ndjeshme njerëzore: *“Kur njeriu nuk ndien as mall, / As brengë, as dhimbje, / Nuk ndien as gaz, as hidhërim, as shpresë, / Një gjë ju them me ndershmëri dhe bindje, / Lëreni të vdesë”*. Ky është pranimi më i sigurtë dhe më i bukur i jetës, sepse jeta e tillë është krijuar dhe e tillë do të vazhdojë, që njeriu përmes përvojash të ndryshme shpirtërore të formojë relievin e tij shpirtëror, sepse dhimbja dhe vuajtja janë daltat që gdhendin portretin moral të tij.

Duke lexuar me ëndje këtë poezi të patjetërsueshme dhe origjinale, sendërton çast pas çasti një mozaik të brishtë dhe të bukur, që nuk është gjë tjetër veçse mozaiku i dhimbjes dhe vuajtjes njerëzore, i dhimbjes individuale dhe universale, që e ndjek njeriun që prej lindjes deri në vdekje: *“Gjithmonë më bren në shpirt trishtimi”*, shprehet në një çast të jetës së vetë poeti, atëhere kur përvoja e pakontestueshme njerëzore dhe jetësore ka treguar se sa i gjatë është mjerimi në jetën e shkurtër. E në këtë jetë të shkurtër njeriu përshfaqet më të gjitha dualitetet e veta, dilemat, mëkatet dhe shfaqjet e turbullta të natyrës njerëzore, duke u bërë *“ujk me thonj të gjatë në jetën e shkurtër”*. Po kush e shkakton dhimbjen në jetë sipas poetit? Dhimbja është kudo si pjesë e pandarë e jetë njerëzore, dhimbja mund të shkaktohet dhe prej gjërave të thjeshta, të rëndomta, atyre që lidhen më përditshmërinë tonë si: ankimet e paprera që përbëjnë ritmin monoton të jetës, dhimbja kur sheh një qen të braktisur apo një zog të vetmuar në degë etj., ashtu siç mund të krijohet ajo dhimbja e madhe prej gjërave kardinale në jetë si humbja e bukurisë apo zvenitja e saj, prej shëmtisë që servir realiteti i hidhur, prej celulave gri që vdesin çdo ditë e ne nuk mund t'i shohim, prej ditëve të djegura më kot: *“Ah sa ditë kam djegur të ngrohësja, / mërztur prej ngricave”* etj. Poeti vajton si pelegrin i munduar që i kanë ngatërruar udhën për të arritur karvanin (*udhëtar në vendin e shpresës së thyer*), i trishtuar për miqtë e remë *“që*

shtireshin si ëngjëj të dashur”, për ëndrrat e prera, fëmijët që janë larg rrugëve të botës. Pleqëria që troket në derë dhe nuk vjen për mirë etj, prandaj ai ndjen në retrospektivën që i bën shpesh jetës se: *“jam tharë në hijen e trishtimit”*. Por, në këtë pashpresmëri vezullon një dritë, një mendim, një sinjal ose një shpresë e vagëlluar se ndoshta gjithçka mund të ribëhet edhe njëherë. Është ndoshta kujtimi i gjërave të dashura dhe të bukura në jetë, që lënë pas një vazhdë të shndritshme dhe në këtë dominim trishtimi na kujtojnë *“zjarret që digjen e tymojnë në gërmadhat e shpirtit të djeshëm”*.

Nëse përqëndrohemi te shprehja e dhimbjes dhe trishtimit njerëzor në poezinë e Agollit, ai që të bie në sy është jo vetëm zgjerimi, por edhe evoluimi i motiveve të trishtimit dhe dhimbjes. Në poezitë e hershme të poetit, para viteve '90, shkaku i trishtimit lëviz brenda një qarku më të kufizuar dhe kjo për disa arsye që vinin jo vetëm prej pengesave të cenzurës së kohës, për të shmangur shfaqjet dekadente të ekzistencializmit dhe trishtimit në poezi, por dhe prej moshës së poetit, e cila duke qënë më e re, më vitale, ofronte më pak trishtim. Trishtimi në këto poezi është i lehtë në dukje, por brenda vargjeve ndjen dimensionin human të qënies, e cila trishtohet për dashurinë e humur, për raportet e tij me ndjenjën e dashurisë (*I përndjekuri i dashurisë*), për shtëpinë e dikurshme në të cilën sot nuk është më dhe një dritë e nderur i kujton se aty jeta vazhdon etj.

Në poezitë e vëllimeve para viteve '90, autori duket se i ka shpallur luftë armikut më të madh të njeriut, pleqërisë, e cila vjen ngadalë, pa u kuptuar dhe të rrëmben ditë për ditë, por autori me notat e një humori të këndshëm duket sikur e shpërfill dhe e tall atë: *“S'trembem nga kjo shtrigë, / Çiften do ta mbush sërish me vargje, / Le të shtiret gjoja se s'ka frikë, / Jam betuar s'do ta le në paqe”*. Ndërsa në poezitë e mëvonshme, ai vazhdon të mbajë të njëjtin qëndrim stoik ndaj pleqërisë, duke e pranuar atë si një ligj njerëzor dhe universal dhe duke anatemuar të këqijat e saj. Por, e rëndësishme, sipas tij, është që njeriu të jetë i denjë edhe në vdekje, sepse edhe vdekja është dituri, ashtu si dhe vetë jeta: *“Tani më duhet të mësoj edhe shkopin mirë, / Për t'u mbështetur kur të dal në mëngjes, / Pastaj më pret një mësim pak më i vështirë, / Të mësoj dhe të vdes”*.

Poeti vazhdon i paepur të ndjejë vitalitetin në shpirtin e tij e të thërrasë me forcë *“jam një këmbanore me këmbanë”*. Mesazhi është: jam i gjallë për të kumbuar dashurinë njerëzore përmes vargjeve të mija. Ai deklaron se pavarësisht moshës dhe viteve, pavarësisht lotit të pa zë që i zbret tinëz në faqe, fuqia e fjalës poetike të tij arrin të përcjellë mesazhe dhe kumte universale,

për të tjerët. Ai e sheh vdekjen me doza humori, si një diçka e pashmangshme para së cilës njeriu është i pafuqishëm, dhe si në përrallat e lashta populllore kërkon ta bëjë atë të natyrshme si një bashkëudhëtare të njeriut, si nje element të cilin njeriu edhe mund ta sfidojë edhe mund ta tallë. Vdekja për Agollin nuk është humbje e pazëvendësueshme, sepse e pranishme është dhe përjetësia: *”Po kur të jesh mërziur shumë, / Në raft të librave kërkomë, / Atje i fshehur do të jem unë në ndonjë raft a ndonjë shkronjë”*, i drejtohet ai njeriut të afërt, duke dashur të japë kumtin se dhe në vdekje poeti është i gjallë, se dhe në vdekje ai ngre një urë për të lidhur dy brigje, një dritë për të ndriçuar natën e errët, një varkë për të shpëtuar botën si Noeja bibliik.

“O zot kur fund t’i japësh botës, / Provomë e mua sa më shpejt, / Po ngrita varkën si të Noes, / Gjeni mbi Noen jam vërtet”.

Mjafton ky varg për të ndriçuar rrugën ku ka ecur një poet, qëllimin dhe misionin që ka marrë përsipër të kryejë dhe që më mirë se kurrë e ka kuptuar në zenitin e jetës së vetë. Ndaj me të drejtë ai mund të cilësohet si shkrimtar i përmasave të mëdha, shkrimtar i dhimbjes dhe i filozofisë jetësore e sidomos asaj shqiptare. Një njeri që kërkon rivalizim dhe me shpëtuesit bibliikë të botës.

Përmes udhëtimit shpirtëror të poetit të pranishme shpesh janë kujtimet, të cilat edhe pse e bëjnë melankolik, i krijojnë ndjesi të ëmbla dhe të bukura. Diku një burrë i pjekur ecën në rrugicën e shkollës dhe kërkon me mall shoqen e bangës, me fjongon e gjelbër që tani s’është më. Fjongoja e gjelbër e fëmijërisë është filli që lidh një nga një kujtimet e një burri në moshë të pjekur: *“Sa ujë ka shkuar nga malet në det, / Kujton se një fjongo e gjelbër të pret?”*. Diku tjetër, kujtimi nëpërmjet ëndrrës e çon te ndjenja e kaluar, te ndjenja e bukur që nuk është më. Kujtimi është i bukur, por kujtimi është dhe dhimbje kur krahason kohrat dhe, me sa duket, kjo përbën dhimbjen më të madhe të poetit: *“Pastaj në pasqyrën kristal një fytyrë, / E vyshkur me rrudha shumë, / Dy lotë prej plaku me flokët me lyrë, / Dhe ky isha unë...”* E dhimbshme është koha që ikën, por nëse njeriu ka jetuar me nder dhe dinjitet dhe lë pas një emër të mirë, atëhere qëllimi i jetës është realizuar: *“Kam jetuar ngaherë me nder, / Dhe dorën kurrkujt s’ia kam shtrirë, / Tërë jetën kam pasur një defter, / Dhe në të kam shkruar fjalën e mirë”*.

Kjo është finalja e jetës së poetit, e artit të tij, që edhe përmes vuajtjeve, dhimbjeve dhe dëshpërimeve me të cilat na sprovon jeta, ashtu dhe përmes gëzimeve që ajo na dërgon, të arrijë të mbetet mbi të gjitha njeri dhe fjalës së tij t’i japë fuqi mitike, për të përcjellë përherë mes njerëzve “Humanizmin”.

Përmes dhimbjes letrare që arriti të shprehë, Dritëro Agolli, ne kemi mundur të kuptojmë vlerën e mahnitshme të gjuhës, finesat e saj të brendshme që vetëm një mjeshër i fjalës mund t'i bëjë të ditur. Për këtë arsye poezia e tij do të jetë vazhdimisht e receptueshme gjerësisht, sepse çdo qenie humane gjen brenda saj filozofinë e jetës, shpalosur kaq bukur përmes vargut të mrekullueshëm poetik.

Bibliografi

Agolli, D., *Në rrugë dola*, Tiranë, 1958.

Agolli, D., *Hapat e mija në asfalt*, Tiranë, 1961.

Agolli, D., *Udhëtoj i menduar*, Tiranë, 1995.

Agolli D., *Pelegriini i vonuar*, Tiranë, 1993.

Agolli, D., *Lypësi i kohës*, Tiranë, 1995.

Agolli, D., *Lutjet e Kambanës*, Tiranë, 1998.

Avdyli, M., *Studime për Agollin në Kosovë*, Tiranë, 2006.

Elsie, R., *Histori e letërsisë shqiptare*, Tiranë-Pejë, 1997.

Elsie, R., *Një fillim dhe një fund*, Tiranë, 2002.

Rahmani, K., *Letërsia bashkëkohore shqiptare*, Prishtinë, 2006.

Shala, K., *Shekulli i letërsisë shqipe*, Prishtinë, 2006.

Dr. KOÇI PETRITI

MAGJISTAR I FJALËS POETIKE

Dritëro Agolli është magjistar i fjalës poetike. Poezia e tij është e nivelit të poetëve që ka përkthyer, veçanërisht e poetëve rusë që dhe herë-herë i ka dritërorizuar, sikundër edhe është ndikuar me Bagrickin, Eseninin etj.

Asnjëri prej poetëve tanë, në historinë e letërsisë shqipe, nuk e ka shfaqur veten në harkun e vet poetik, në moshën që ka sot D.Agolli, me këtë ndjeshmëri liriku, me këtë freski dhe forcë jetësore vargu, me këtë thjeshtësi monologimi, me këtë sens filozofimi, origjinaliteti dhe identiteti, shenjë kjo e vitalitetit që nuk shteret.

Vëllimet “Pelegri i vonuar”, ”Lypësi i kohës”, ”Vjen njeriu i çuditshëm në jetë”, janë krijime të asaj periudhe, që është quajtur ”mosha e dytë e poetit”.

Kur për Martin Camajn kam thënë: “Poezia kalon nëpër moshën e poetit. Kufijtë mes fëminisë dhe rinisë nuk dallohen. Kufijtë mes rinisë dhe burrëritit nuk kanë sinor. Burrëria brenda pleqërisë vjen si mbasditja e tretur në muzg e pastaj e muzgut në natë” – këtë kam patur parasysh edhe për poetë të tjerë.

Ndërsa për Dritëro Agollin mund të flitet ndryshe. Tre librat që përmendëm janë libra që, siç rrëfëhet ai vetë, “japin lëvizjet dhe lëkundjet e një përmbysjeje të madhe shoqërore e një botkuptimi dhe psikologjie, e një kontakti me rrjetin elektrik, nga del një shkrepimë e cila përcëllon trupin dhe fytyrën e poetit”. Kjo krijimtari e pas Nëntëdhjetës riafirmon dhe ridimensionon poetin, i cili sa më tepër moshohet, aq më shumë sensibilizon plisin dhe barin, gurin dhe drurin, plepin dhe qershinë, qiellin dhe tokën, udhën dhe bulevardin, kafshët dhe insektet, lulet dhe zogjtë. Të gjitha këto i rimerr me një ndjeshmëri të re për të shprehur mallin dhe trishtimin, ëndërrimin dhe zhgënjimin, çastin dhe përjetësinë, përvojën dhe mençurinë, njeriun që e ka himnizuar jetën me ngjyra euforike të një entuziazmi revolucionar dhe të zhgënjyerin e të tjetërsuarin e tanishëm, që e zhbiron realisht atë deri në dhimbje, deri në skajshmërinë tronditëse të vetvetes që po pleqëron. Për të kuptuar thelbin e këtij libri mjafton të marrësh vjershën “Tharja”.

Është nga ato vjersha që mund të të kalojë pa u vënë re, ashtu siç mund ta bësh pikë referimi të poezisë së thjeshtësisë mallëngjyese dhe tronditëse .

*Unë jam tharë si trari në hijen e murit,
Jam tharë në hijen e trishtimit,
Por do të kthehem tek ti kur të ngrihesh prej gjumit,
I raskapitur krejt prej mundimit.*

*E di, asgjë s'ke ç'të bësh, tani jam i tharë,
Një pemë e zhveshur prej gjelbërimit,
Megjithatë pak nga lëngu yt kam për të marrë,
Unë, ky tra i tharë nën murin e trishtimit.*

Kemi folur me fjalë të zhurmshme dhe kemi bërë poezinë e zhurmshme. Ajo u kthye në vetëtharje të poezisë së vërtetë, në sterilitet. Po ja, përmes këtij asgjësimi dhe shkretimi të vjershërisë sterile dhe bërtitëse, ku ngrihet, si bari i ri mbas kositjes, poezia e “moshës së dytë”, si “Tharja”.

Dru i gjelbër, dru i zhveshur prej gjelbërimit, dru i tharë nën hijen e murit të trishtimit. Katër herë në tetë vargje theksohet “tharja”. Vini re hapësirën jetësore dhe figurative, sfondin dramatik dhe interpretimin emocional që merr krijimi i përcjellë nga dy vargjet e fundit :

*Megjithatë pak nga lëngu yt kam për të marrë,
Unë, ky tra i tharë nën murin e trishtimit.*

Dhe po t'i biesh pas kësaj përcjelljeje, shkon te vargjet e vjershës “Letër”:

*Çdo natë të shtrihesh në të njëjtin shtrat,
Dyzet vjet të njëjtin varr e të njëjtin fat.*

Poeti, ky tra i tharë në murin e trishtimit, mbasi ka bërtitur tek vjersha “Mos ma kujto”, “mbështetur pas murit me zemër të vrarë, me duar të lidhura...në çaste të hidhura”, shkon pastaj tek i zhgënjyeri nga miqtë, që shtireshin ëngjëj të dashur, shkon te poezia “Trishtimi” dhe monologon tërë natën:

*Ku vete s'e di, veç s'dua të kthehem
Sërishmi në rrenat e jetës,
Diku në një skaj të largët do prehem
Me qafën e futur në jakën gri të xhaketës.*

Në çdo krijim në pak vargje është njeriu që nuk fle dot, që s'ka me cilin të gdhihet e natës i fshihet, njeriu që befasisht e fare thjesht, me po atë varg që i ka kënduar një çasti sublim, i

këndon edhe tryezës. E në këtë rast, të ngjan se ka përballë Bërnsin që e ka përkthyer dhe Bërnsi po ia bën “Bromp” me përkthimin e Lasgush Poradecit: *Ja shishja dhe një mik dhe pi /...Shijoje grimën o njeri, / shijoje para se të vdesësh / se kokëforta lumturi / nuk vjen gjithnjë kur ta thërresësh...*

E ky poet shqiptar, duke përpjekur gotën me poetin skocez, thërret:

Ta bëjmë botën krejt përshesh / të dalë e ku të dalë...

Pastaj: *Të derdhem në trimëri / të dalë e ku të dalë / se trimërinë gjer tani / e patëm pak të rrallë...*

Dhe daullet që legjendarizuan trimërinë heshtin. Skematizmi pësoi plasaritje. Ndryshe nuk do të vinte me këtë nur sinqeriteti vargu: *Dua dhe pres një ditë / të nisë çdo gjë nga fillimi...*

Dritëro Agolli ka aftësinë që t’i japë jetë, ta animizojë deri në befasi sendin. Edhe nga qepa nxjerr poezi, nga zhuzhaku e bubuzheli dhe nga sendet e një njeriu të vdekur vetmuar. E nga shembje kishash shembësit mëkatar i këlthet: *Mosni, or njerëz / se guri do të jetë më i rëndë / kur kishat t’i ngrini sërishmi...*

Befasohesh me vjershën “U rrahën pleqtë”. A na shkon ndërmend të rrihen pleqtë? Fëmijët po. Rivalët doemos. E gratë patjetër. Ja, edhe pleqtë.

Këto vjersha të kapitullit “ Malli dhe trishtimi “ janë larg euforisë dhe lustrës. Në vjershën “Duke vajtuar” autori vetërrëfëhet: *Më fal, o vend i bekuar / ndaj teje dhe unë / fajin s’e kam aqë të pakët...*

Alternativë interpretimi për tekstin “Rapsodi”

Tani le të ndërtojmë një alternativë interpretimi të tekstit "Rapsodi". Fjala, e cila na jep mundësi të ndërtojmë një tekst paralel, është leksema "**hejbe**", (*mbushje dy hejbe me këngë labe....*). Që këtë nis imazhi i shtegtimit, i udhëtimit të këngës nga visi në vis, nga koha në kohë, nga brezi në brez. Kjo fjalë, sado e një përdorimi "bukoliko-gjeorgjik", është po aq moderne dhe figurativisht i përgjigjet thënies së një teoricieni të tekstit poetik, se fjala e poezisë moderne është një kuti e Pandorës, ku është mbyllur virtuoiziteti i gjuhës.

E gjithë poezia në fjalë i nënshtrohet diktatit të kësaj fjale-kyç. Hejbetë janë valixhja tradicionale e shtegtarit katundar që shkon në qytet, e kurbetçiut që shkon pas karvanit. Kënga në këtë rast është lëndëzuar. Duke ndjekur udhën që të dikton figura-hejbe mbushur me këngë, i gjithë procesi i shtegtimit të këngës nga visi në vis, nga brezi në brez, nga koha në kohë, **kalon nga abstragimi në lëndëzim, nga lëndëzimi në shpirtëzim, nga shpirtëzimi në personifikim.**

Kënga-emër abstrakt bëhet lëndë konkrete, send i vënë në hejbe. Sendi shpirtëzohet, metaforizohet. Dhe këngët bien erë plumb e erë predhë, erë prush dhe erë brengë, erë dushk e lulëshqerrë.

Në sytë tanë shpaloset një peisazh i përfytyruar jete e lufte. Metafora e këngës shtegton nëpër një reliev çukë më çukë dhe mbi malet e përpjetë, mardhur bore e djegur vape. Foljet e vjershës përcjellin këtë imazh veprimi e relievi nëpër të cilin udhëton shtegtari: *i mbushe, i more, i zbraze, i përcolle* deri në personifikimin "*shkoni, bija, merrni viset*". Këngët kanë marrë bekimin si një bijë, që përcillet larg e larg mërguar, shtatë male kaptuar. Jemi gjithnjë nën fokusin e një fjale që krijon imazhe. Përsëritja tri herë e fjalës "hejbe" e thekson pozitën kyç të saj në këtë tekst. Kështu kemi arsye ta lidhim këtë procesion shtegtimi edhe me realitete të tjera, si transmetim tradite, si shtresim kulturor të Palimpsestit kulturor popullor e më gjerë, duke e lidhur me shtegtimin e eposeve. Procedimi i përcjelljes së këngës, i përcjelljes së kumtit të brezit në sosje tek brezi që këndellet, ka të bëjë me natyrën bartëse e përcjellëse të fjalës shqipe, siç sugjeron edhe poezia "Fjala" e Camajit:

*Në fjalë sqarohen qiell e dhe bashkë,
Ajo është një **strajcë** e në të mundemi
me bartë stinët e motit akull e zjarrm.*

Përcillet kumti i këngës, i fjalës (te një autor nëpërmjet leksemës "hejbe", tek tjetri nëpërmjet leksemës "strajcë").

Vite më parë, kur poema "Nënë Shqipëri" botohej në njëqindmijë kopje, komentohej e i mësoheshin vargjet përmendësh nëpër shkolla e universitete; unë, pavarësisht pompozitetit dhe ashkut propagandistik, që kumtonin e përcillnin prej saj; në komentet e detyruara programore, ndalesha te "*këmbët e zmadhuara nga ecja e mundimi*".

Nëse thamë që fjala bërthamë te "Rapsodi" është fjala "hejbe", tek poema "Nënë Shqipëri" kemi pasazhin "*këmbët që u zmadhuan nga ecja e mundimi*". Ky varg na përcjell "nëpër shtigjet e shekujve". Imazhi i udhës, i shtegtimin nën pasazhin "me këmbët që u zmadhuan" na çon tek pasazhi i një shtegtimi historik:

*Vinte Ai...
mbi vithet e kalit të bardhë rëndonte nata e Mesjetës,
mbi jelet e kalit të bardhe binte mëngjezi i Rilindjes
mbi trokun e kalit të bardhë kushtronte zëri i trumbetës...*

Pastaj në rrjedhën e këngëve të poemës, nën këtë trok e kushtrim trumpete: dilte Naimi, shfrynte Rrapo Hekali, mes Myzeqesë ecte karroca, me Plakun e Vlorës, sulej Selami, Parisit ecte Avniu, vinte Bajrami (Curri) shtigjeve zënë prej ortekëve, xhubleta dhe fustanella e nënës Shqipëri vërtitej nëpër skenat tragjike në amfiteatrin e madh të Ballkanit. Dhe vazhdohet me këmbët e gjakosura nëpër baltrat e kuqe të Mokrës e majën e Shkëlzenit, gjer vijmë te vargu “Çapitej Shqipëria nga lufta në punë, nga gjaku në djersë nga djersa në ofensivë...po ngjitej në mal socializmi...Dhe poeti i bie vendit pash më pash...le emrin rinor në urat e Shkumbinit, lë emrin në digat e mëdha të Drinit...”

Kjo lëvizje foljore e fjalës poetike: “me këmbët që u zmadhuan nga ecja e mundimi, që çapiten, ngjiten”, vë në lëvizje gjithë figuracionin e poemës.

Dhe kjo bëhet vlera kryesore poetike e saj.

* * *

Kur kam shkruar për “Similitudën e Drinit” argumentoj si e shndërruan atë në figurë poetike Gavril Dara, Lasgushi, Mjeda, Martin Camaj, Ali Podrimja. Kam shënuar edhe Vehbi Skënderin, Anton Papekën, Azem Shkrelin, Agim Vincën, Agron Tufën etj.. Te Drini i poezisë së Vehbi Skënderit duhej të isha ndalur më tepër. Ai e ka përjetuar atë, jo si soditës, por si protagonist sizifian.

Ndërsa Agolli Drinin dhe Devollin e ka konfiguruar nga këndvështrimi triumfalist. (“Lë emrin në digat e mëdha të Drinit” dhe “Po Devoll, i tillë qenkam unë...Brenda kësaj balte, përmbi lumë...unë devolliu i pagjumë, gjeta vargjet gjeta poezinë.”).

Kështu për t’iu rikthyer konfigurimit të Drinit (te Dritëroi Drinit dhe Devollit) mund të bëj këtë karakterizim, që lidhet me idepasionin e çdo poeti madhor:

I pari, Dara i Ri, e konfiguron Drinin në funksion të një skene lufte: kalorësit e Skënderbeut çajnë mes hordhive osmane, “ashtu si Drini i Zi në dimër që kalon përmes liqenit”.

I dyti, Lasgushi, në funksion të një simboli gjeografik shqiptar që shenjëzon kalimin mespërmes në Shqipëri e që “shpreh dhimbjen për ndarjen e për bashkimin e dheut të shqiptarëve”.

I treti, Mjeda, në funksion të skenave të luftrave triumfuese të ilirëve kundër ushtrive greke dhe të luftrave të ilirëve kundër romakëve. Similituda me vërshimin drinor është vërshimi ilir përballë “leprave t’Greqís”, etj.

I katërti, Camaj e ka në funksion të shqiptarit, që rri një shekull vetmi, nën hijen e korbit të zi e në funksion të dy vetmitarëve biblikë: të burrit këtej Drinit e gruas andej Drinit, *“burrit të vramë vetmie e gruas picak në terr, që lyp burrë e kallen pishat flakë”*.

I pesti, Podrimja, në funksion të etnisë, tragjikës dhe qëndresës së Kosovës. Emblemën e Drinit Ali Podrimja e ka edhe në mbiemër edhe në poezi dhe e finalizon me vargun: *“Nyje t’i lidh Dri e Jon rreth Dheut”*.

I gjashti, Vehbi Skënderi, Drinin e ka në funksion të lashtësisë, *(i vjetër je ti Drin, aq sa kjo botë,/ buron nga Mali i Thatë,/ buron nga dherat e begata të Kosovës.)* E ka edhe në funksion të “të përbalturit”, që “Zeusi” e ka detyruar të ngjitë e të zbresë blloqe betoni e turbina dhe ai, jo vetëm i mbart mundimshëm ato si Sizifi, por edhe i thur këngë entuziaste këtij kalvari.

Ndërsa i shtati, Agolli Drinin dhe veçanërisht Devollin e ka konfiguruar nën këndvështrimin triumfalist.

Kështu, në kontinuitetin intertekstual, me shembujt e similitudës së Drinit në poezinë kombëtare, Dara i Ri është Adami i kësaj similitude, Lasgushi emblematiku, Mjeda superior, Camaj zotëruesi, Podrimja finalizuesi, Vehbi Skënderi sizifiani dhe Agolli triumfalisti komunist.

Një ndër vjershat e bukura të Agollit është “Frymëmarrja e lumit”:

*Natën i shtrirë merr frymë lumi,
brigjet e ndiejnë frymëmarrjen e tij,
e ndien edhe ti i pagjumi,
e ndien dhe vajza jote e rënë në dashuri...*

Prof. as. dr. DHIMITRI BELLO, Dr. RAQI BELLO

VEPRA E DRITËRO AGOLLIT NË BULLGARI

Robert Elsie në parathënien e librit të studiueses së mirënjohur bullgare, Rusana Bejlery, kushtuar letërsisë shqipe, shprehet:

“Gjatë shekullit XX popujt e Ballkanit më shumë kanë jetuar afër njëri-tjetrit, sesa bashkë. Shekulli i XXI do jetë rrënjësisht i ndryshëm. Popujt e Evropës Juglindore, ashtu si pjesa tjetër e kontinentit, mësohen të jetojnë si një familje në shtëpinë e përbashkët evropiane, dhe vuajtjet e së shkuarës shumë shpejt do të zhyten në kujtesë.

Duhet theksuar, që sot këta popuj, edhe pse fqinjë prej shekujsh nuk njihen mirë reciprokisht. Mund të quhet edhe simbolik fakti, që jo shumë larg në kohë, që të fluturoje nga njëri vend në tjetrin, ishte e domosdoshme që të kalohej transit nëpërmjet aeroporteve të Vjenës, Romës ose Cyrihut”¹¹

Gjithsesi, vetë marrëdhëniet kulturore të popullit shqiptar dhe atij bullgar kanë tradita të hershme. Ato datojnë që prej kohëve të lashta dhe gjithnjë kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë në nivel dhe pa paragjykitime, model i një bashkëpunimi të mirë në “Ballkanin e trazuar”. Të dy popujt kanë jetuar shekuj me radhë pranë njëri-tjetrit, në udhëkryqin e quajtur Gadishulli Ballkanik dhe kanë shumë gjëra të përbashkëta në doke, zakone, folklor, traditë dhe kulturë. Në kohën e lëvizjes së madhe të popullit shqiptar për pavarësi, shumë intelektualë, poetë dhe shkrimtarë patriotë të Rilindjes Kombëtare shqiptare, jetuan dhe punuan në Bullgari. Sofja, ku u themelua shoqëria “Dëshira”, u kthye në një nga qendrat më të rëndësishme të kohës për botimin e librave dhe gazetave në gjuhën shqipe, qendër e veprimtarisë kulturore e politike, me ndikim të madh në trojet etnike të shqiptarëve. Aktivistët e shoqërive patriotike të Rilindjes, të Stambollit dhe Bukureshtit, kalonin nëpërmjet Sofjes për të shkuar në tokat e pushtuara shqiptare, si qyteti që kishte lidhje të drejtpërdrejtë me to. Nuk ka rilindës shqiptar që të mos e ketë vizituar Sofjen. Atje ka qëndruar Petro Nini Luarasi, Lumo Skëndo, Shahin Kolonja, Bajo dhe Çerçiz Topulli, Mihal Grameno, Fan S. Noli etj. Në Sofje, në shtypshkronjën “Mrothësia”, filluan të botohen një numër i konsiderueshëm gazetash dhe revistash, midis të cilëve një rol të veçantë luajti gazeta “Drita”, një nga gazetatat më të mira për kohën në gjuhën shqipe. Pavarësisht problematikës

¹¹ Бейлери, Р., *Албанската литература като огледало на народната душевност*, Sofje, 2009, f. 7.

patriotike që trajtonte kjo gazetë, në faqet e saj gjetën vend edhe artikuj të ndryshëm publicistikë dhe gjini të reja letrare. Këtu dalin në dritë edhe disa prej veprave të Naimit, Samiut, Mi'hat Frashërit (Lumo Skëndo), Spiro Dines etj. Disa prej këtyre veprave, të përkthyer edhe në bullgarisht, përbëjnë dhe përkthimet e para të letërsisë shqiptare në gjuhën bullgare. E tillë është drama “Besa” (në bullg. *Дадената дума*) e S. Frashërit, që është vënë dhe në skenën e cirk-teatrit “Bulgaria” të asaj kohe¹.

Sot, që pas Luftës së Dytë Botërore, Bullgaria përsëri u shfaq si një qendër e rëndësishme për albanologjinë. Por, kësaj radhe interesi për çështjet që kanë të bëjnë me Shqipërinë dhe shqiptarët, për gjuhën, kulturën dhe letërsinë e tyre, janë vetë bullgarët. Shumë studentë që mësuan gjuhën shqipe, u bënë specialistët e parë bullgarë, të cilët u afirmuan në fusha të ndryshme. Disa nga këta filluan të merren edhe me përkthime, kryesisht nga fusha e letërsisë artistike. Në Bullgari përkthimet e letërsisë shqiptare fillojnë nga vitet ‘60 të shekullit të kaluar dhe vazhdojnë edhe sot. Interesi për t’u njohur me njëri-tjetrin gjen shprehjen e vet konkrete në Bullgari, me përkthimet që janë bërë dhe vazhdojnë të bëhen veprave më të rëndësishme të letërsisë shqiptare. Pavarësisht se është krijimtaria letrare e një populli të vogël, siç janë shqiptarët, kjo letërsi vlerësohet shumë në Bullgari. Fillimisht me botimin e këtyre përkthimeve është marrë shtëpia botuese “Narodna kultura” (bullg. Народна култура) e Sofjes. Letërsia shqiptare gjeti pasqyrimin e saj edhe në faqet e gazetave dhe revistave bullgare, ku gjetën vend përkthimet, intervistat e mjaft shkrimtarëve shqiptarë. Të tilla janë gazeta letrare “Literaturen veshnik” e Sofjes, ndërsa kohët e fundit me mjaft sukses është shfaqur para lexuesve bullgarë dhe të huaj revista periodike Ballkani e Sofjes, ku një vend të veçantë dhe të rëndësishëm, përkrah letërsive të popujve të tjerë të Ballkanit, zë edhe pjesa që i kushtohet letërsisë shqiptare. Në vite, në faqet e tyre janë prezantuar mbi njëzet autorë të gjeneratave të ndryshme, disa nga të cilët me më shumë se një tregim, kurse të dhënat e shkurtra bibliografike i japin mundësi lexuesit bullgar të njihet me zhvillimet dhe tendencat e letërsisë shqiptare. Nuk është lënë në harresë as pasuria e madhe folklorike e popullit shqiptar, që është studiuar mirë si nga folkloristët shqiptarë ashtu dhe nga ata të huaj. Në Bullgari folklori shqiptar është prezantuar me një përkthim të të paharruarit Th. Kacorri, me bashkautor Marko Gançev-in në librin “Midis dy maleve të larta” (titulli origjinal në bullg. “Между две планини високи”), botuar në Sofje dhe përmban mbi 3000 vargje. Lexuesi bullgar njihet me heronjtë e eposit shqiptar: Gjergj Elez Alia, Mujin dhe Halilin etj.

Për sa i përket letërsisë, lexuesit bullgarë janë njohur fillimisht kryesisht me krijimtarinë e I. Kadaresë dhe D. Agollit. Përkthyesit kryesorë të letërsisë shqiptare në bullgarisht janë: Marina Marinova, Marko Gançev, Thoma Kacorri, Ekaterina Josifova, Zoja Kostadinova, Viktor Genkov, Evgenija Kotova etj. Por “zbulimin” e letërsisë shqiptare për lexuesit bullgarë e bëri përkthyesja Marina Marinova. Ajo u bë e njohur si përkthyesja e parë e I. Kadaresë, kur gjatë vitit 1966 bëri përkthimin e parë të romanit të tij “Gjenerali i ushtrisë së vdekur” (bullg. Генералът на мъртвата армия). Mbas këtij hapi të parë ajo i dhuroi lexuesit bullgar në një mënyrë origjinale dhe plot gjallëri edhe disa nga veprat më të njohura të Dritëro Agollit, Zija Çelës, Rexhep Qoses, Besnik Mustafajit etj.

Nga këto përkthime mjaft i njohur për lexuesin bullgar është bërë shkrimtari Dritëro Agolli, me të cilin përkthyesja M. Marinova ka pasur rastin të njihet personalisht në Tiranë, kur ky ka qenë kryetar i Lidhjes. Shkrimtari ynë i madh D. Agolli, është nga autorët shqiptarë më të përkthyer në Bullgari. Ai është bërë i njohur aty nëpërmjet romaneve dhe poezisë së tij. Të gjitha librat e përkthyer janë shoqëruar me një autobiografi të shkurtër për autorin dhe disa fjalë në lidhje me krijimtarinë e tij. Shkrimtari i njohur nëpërmjet kësaj përkthyesje të talentuar ka folur në një bullgarishte të përkryer, fillimisht me romanin e tij “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo” (titulli në bullg. Величието и залезът на Другарят Зюльо, ose i njohur thjesht si “Drugarjat Zylo”), botuar në Sofje në mars të 1978 nga shtëpia botuese Narodna kultura (Издательство “Народна култура”), me 116 faqe dhe me tirazh 10 125 kopje. Romani është pritur mjaft mirë nga lexuesi dhe kritika bullgare. Në gojën e tyre ai qarkullon si “Shoku Zylo”. Në fjalët e hyrjes të përkthimit bullgarisht të romanit thuhet, se ky roman për herë të parë është prezantuar jashtë vendit (Shqipërisë) në bullgarisht. Përkthyesja M. Marinova e përgatiti lexuesin me situatat komike të heronjve kryesorë Demkën dhe Zylon me të cilët do të njihen duke lexuar faqet e këtij romani. Në fund të këtij prezantimi lexojmë edhe vlerësimin që i bëhet këtij romani: “Ky roman i Agollit nuk është vetëm një satirë e rrallë, e suksesshme dhe bashkëkohore, por edhe një vepër që paraqet figurën e burokratit servil dhe burokratit të paaftë, pjellë e realitetit socialist. Shprehja e autorit është dinamike, me një mprehtësi dhe zgjuarsi të madhe. Zylo është tipizuar kaq mirë, saqë kalon kufijtë e realitetit shqiptar, duke na u paraqitur si një karakter i njohur në shumë vende të tjera, ku ka pasur kushte të mbijë, të shfaqet fenomeni Zylo. Nëpërmjet të qeshurës shkrimtari me guxim denoncon një radhë fenomenesh negative, karakteristike për një epokë të tërë”.

Nuk vonoi shumë dhe kjo përkthyesë i dhuroi kënaqësinë lexuesit bullgar të njihen me një tjetër roman të bukur të shkrimtarit D. Agolli, “Njeriu me top” (titulli në bullg. Човекът с оръдието) një botim i shtëpisë botuese “Narodna kultura” 1981, me 290 faqe. Në hyrjen që i është bërë këtij romani thuhet se autori e merr subjektin nga koha e pushtimit italian të Shqipërisë, por vitet e luftës ai i shikon nga një aspekt krejtësisht tjetër. Romani “Njeriu me top” shpaloset me një psikologjizëm të thellë, me ndjenja njerëzore, të manifestuara nga fshatarët e thjeshtë ndaj ish pushtuesve të tyre – ushtarëve të mjerë italianë, të gjithë bij të popullit, që endeshin në dhe të huaj, me rrugën e vështirë të jetës së shqiptarit në kohë lufte, të mbushur me kontradikta dhe kthesa.

Të dyja këto romane (“Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo” dhe “Njeriu me top”), të përkthyer në bullgarisht janë dhe përkthimet e para në gjuhë të huaj që i janë bërë atyre.

Romani i tretë i përkthyer është “Trëndafili në gotë” (në bullg. “Роза в чашата”) i përkthyer që më 1988, po nga M. Marinova. Fillimisht lexuesit janë njohur vetëm me një pjesë të këtij romani. pjesë të këtij romani. Gjatë vitit 1996, një nga revistat më të mira letrare në Bullgari “Ах, Мария и приятели” (në shqip “Ah, Marija dhe miq”), pavarësisht profilit të saj prezantues të letërsisë bullgare, ia kushtoi dy numrat e saj të parë letërsisë së Ballkanit. Në numrin e parë të revistës, ishte e prezantuar dhe mirëpritur një antologji e letërsisë shqiptare. Ishin prezantuar pesë autorë me një pasqyrim të shkurtër të letërsisë bashkëkohore. Nga klasikët e letërsisë shqiptare figurojnë D. Agolli me pjesë nga romani “Trëndafili në gotë”, J. Xoxa me një fragment nga romani “Lumi i vdekur” (Мъртвата река), I. Kadare me fragment nga romani “Përbindëshi” (Чудовището), Z. Çela me tregimin e shkurtër “Kinema verore, lozhë” (Лятно кино, лежа) dhe B. Mustafaj me një pjesë nga romani “Verë pa kthim” (Невъзвратимото лято). D. Agolli, siç e përmendëm, është prezantuar në faqet e kësaj reviste me një pjesë të shkurtër nga romani i tij “Trëndafili në gotë” (nga f. 22-29).

Në vitin 2006 Trëndafili në gotë është botuar si libër më vete, me 260 faqe, nga shtëpia botuese “Ballkani” e Sofjes (me përkthimin e 1988, të bërë nga M. Marinova). Romani është prezantuar me një hyrje të përkthyeses, ku ndër të tjera thuhet se tematika e romanit është bashkëkohore dhe se ai pasqyron fundin e viteve ‘70 të shek. XX, kur inteligjenca në vend e parandien se diçka duhet ndryshuar, të shkëputet nga rutina dhe inercia, të braktisen shtigjet e rrahura si më të lehta, sepse e gjitha kjo pengon prosperitetin e Shqipërisë. Romani është i

mbushur me humor spontan dhe tall burokratët dhe teknokratët, njerëzit e paditur dhe karrieristë, diçka tipike për stilin e D. Agollit.

Në serinë e botimeve akademike të shtëpisë botuese “Marin Drinov”, me titull “Recension i përkthimeve të letërsisë evropiane në bullgarisht”, Sofje 2004 (bullg. Prevodna recenzija na evropejskite literaturi), vëllimi i gjashtë i kushtohet letërsisë së popujve të Ballkanit. Pjesë e rëndësishme e saj është ajo, që ka të bëjë me letërsinë shqiptare, e titulluar Letërsia shqiptare (bullg. Albanska literatura, vol. 6, Sofija 2004). Këtu janë prezantuar disa nga penat më të njohura të letërsisë shqiptare, si: S. Spasse, Dh. Shuteriqi, D. Agolli, I. Kadare, R. Qosja, disa nga veprat e të cilëve janë përkthyer në gjuhën bullgare. Ja se çfarë shkruan për lexuesin bullgar përkthyesja M. Marinova për shkrimtarin D. Agolli: “Krijimtaria e Agollit zë një vend të rëndësishëm në letërsinë bashkëkohore shqiptare. Ai është ndër poetët më të shquar të vendit, por në të njëjtën kohë është dhe një beletrist, romancier dhe dramaturg unik dhe origjinal. Është autor i shumë fejtoneve. Shkruan gjithashtu kritikë letrare dhe publicistikë.... „. Mbasi na jep një panoramë të veprave kryesore të D. Agollit me përmbajtjen kryesore të tyre, autorja e mbyll me këto fjalë artikullin për shkrimtarin e madh: “Agolli dallohet për nga aftësia dhe mjeshtëria e jashtëzakonshme në përshkrimin e jetës së gjallë, të pozitives dhe negatives tek njeriu. Ai është një tregimtar i natyrshëm dhe fjalëmbël dhe ka aftësi që me humorin e tij të sjellë qetësi dhe harmoni. Krijimtaria e tij është mjaft kolorite, me karakter të theksuar kombëtar. Shumë vepra të Agollit në poezi dhe në prozë janë përkthyer në gjuhë të huaja. Midis tyre popullaritet më të madh gëzon romani “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo”. Dy nga romanet e prezantuara tek ne (në Bullgari, bëhet fjalë për “Shoku Zylo” dhe “Njeriu me top”) janë dhe përkthimet e para të këtyre romaneve në gjuhë të huaj”.

Shkrimtarët shqiptarë sot njihen dhe mësohen nëpër leksionet e programeve të Ballkanistikës, pranë universiteteve “Sv. Kliment Ohridski” në Sofje, “Sv. sv. Kiril dhe Metodij” në Veliko Tërnovë, JZU “Neofit Rilski” në Bllagoevgrad, “Paisij Hilendarski” në Plovdiv. Letërsia shqipe, në disa nga këto universitete, është si lëndë më vete me një kurs leksionesh dhe seminaresh, që ka si qëllim të njohë studentët bullgarë me zhvillimin e letërsisë shqiptare në periudha të ndryshme kohore dhe me krijimtarinë e autorëve kryesorë. Ekzistojnë websaite të veçanta në këto universitete që i kushtohen letërsisë shqiptare, siç janë ato të Sofjes dhe V. Tërnovës (www.albanian.dir.bg; <http://www.uni-vt.bg/>).

Një nga shkrimtarët më interesantë dhe të dashur për studentët bullgarë është padyshim Dritëro Agolli. Ata lexojnë me kënaqësi dhe i bëjnë komente veprave të tij të përkthyer në bullgarisht, dhe atyre origjinal në shqip. Dritëro Agolli është autori shqiptar që me veprën e tij qëndron shumë afër shpirtit rinor të studentëve, prandaj mjaft detyra kursi dhe tema diplomash kanë në qendër të tyre veprat e autorit. Interesi i tyre është të dinë edhe për krijimtarinë e re të autorit dhe bëjnë përpjekje që këtë krijimtari ta gjejnë, lexojnë, por edhe ta përkthejnë në bullgarisht, për ta bërë të njohur për të gjithë lexuesit bullgarë.

Në faqet e internetit shpesh dalin përkthime nga pasuria poetike e autorit, të bëra nga studentët, poezi nga përmbledhjet poetike të autorit: “Lypësi i kohës” (Tiranë, 1995), “Gdhihet e ngryset” (Tiranë, 2000), “Pelegri i vonuar” etj.

“Ne jemi të mahnitur, - thotë një studente e universitetit të Veliko Tërnovës, -me talentin e jashtëzakonshëm të Dritëroit, që si rrallë ndonjë poet tjetër, arrin të krijojë poezi melodike nga gjithçka. Shkruan thjesht, në mënyrë të këndshme dhe ritmike, shumë pastër, pa komplikuar dhe rënduar me figura të tepërta, me ndjenjë humori e kombinuar me një dozë të hollë vetironie. Ky është autori i botës sonë rinore”.

Ja pse Dritëro Agolli është nga autorët më të përkthyer nga studentët. Shumë nga këta, nesër do të jenë përkthyesit dhe firmuesit e krijimtarisë letrare artistike shqiptare në bullgarisht, dhe do të sjellin më afër lexuesit bullgar letërsinë e popullit shqiptar, duke mbajtur dhe çuar më tej lidhjet e vjetra tradicionale të dy popujve.

Dr. ELDON GJIKAJ

DRITËRO AGOLLI NË LETËRSINË SHQIPE

Tashmë prej më shumë se gjysmë shekulli vepra letrare e Dritëro Agollit është e pranishme në letërsinë shqipe, duke qenë një pikë referimi për krejt prodhimin letrar shqiptar gjatë gjysmës së dytë të shekullit XX, por edhe në këtë dekadë të shekullit të ri. Dritëro Agolli shquhet si një shkrimtar mjaft prodhimtar i cili ka lëvruar suksesshëm prozën dhe poezinë në letërsinë tonë. Ai i përket asaj plejade shkrimtarësh që sot gjithnjë e më shumë në vështrimet historike letrare emërtohen si brezi i viteve '60-të. Së bashku me Kadarenë e Arapin, Agolli solli një tjetër frymë në letërsinë shqipe të gjysmës së dytë të shekullit XX, frymë që prirrej drejt një letërsie më cilësore sidomos në elementët formal, por edhe sa i takon zgjerimit dhe pasurimit të temave letrare. Megjithëse letërsia shqiptare në këtë periudhë ishte e shtrënguar fort në kufizimet e metodës së realizmit socialist, e cila detyronte një letërsi me karakter ideologjik dhe politik, mund të thuhet se në këtë periudhë shkrimtarët e talentuar sollën vlera të njëmendta letrare që edhe sot e gjejnë receptuesin e tyre. Ndër këta shkrimtarë cilësorë Agolli është pa dyshim një zë original, i cili ka mundur të ruajë lexuesin e tij. Edhe pas vitit '90-të, kur letërsia jonë çlirohet prej metodës së realizmit socialist dhe kur nisin e lëvrohen modele letrare nga më të ndryshmet, Agolli vazhdon të krijojë me intensitet të lartë duke sjellë disa prej kulmeve të tij letrare. Këtu duhet të veçosh sidomos romanin “Arka e djallit”.

Duhet theksuar se letërsia e D. Agollit përmban një galeri njerëzish dhe karakteresh, dhe nga kjo pikpamje studiuesit kanë theksuar se “njeriu është fuqia e brendshme e veprës së D. Agollit.” Në poezinë e D. Agollit njeriu përgjithësisht është i njësuar me vetë autorin, ndërsa në prozë njeriu personazh shfaqet i pavarur nga autori.

Agolli ka krijuar një poezi të personalizuar, me shumë individualitet. Në një vështrim krahasues me poezinë shqipe që lëvrohej përpara viteve 60-të, duhet thënë se Agolli solli në poezi “*unin*” e fortë lirik, i kundërt ky me poezinë e brezit të poetëve antifashistë. Personalizmi i qartë i poezisë duket qysh në vëllimin e tij të parë, “Në rrugë dola” (1958). Kjo prirje u shpreh pastaj dhe më shumë e më qartë në poemat “Devoll-Devoll” dhe “Poemë për babain dhe për veten”. Ajo karakterizon gjithë poezinë e autorit.

Qëndrimin ndaj teknikave të vjershërimit tradicional D. Agolli e pati shprehur edhe në formë kritike, përmes artikullit *“Traditë, natyrisht, por jo shtampë”*. Poezia e D. Agollit ndahet nga poezia tradicionale sepse nuk e kërkonte me patjetër lëndën e vet tek heroizmi. Në këtë poezi e pa veten si subjekt bujku dhe bariu, fshatari dhe studenti, malësori dhe intelektual. Ai krijoi një gjedhe të re vjershërimi, që ndiqte Naimin duke mëtuar risinë. Rruga e rritjes së tij të shkallëshkallshme poetike shprehet në librat: *“Hapat e mija në asfalt”* (1961), *“Shtigje malesh dhe trotuare”* (1965), *“Devoll-Devoll”* (1964), *“Mesditë”* (1968), *“Baballarët”* (1969), *“Nënë Shqipëri”* (1974), *“Fjala gdhend gurin”* (1977), *“Udhëtoj i menduar”* (1985), *“Pelegri i vonuar”* (1993), *“Lypësi i kohës”* (1995), *“Fletorkat e mesnatës”* (1999). Poezia e tij është e afërt për njeriun. Poeti e zgjeruar shumëfish hapësirën e realitetit në poezi dhe krijoi poezi antologjike me motive të përditshmërisë së jetës. Nga kjo pikëpamje poezia e Agollit e emancipoi në tërësi mendimin dhe klimën letrare në Shqipëri.

Në prozën e D. Agollit njeriu si entitet shpesh paralajmërohet që në titullin e veprës: *“Njeriu i mirë”*, *“Njeriu me top”*, *“Tregime për njerëz të gjallë”*, *“Njerëz të krisur”*, *“Njeriu me veladon”*, *“Portret i njeriut të madh”*, sikurse në poezi *“Vjen njeriu i çuditshëm”* etj.

D. Agolli, me prozën e tij, ka krijuar karaktere që i ikin disiplinës dhe i largohen mitit skematik të *“njeriut të ri”*, duke ndërthurur brenda vetes vlera të përveçme morale duke qenë edhe frymë të gjalla: njerëz të virtytshëm e të cenueshëm njëherësh, siç ka qenë dhe do të jetë në rrjedhë të historisë së jetës njerëzore. Po të kihet parasysh se një nga parimet bazë të dogmës së soc-realizmit ka qenë tipizimi i personazheve në konturet klasore, pra personazhe pozitive dhe negative, ku të parit i takon gjithçka e virtytshme që buronte prej partishmërisë proletare dhe idelave të komunizmit, ndërsa të dytit gjithshka e keqe që buronte prej gjithfaërsoj shkaqesh, që nga dekadencia borgjezo-revizioniste e deri te dobësia morale, duhet thënë se Agolli nuk ndërton personazhe steril sipas kësaj dikotomie ideologjike. Personazhet e tij shpesh i përkasin *“hapësirës gri”*, ku s’mund të presësh vetëm ndriçim virtyti, por edhe dobësinë njerëzore. Komandanti Rrapo përzë dy komisarë, sepse nuk i pëlqejnë njerëzit e fjalës. Minai, shkrimtari i ri tek *“Trandafil në gotë”*, trondit jetën e një qyteti në anësi, duke vënë në provë dhuntinë natyrore të vëzhgimit dhe parashikimit. Tek *“Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo”* mund të thuhet se të gjithë personazhet dhe gjendjet e tyre janë në hapësirën gri, ku, për çudi, është vështirë të vendosësh nëse ka më shumë dobësi tek ato karaktere që mund të merren si të prirura nga kahja pozitive apo më shumë vlera tek pala tjetër e personazheve. Më i ndërlikuar bëhet problemi tek *“Arka e*

djallit”, një roman i shkruar përgjatë dy dekadave, ku personazhe simpatikë, si Cute Babulja e shkrintari Sherif Abeceja janë më të krisur se vetë ata që autori i quan “*njerëz të krisur*”.

Një karakter gjithaq të ndërlikuar dhe aspak të kulluar shpërfaq Mato Gruda tek “Njeriu me top”. Tek romani “Dështaku”, Xhelo Mara i paraqitet lexuesit si një personazh kompleks, sa i fortë po aq edhe dilematik. Në këtë roman ata që hiqen si bartës të frymës së progresit shihen me dyshim, ndërsa ai që rrezikon të shpallet armik i ngjan më jetësor.

D. Agolli, me veprën e tij, arriti të krijojë personazhin e dilemës, përkundër heroit të palëkundur që duhej të shenjonte “*njeriu i ri*”. Mato Gruda gjendet midis dy hasmërive: të familjes dhe të atdheut. Cute Babulja gjendet midis dy ngasjeve: zbatimit fanatik të vijës e detyrës dhe dëshirës për jetën dhe kënaqësitë e kësaj bote. Demka gjithashtu ka dilemën e vet: ai nuk di se çfarë të zgjedhë, devotshmërinë ndaj shefit apo joshjen e dikurshme të krijimit.

Pikërisht dobësia dhe dilema, kufizimi dhe mëdyshja, që prishin harmonikisht shenjtërinë e kulluar pozitive që duhej të kishte heroi skematik, e bëjnë galerinë e personazheve të D. Agollit një galeri njerëzish të gjallë, që mbijetojnë ndër kohëra dhe vazhdojnë edhe sot të na falin emocione.

Në përfundim mendoj se vepra e D. Agollit është një pikë referenciale për letërsinë shqipe të gjysmës së dytë të shekullit XX por që vazhdon edhe sot. E rëndësishme është që kjo vepër të trajtohet e vlerësohet bazuar në kriteret shkencore ashtu si detyron studimi i letërsisë, në të cilin një shenjë esenciale është dimensionin social që kjo vepër zë, receptimi i saj historik, receptimi i saj në potencë dhe receptimi kritik. Vepra e Agollit ofron të gjitha mundësitë për të kryer shqyrtime multidisiplinore, por edhe specifike, të ngushta të cilat vazhdojnë të mbeten të pakta.

Prof. as. dr. ADEM JAKLLARI

MJESHTËRI I MADH I NARRACIONIT TË SHKURTËR

Në universin artistik agollian, tregimi është një nga yllësitë më të ndritshme. Edhe pse në rrafshin sasior kjo lloj krijimtarije zë një vend më të vogël se poezia apo romani, cilësitë, në të gjithë treguesit, janë të rendit të parë. Përgjatë gati një gjysmë shekulli Dritëro Agolli lëvroi me mjeshhtëri tregimin duke pasuruar rrëfimin tradicional dhe atë modern shqiptar. Përvojat më të mira të tregimtarisë sonë të përfaqësuara nga Koliqi, Kuteli, Migjeni dhe ndonjë tjetër, modelet shumëshekullore të rrëfimit folklorik me trajtat e veta magjike dhe fantazmagorike i bëri pjesë të ateliesë së vetë krijuese dhe i vuri në lëvizje sa herë ua pati nevojën për të ndërtuar modelet e veta krijuese. E rimarrë në kushtet e reja të pritjes estetike kur leximi i letërsisë është shumë më pak i ndikuar nga paratekstet sociale, tregimtaria e Agollit si formacion estetik, etik dhe filozofik; si zbulues artistike e një materieje të gjerë dhe të ndryshueshme në mjaft tregues nga materia sociale e kohës së sotme; së fundi si një trup gjuhësor dhe stilistik, rri bukur, e pakapërcyer, e pavjetëruar; që i afroshesh me shije dhe që të ushqen shije të përparuar. Që në tregimet e para që botoi në fillim të viteve '60 dhe deri te tregimet që botoi në fundin e viteve '80 të shekullit XX, Dritëro Agolli krijon, me botën përtej vetes, marrëdhënie tërësisht artistike; ai eksploron ato anë të të kësaj bote që kanë zhvillime të natyrës që i pranon letërsia, zbulon shkakësi që qëndrojnë përtej sociale, ndriçon mistere shpesh herë magjiplote të qenies njerëzore. Mbi të gjitha, shkrimtari joshet nga “njerëz të krisur”, “tuafë” si jashtë kohe, që pëlqejnë aventura dhe sjellje që thyejnë tabu dhe norma; qenie në të cilat mbijetojnë shtresa të shumta e të ndryshme kohore dhe kulturore, që kryejnë zullume dhe mëkate; që janë të pushtuar jo rrallë nga demonët. Këta njerëz shpesh të duken se qëndrojnë psikologjikisht më afër qenieve tradicionale, personazheve mitike dhe folklorike, sesa qenieve të kohës kur shkruhen tregimet. Në këtë mënyrë, tregimtari i shpëtoi kurthit të rrëzikshëm të të krijuarit të një tregimi qëllimor, që ishte aq shumë në modë në kohën e socializmit. Zbulimi i anës tjetër, që kontestonte modelet njerëzore që po përpiqej të ndërtonte filozofia marksiste-leniniste, i dha tregimtarisë së Agollit frymë origjinale, duke ruajtur njëherazi, edhe vijueshmërinë e tregimtarisë shqiptare dhe botërore, veçanërisht asaj të fundit të shekullit 19-të dhe fillimit të shekullit 20-të. Ndërsa personazheve të tij u dha një dimension kompleks, domethënie artistike universale. Shumica e heronjve të tregimeve të tij, sidomos atyre me motiv Luftën e Dytë Botërore janë karaktere të shumëfishta: reale dhe hipotetike, tragjike dhe komike,

heroike dhe absurde. Ata herë zotërohen nga arsytetime të forta filozofike, që të mahnisin me shkëndijimet e mendjes së tyre, e herë tjetër nga pasione të marra; herë nga veprime që i afrohen kufijve të normales dhe herë tjetër i largohen skajshëm asaj duke u zhvendosur deri në trojet e së pamundurës. Ky parim i sendërtimit artistik u jep tregimeve të tij, brenda një shtrati me kufiza mjaft të perceptueshme, një frymë dhe tonalitet magjik, misterioz. Rrëfimi ecën përgjatë dy linjave: njëra e dukshme e matshme; përgjithësisht indentike me atë tempo dhe modalitet në të cilën rrjedh jeta e rëndomtë; dhe tjetra pa shenja konkrete, nëpër rrjetet spirituale dhe misterioze të individit, përgjatë thellësive ku rri e fshehur kujtesa gjenetike, fondamenti mistiko-legjendar i fisit dhe individit shqiptar, dhe në disa raste bota e tij ndjenjësore e furishme, që shpesh të kujton Aristotelin e antikitetit grek, që pranonte ekzistencën “e shpirtit njerëzor në dy trupa njëherësh”. Ky dualitet shpirtëror është pjesë e thelbit të mjaft prej personazheve të Dritëro Agollit, çka i bën ata të jetojnë gjatë në vetëdijen e lexuesve; ndërsa tregimet vetë të kujtojnë Mopasanin, Çehovin dhe Gorkin e fazës së parë të krijimtarisë së tij. Këto lloj tregimesh shquajnë për krijimin e invarianteve tematike dhe tipologjike, të cilat ushqejnë një rrjedhë të gjatë krijuese të mëvonshme. Krijimi i personazheve që qëndrojnë më afër natyrës, të lirë deri në aventurë ndaj rregullave shtërnguese që krijon, herë pas here, shoqëria njerëzore, të zotëruar nga pasione të forta: të bujshëm deri në skandalitet në veprimet e tyre, u jep tregimeve modulime artistike polifonike, tekste të drejtpërdrejta, por edhe nëntekste që mundësojnë lexime të dhumta dhe subjektive. Në këtë mënyrë, tregimet e shkrimtarit tonë të shquar kanë realizuar një komunikim estetik të gjerë në kohë dhe në lexues. Kjo pjesë bazale e qenies kolektive kombëtare, por edhe me pikëtakime njerëzore universale; këto kumte dhe informacione të hershme zgjohen jo rrallë në rrjedhë të historisë, dhe në kohë, kur kërkohet të bëhen ndryshime në kodet njerëzore dhe shoqërore, ato shfaqen në forma të ndryshme. Graviteti që ushtron mbi njeriun etnopsikologjia është e rëndë, ndërkohë që inercia e lëvizjes përpara nuk është më e vogël. Vendosija e personazheve, në mjaft tregime, në situata të tilla përjashtuese i jep rrëfimit agollian tension të brendshëm, ritëm dhe intrigë. Dritëroi priret më shumë drejt ravijëzimit të portreteve me fizionomi që e kapërcejnë mesin, shumicën; që përbëjnë entitete të jashtëzakonshme. Si tip tregimi, ky i Agollit, është ai që përpiket t’i jap përgjigje pyetjes se çfarë tipi është personazhi, duke mos e injoruar tërësisht pyetjen se çfarë do të ndodhë në rrjedhën e tërësisë së ngjarjeve. Pika drejtëvizore ku ngjarjet në mënyrë tepër intriguese ndjekin njëra-tjetrën, pikëtakohen dhe bashkëzanojnë me atë vertikale, që ka të bëjë me leximin në thellësi të kohëve të mbivendosura;

qofshin ato historike, etnopsikologjike, filozofike, rituale etj. Heronjtë e tregimeve të Agollit afrojnë për nga konceptimi dhe arkitekturimi i tyre me entitete infernale dhe purgatoriale. Ata midis mëkatit dhe virtutit jo rrallë zgjedhin të parin. Madje disa syresh shkojnë edhe më tej; ata shpesh pushtohen nga furi të demoniake, nga pasione të zjarra (nuk karakterizohen vetëm nga një qëndrim). Autori i përfshin në vorbullën e ngjarjen kontestuese ndaj njëra-tjetrës, çka ushqen shumësinë e qëndrimeve dhe sjelljeve. Duke ndjekur grafikën shpirtërore të personazheve më të spikatura të prozës së shkurtër të Agollit, vëmë re praninë e shumësisë së qëndrimeve që përmendëm më lart. Figura të tilla artistike si Ahmet Sina (*Lamtumirë, kapedani im*), Islam Bulykbashi (*Ndëshkimi*), Agush Tomorrca (*Nipi plëngëprishës*), Pasho Velçani, Kadri Gurra (*Martesa e papritur e Pasho Velçanit*), Hajrie Çeremi (*Pesha e turpit*), Teloja e Koçoja (*Njeriu i mirë*), etj., janë ndërtuar sipas parimit të shumësisë së qëndrimeve dhe kompleksitetit të shfaqjes. Tek këto figura vihet re edhe qëndrimi realist, që ka të bëjë me mospranimin dhe dënimin e dukurisë, edhe qëndrimi estetizant i admirimit që bajshkëjeton në mjaft raste me mosbesimin, edhe qëndrimi liriko-poetik e përsiatës, që pranon bashkëekzistencën e qenies dhe mosqenies. Parë në këtë kënd, nuk mungojnë shfaqjet, gjithashtu, të sjelljeve naive. Në tregimet e veta Agolli i kushton vëmendje dritësimit të kohëve historike, që janë vonuar të shfaqen tek individë të ndryshëm, dhe kur shfaqen sjellin me vete përplasje dhe kundërshti. Në tregimin *Lamtumirë, kapedani im*, bie fjala, heroi i tij, një figurë komplekse, vendoset në rrethana sa brenda filozofisë së tij aq dhe jashtë saj; ai është një luftëtar i lirisë i tipit tradicional, që e ka të vështirë të evoluojë sipas rendit të gjerave dhe moralit që po ushqejnë komunistët e vendosur në krye të partizanëve. Në mesin e këtyre rrethanave diverse për të, ai përjeton zhvillime të ndryshme shpirtërore dhe botëkuptimore. Shkrimtari duke ndjekur me vëmendje barasvlerat semantike të tërësisë së ngjarjeve dhe marrëdhënieve midis karaktereve i jep rrëfimit një theks të ri, konceptimin filozofik. Kjo ndodh edhe me personazhe të tjera, duke përcaktuar, në këtë mënyrë, një prej thelbeve të narracionit agollian. Heronjtë e veprave të tij janë jo vetëm veprues dhe forca kinetike që vë në lëvizje tërë arkitekturën artistike, por edhe mbartës të një filozofie me prirje të pastër popullore shqiptare. Invariantet tematike dhe tipologjike letrare, Agolli di t'i pasurojë me variacione dhe trajtësime orgjinale motivore dhe poetike.

Tek i lexon rishtazi tregimet e Dritëro Agollit ke ndjesinë e diçkaje që nuk ndodh për herë të parë. Kjo, për mendimin tim, ndodh sepse *logjika rituale* (koncepti teorik është i Todorovit) ka të bëjë me *kthimin e përjetshëm*, me ravgimin në të kaluarën psikike të individit si pjesë e

psikikës kombëtare. Mjaft sjellje dhe veprime tek heronjtë e tregimeve, që po analizojmë, bien pre, kapen në lak prej kodeve gjenetike të bashkësisë etnike dhe trashëgimisë historike kombëtare. Koha e përjetshme, që herë përqaset me atë legjendare folklorike dhe herë me atë të hershmërisë historike, nuk është e vetmja kohë në tregimet e Dritëroit. Ajo harmonizohet dhe bashkëzanon me kohën reale, të tashmen. Integrimin artistik të të dyja kohëve, Agolli e realizon duke ndjekur dy logjika rrëfimi: të rrëfimit realist, linear; dhe të kthimit tek tekstet dhe modelet e letërsisë popullore. Vështruar nga disiplina e intertekstualitetit, tregimtaria agolliane dëshmon një nga shembujt më të mirë të mbështetjes jo në trajtë imitimi te modelet popullore, por në trajtë rifunksionalizimi letrar për të përligjur thelbet e karaktereve dhe për të ruajtur tipologjinë e rrëfimit që parapëlqen.

Dritëro Agolli e ka shprehur hapur kredon e vet krijuese: ai është shkrimtar i vijimësisë së traditës më të mirë krijuese shqiptare dhe i pasurimit të saj me vlera të mirëfillta letrare dhe kulturore. Edhe me tregimin, Dritëroi realizon të njëjtën ambicje prej artisti të vërtetë. I ushqyer nga të dyja përvojat letrare, ajo shqiptare dhe botërore, tradicionale qoftë apo moderne, fondi tregimor i tij është tashmë vetë një model në letërsinë tonë. Kjo anë e krijimtarisë së tij, pak e njohur dhe e studiuar, për shkak se një pjesë e tregimeve të Agollit nuk u la të qarkullonte në kohën e diktaturës komuniste, përbën një ndihmesë tepër të vyer në ecurinë e tregimit shqiptar.

Dr. DION TUSHI

TIPARI HUMANIST I PROZËS SË AGOLLIT SI VEÇANTI DHE VIJUESHMËRI ORIGJINALE E KRIJIMTARISË SË TIJ

1. Humanizmi si origjinalitet.

Pjesa dërrmuese e subjekteve dhe personazheve të Dritëro Agollit flasin për jetën dhe njeriun. Pikërisht këtu qëndron edhe karakteri i fortë antropologjik dhe humanist i veprës së tij. Në këtë kuadër fakti që ai nuk e idealizon personazhin, përbën një avantazh të madh, që nga ana e vet krijon një gjithpërfshirje dhe tërheqje të botës së personazhit tek lexuesi dhe një zhdukje të natyrshme të barrierave midis tekstit dhe lexuesit. Falë talentit të tij, ky kapërcim nuk është sipërfaqësor, çka do të thotë se nuk kemi të bëjmë me një letërsi zbavitëse për një kategori të caktuar lexuesish, nëpërmjet një improvizimi të lehtë. Art do të thotë thjeshtësi, në përmbushje të kësaj teze dhe në këtë rast e pavetëdishmja krijon artistikisht një rrëfim të çliruar nga çdo paragjykim, apo ngarkesë emocionale¹.

Eshtë kjo thjeshtësi e pësosur që hap dyert e subjektit në mënyrë organike dhe aktive dhe lexuesi ndjen se nuk lexon ndonjë tregim apo roman, por ndjen se futet brenda jetës së gjallë të personazheve. Le të kujtojmë këtu romanin “Trëndafili në Gotë”², ku forca dhe uniteti i rëfimit, i mbështetur tek detaji, krijon nëpërmjet depërtimit tek lexuesi një kërshtëri të përhershme. Kjo e bën prozën e Dritëro Agollit, një ndër prozat më të lexueshme, më origjinale dhe më të realizuara të letërsisë sonë.

2. Përballëvënia e karaktereve si referencë e strukturës humanistike të D. Agollit.

Ajo që të bën përshtypje tek proza e tij, është mënyra e veçantë e kontrastit që autori krijon me përballëvënien e dy kategorive të personazheve që ai krijon, kështu tek vepra të aritura të tij si përmbledhja me tregime “Njeriu i Mirë”, apo romanet “Dështaku”³, “Arka e Djallit”⁴ etj, kemi një kategori të parë apo një grupim personazhesh, ku paraqiten karaktere të forta, fisnike, deri diku altruiste dhe të formuara, me botë të pasur shpirtërore dhe intelekt, ndërkohë që paralelisht me ta kemi një kategori të dytë, me njerëz mendjengushtë, të gjymtuar shpirtërisht

¹ D. Agolli, *Jeta në letërsi*, Artikuj, Tiranë 1987.

² D. Agolli, *Trëndafili në gotë*, Tiranë 1998.

³ D. Agolli, *Dështaku*, Tiranë 1993.

⁴ D. Agolli, *Arka e Djallit*, Tiranë 1997.

dhe shumë egoistë. Pikërisht, kjo përballvënije, siç është trajtuar dhe nga studiues të tjerë, si psh Hasan Mekuli⁵, është ajo që tregon ecurinë e domosdoshme dhe dialektikën e jetës, pa pretendime dhe tendenca, pa lustra dhe heronj pozitivë. Pikërisht diçka e tillë lë vend për vrojtme filozofike dhe morale, si dhe për mbresa tek çdo lexues, i cili zbulon fakte jetësore, konkrete për të apo për jetën e autorit dhe pa dyshim që i rrit dukshëm vlerat antropologjike prozës së autorit, duke u dhënë personazheve përherë diçka të vetën, e cila funksionon si tharm dhe si veçori origjinale karakterizuese në çdo vepër të tij.

Proza e Dritëro Agollit në tërësinë e vet, ka shumë tema dhe motive të ngjashme me njëra-tjetrën dhe ndonjëherë shumë të afërta midis tyre. Diçka e tillë vërehet në të gjitha tregimet, qofshin këto tregime dashurie, tregime nga koha e luftës, tregime të karakterit social, psikologjik, apo edhe humoristik. Pothuajse secila nga këto lloje huazon dhe gërshetohet me elementët e tjetrit. Diçka e tillë ndodh sepse autori rrëfen gjëra që janë të bindshme, me veçori që vijnë nga një përjetim cilësor dhe i thellë, duke u kujdesur për ato që shkruan, pasi nuk është qëllimi i tij që me penën e një gjeniu të befasojë lexuesin, por t'u tregojë atyre përvojën e tij jetësore, lidhur me situata dhe personazhe që pakkush i kishte paraqitur si ai. Është ky filtër i hollë i subjektivitetit të tij krijues, i prirur tek vrojtimi i veçantë i jetës njerëzore, që merr spuntin nga karakteri i tij njeridashës dhe human, i stampuar në formën më të përsosur brenda shpirtit të tij të ndjeshëm, ai që përvijon suksesshëm natyrat e personazheve mbresëlënëse. Kështu, ai evidenton pozitiven dhe frymën e sakrificës tek njerëzit bujarë dhe të fisëm, dhe siç e thamë më lart e përballëvë, në kontrast me një mënyrë tjetër, përmes veseve, egoizmit dhe ligësisë. Tipa të tillë autori i shpërfill dhe i dënon, pikërisht në emër të vlerave dhe mbi të gjitha në emër të filozofisë së tij të thjeshtë humaniste, nga e cila priret gjithmonë. Falë përvojës dhe pjekurisë së tij artistike, autori është gjithmonë narativ dhe nëpërmjet naracionit ai tregon për atë që ka parë dhe i ka lënë mbresë, pa sugjeruar haptazi, por ndërkohë pa fshehur simpatitë dhe antipatitë e tij si shkrimtar.

3. *Humanizmi në trajtimin e temës së dashurisë.*

Trajtimi i motivit të dashurisë nga D. Agolli, është një shpalosje tjetër e karakterit humanist të prozës së tij. Mënyra se si ai e shikon këtë ndjenjë kaq fisnike, i jep atij gjithmonë shkak që ta lidhë atë me motive sociale, duke e trajtuar si pasqyrim raportesh shoqërore nën një këndvështrim antropologjik. Kështu kemi parasysh këtu dashurinë e Almës me Memo Kovaçin

⁵ M. Avdyli, *Studime për Dritëro Agollin në Kosovë*, Tiranë 2006, f. 238.

tek “Komisari Memo”⁶, dashurinë e Verës me Telo Gorën tek “Njeriu i Mirë”, apo dashurinë e Xhelo Marës me Hatixhenë tek romani “Dështaku”⁷, ku dashuria është e pastër, e dliirë dhe që pavarësisht sprovave që vijnë si rezultat i ndikimeve të drejtpërdrejta të karaktereve të ndryshëm socialë dhe psikologjikë me ta, përjetohej pa egoizëm apo interes⁸.

Lëndën në trajtimin e temës së dashurisë ai e gjen në realitetin e kohës, në jetën e përditshme, jo duke e banalizuar atë, por përkundrazi, duke e zgjedhur atë që është më esenciale, më karakteristike, dhe për pasojë trajtimi dhe përfundimi jepen në formën më realiste. Botëkuptimi humanist i dashurisë, përbën ndërkohë edhe diagramin me oshilacione, me ulje ngritje të jetës dhe natyrës njerëzore, të dobësive dhe të forcës së karakterit⁹. Në këtë këndvështrim, bën që të kuptohet më mirë, depërtimi i domosdoshëm i asaj që është progresive, pozitiviste dhe shndërruese.

4. *Personazhet e ndjenjave të forta, tregues i karakterit human në prozë.*

Duke patur parasysh prozën e D. Agollit, të bën përshtypje fakti se çdo gjë që bëjnë heronjtë e tij, e bëjnë me dashuri aq të madhe sa shkon deri në adhurim, madje dhe urrejtja tek ata të duket sikur adhurohet. Ata janë përgjithësisht, personazhe të ndjenjave të forta. Kjo gjë i bën më imponues, më të vendosur dhe për pasojë më tragjikë. Dhimbja e tyre e shkaktuar nga dashuria, nga privacioni, apo nga rrethanat, i fisnikëron ata dhe u jep një dimension madhështie. Duke kaluar në tërësinë e gamës së ndjenjave njerëzore natyrshëm arrijnë tek madhështia, dhe këtë përmasë ua jep ajo që mbartin. Një e dhënë më tepër kjo në favor të idesë së humanizmit si provë dhe sfidë në jetën njerëzore. Personazhet e tij mbeten gjithmonë njerëz dhe pavarësisht fatalitetit, dinamika e veprës së tyre del e pacunguar.

5. *Filozofia humaniste e mesazheve në veprën e D. Agollit.*

Të bën përshtypje fakti se personazhe të prozës së Dritëro Agollit, mbartin në vetvete veti dhe karakteristika të heronjve të veçantë që krijoi letërsia e Brezit të Humbur. Një ndër këta, personazhi më i spikatur që i mbart këto veti është ai i Xhelo Marës në romanin “Dështaku”, i cili megjithëse vritet në prag të arritjes të fitores së jetës kundër dështimit, mesazhi që ai përçon përmban së brendëshmi optimizmin e jetës edhe në rrethana të pazakonta, si konceptim i filozofisë humaniste.

⁶ D. Agolli, *Komisari Memo*, Tiranë 1978.

⁷ D. Agolli, *Dështaku*, Tiranë 1993.

⁸ D. Agolli, *Zhurma e erëave të forta*, Tiranë 2006.

⁹ D. Agolli, *Njeriu me top*, Tiranë 1977.

Kështu pavarësisht që këtu nuk kemi një roman që mbyllet me *happy end*, pasi jeta e personazhit kryesor mbyllet tragjikisht, jeta përsëri do të triumfojë mbi dështimin dhe vdekjen. Karaktere të kthyer në simbole si ajo e protagonistit në fjalë, shërbejnë si një inkurajim dhe kundërvënie ndaj çdo lloj nëpërkëmbjeje, arbitrarizmi dhe cënimi të sovranitetit.

Kështu humanizmi si një kolonë zanore e gjithë prozës së D. Agollit, nuk është vetëm i pranishëm dhe evident në çdo vepër, por shoqëron gjithmonë mesazhet që dalin nga veprat e tij¹⁰.

Deri tani kemi folur vetëm për karakterin humanist në përmbajtjen e prozës së tij, por duhet thënë se elementin humansitik vepra e D. Agollit, e shpreh edhe nëpërmjet elementëve të formës. Kështu lirizmi, i cili është një nga tiparet më karakteristike edhe të prozës së tij, është në vetvete një tregues i evidentimit të humanizmit. Për më tepër kur ky lirizëm merr ngjyrimet emocionale të veçanta, atëherë kuptojmë se kemi të bëjmë me një predisponim të brendshëm të autorit.

Të gjitha sa thamë të bëjnë të mendosh se proza e tij me gamën e gjerë dhe të përzgjedhur tematike, është një pjesë e rëndësishme e antropologjisë sonë kombëtare dhe në të njëjtën kohë edhe e vlerave globale humaniste.

Pikërisht tek kjo vlerë e ka sekretin koherenca dhe origjinaliteti i përhershëm i letërsisë së vërtetë të krijuar prej tij. Këtu qëndron vlera e vërtetë e prozës që i jep çdo të drejtë autorit kur pohon se “Asnjë diktaturë nuk shpik dot armë për të vlarë letërsinë”.

BIBLIOGRAFIA

M. Avdyli, *Studime për Dritëro Agollin në Kosovë*, Tiranë 2006.

D. Agolli, *Arti dhe Koha*, Tiranë 1980.

D. Agolli, *Jeta në Letërsi*, Artikuj, Tiranë 1987.

D. Agolli, *Zhurma e erëave të forta*, Tiranë 2006.

D. Agolli, *Dështaku*, Tiranë 1993.

D. Agolli, *Arka e Djallit*, Tiranë 1997.

D. Agolli, *Njeriu me top*, Tiranë 1977.

D. Agolli, *Komisari Memo*, Tiranë 1978.

D. Agolli, *Trëndafili në gotë*, Tiranë 1998.

¹⁰ D. Agolli, *Arti dhe Koha*, Tiranë 1980.

Msc. ILIR SHYTA

“ZYRA”, QENDËR E BUOKRACISË BOTËRORE!

(Qasje në romanin e Dritëro Agollit “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo”)

Në këtë përjasje do të doja të theksoja që në fillim, se zyra mbetet qendra e buokracisë botërore. Parë në këtë këndvështrim, buokracisë mund t'i bëhet edhe një tjetër lexim bashkëkohor përmes këtij romani satirik që mbetet kronikë e karrierës së paralajmëruar të një zyrtari. Ndryshe nuk ka si shpjegohet madhështia e vepres në botë, pasi përmes një rrethi vicioz gjithkush gjen vetveten... Parë në këndvështrimin e viteve, ky roman i botuar në vitin 1972, sipas një përlllogaritje matematikore, na tregon se zylo në ekzistencën e tij, sivjet do të ishte 39 vjeçar. Të edukosh përmes vesit, madje edhe me humor ndër vite, edhe duke buzëqeshur, përfiton vlerë katarsisi në horizontin pritës, pasi ndryshimet e mëdha nisin me humorin, sigurisht për të tronditur çdo sistem shoqëror nëpër kohëra. Për buokratët dhe servilët është shkruajtur jo pak, por faji përgjithësisht i është hedhur njëres palë: shefit arrogant ose vartësit të përulur. Komizmi i figurës së Zylos buron nga kontradikta themelore e karakterit të tij: ai i jep vetes të tjera vlera nga ato që i takojnë, duke menduar se hierarkia shtetërore është edhe hierarki meritash. Në të vërtetë Zylo Kamberi është një figurë tragjikomike. Veprimet e tij të bëjnë të qeshësh, po aq sa edhe të ndiesh keqardhje. Në romanin humoristik të D.Agollit, Zyloja dhe Demka vijnë të flasin ende, duke u bërë pësim-mësim i njehsuar, nën sentencën “gabimet na bëjnë më të mençur”... Fenomenologji dhe ekzistencializëm do ta quaja bukurtingëllimin e këtij romani nëpër sisteme politike, madje një sprovë që vijon të lexohet me interes nga grupmosha të ndryshme lexuesish.

Njeriu për nga natyra e tij krijuese është i thjeshtë, përpos që arsyeja ia jep atributin e të qenit i njohur me vetitë e kësaj ekzistence. Hiqja arsyen dhe domosdoshmërisht do të reflektojë efekt të panjohur mbi çdo gjë. Ai është vetë prijësi që përcakton fatin e tij se çfarë do të bëhet me të ardhmen e tij, pra ai është ajo që do të zgjedhë, krijojë pambarimisht.

Këtu në këtë roman, shteti është shndërruar si vijimësi e ekzistencës së vet. Esenca e tij paraprihet nga individ të caktuar që kryesisht bëjnë “politikë” lokale dhe jo vetëm dhe që ia veshin atë kohës. Shteti dhe fati i tij ndodhen aksidentalisht në një udhë të ndërlikuar që aspiratat e shoqërisë përfundojnë në tehun e shpatës. Ndonëse kjo vjen e nënkuptuar në roman, gjithsesi është pjesë e leximit të tij. Fajësia kolektive dhe fajësia individuale kanë një shkrirje të logjikshme që më pas rindërtojnë të përgjithshmen kafkjane. Kjo tematikë dhe problematikë

zyrtarësh edhe pse ka një adresim të caktuar në burokracinë shqiptare, në këtë shkrim të përgjithshme humb koloritin nacional dhe përjetohet si histori personale pa kufij shteti.

Dihet që njeriu është një qenie tek i cili esenca paraprihet nga ekzistenca, e cila do të thotë se njeriu është një qenie e lirë, por që në çfarëdo rrethane, dëshiron lirinë e tij. Kështu, në emër të këtij vullneti lirie, i ngërthyer nga vetë liria, unë mund të shqiptoj disa gjykime për ata që përpiqen të fshehin rastësinë totale të ekzistencës së tyre si edhe lirinë e saj të plotë.

“Ata njerëz që do të fshihnin lirinë e tyre totale nën pretekstin e të qenit serioz ose duke përdorur shfajësime deterministe, do t’i quaja të poshtër; të tjerët, që do të përpiqen të tregojnë se ekzistenca e tyre ishte e nevojshme, kur ajo është si rastësia e shfaqjes së njeriut mbi tokë, ata unë do t’i quaja bataçinj. Por, si të poshtrit ashtu dhe bataçinjtë mund të gjykohen vetëm mbi planin e vërtetësisë”, shkruan Jean-Paul Sartre. Personazhet e kësaj vepre janë të vërtetë, edhe ambient zyrtar po aq i vërtetë, madje edhe zhargonit zyrtar është vijimësi e kësaj vërtetësie. Faktorë këta që e bëjnë këtë vepër ndikuese. Në momentin, kur vepra bëhet ndikuese, rritet edhe frika se hiqa e saj mund të përcjellë konotacione rreziku për shumë sozi modelimesh.

Për artin e humorit paraqitja e dy personazheve në bashkëfajësi është një zgjedhje e njohur botërisht. Mjafton të kujtojmë, bie fjala, lidhjet Gargantua dhe Pentagryel të Fransua Rablesë, Don Kishotin dhe Sanço Pançon në veprën e mirënjohur të Miguel Servantesit apo Lakin dhe Pocon e Beketit. Edhe Zyloja me Demkën të tillë janë, një në dy apo dy në një. Edhe pse ndonjëherë dy bashkëpunëtorë janë shumë dhe një është pak. Kështu, ata ushqejnë njëri-tjetrin dhe nuk mund të ndahen. Rritja e tyre në detyrë, përditshmëria në zyrë kanë pothuajse profil të njëjtë. Falë kësaj vepre shumëpopullore tani Zylo pa Demkë dhe Demkë pa Zylo, nuk mund të ketë madje edhe anasjelltas. Skenografia e zyrës së vizatuar në libër, brenda çdo leximi që mund t’i bëhet veprës në shtete të ndryshme është e njëjtë. Fajësia kolektive e përligj mësë miri këtë gjë në hapësirën gjeografike të botuar në Francë, Gjermani, Kinë, Itali, Greqi, Bullagri, Rusi, Maqedoni, Danimarkë etj.

Në rrethin e veprimit individual e shoqëror, njeriu inskenon në vetëdijën e tij, vetveten dhe të huajën, kategoritë estetike, të bukurën dhe të shëmtuarën, por edhe të arritshmen dhe të paarritshmen e tij vetjake. Në këtë lojë meditative, herë reale dhe herë ireale përfytyrime mbështet herë në pamjen e jashtme dhe shumë herë më tepër në të brendshmen e tij. Largimi nga mendimi utopik nuk bëhet përmes njëhjes së vetvetes, por i të tjerëve përmes teje. Ky lloj pasqyrimi në vepër ekziston Në formën e tij më të mirë në këtë roman që mban firmën e Dritëro

Agollit. Ky rreth vicioz mund të përjetohet gjatë leximit koherent si një trekëndësh analitik mes së kaluarës, të sotmes dhe së ardhmes. Takimi me zyrtarë dhe zyra mbetet një fenomen në jetën njerëzore që përmbush mosizolimimin e konceptit burokraci. Një zyrtar i cili endet mes konceptit të së bukurës dhe të shëmtuarës, bëhet pjesë e identifikimit mes së pëlqyerës dhe jo të pëlqyerës performancë të tij. Rreziku më i madh në këtë tejqyrje është se duke parë të përgjithshmen, një ditë do të shohësh edhe veten brenda saj. Vëzhgimi i njëanshëm, gjithmonë përballë vetes, mund të ketë pasoja patologjike, plot elementë narcisizmit. Kjo mënyrë të pari, të sjell vetmi dhe izolim vetjak..., por në kuptimin e zyrtarit Zylo, merr një vlerësim më domethënës, përtej vlerësimit personal. Perspektiva e vetëdijes qëndron në shpresën e zotërimit të vetvetes, në mbyllje dhe hapje, por në të vërtetë ky manovrim i vetëdijes për veten dhe të tjerët shpalos kundrim më të thellë. Në qoftë se shikimi mbyllet në vetvete dhe për veten, na lë të kuptojmë tërësinë e izolimit tonë, nëse bëhemi zëdhënës së vesit, sigurisht që nuk mbetemi në izolim.

Zylo është një aparatçik plot dritë-hije, përderisa ngjitja ka edhe zbritje, ose paralajmës sikundër është kumti që vjen i përgjithësuar mes dy kryefjalëve të titullit të romanit, shkëlqim dhe rënie.

Shaka të këtyre veprimeve mund të jenë anomalitë e shumta vetjake që mbeten të izoluara dhe qesharakja për një takëm të caktuar njerëzor.

Zyloja nuk është i vetëdijshëm për sëmundjen e zyrtarit. Përkundrazi, lexuesi e mbyll librin i bindur se, po të mund të bëhej i ndërgjegjshëm për dobësinë e sistemit koherent, shokut Zylo ndoshta do t'i vinin mendtë dhe do të gjente forcë për vetkorrigjim. Prandaj ai është një figurë fatkeqe, ku bëhen bashkë mirësia e qëllimit me naivitetin, me humbjen e ndjenjës së realitetit, të masës për të vërtetën. Në këtë kuptim, Zyloja i shfaqet lexuesit në një pamje sa të rrezikshme, aq edhe për t'i qarë hallin. Njerëz të tillë asnjëanës në zyrat e burokracisë botërore janë imazhi i shtetit të tyre. Kjo pasqyrë treguese i bën ata hërë të fortë dhe hërë të dobët në trupin e atdheut të tyre. Armiqtë më të rrezikshëm të çdo kohë do t'i quantë Dante Alighieri në paraferrin e tij, ku vuajnë njerëzit më të rrezikshëm të shoqërisë.

Autori i librit e përtall, e satirizon, e vë në pozitë të vështirë personazhin e vet, por edhe i dhimbset, e justifikon, madje, në një farë mënyre, ka raste kur duket qartë se e merr në mbrojtje, duke mos e zhveshur nga çdo vlerë e mirë njerëzore, përballë së keqes që vetë termi zyrtar mbart në vetvete.

Burokratët në përgjithësi janë të çuditshëm, në të shumtën e herës dehen nga një realitet që për syrin e tyre ekziston, kthehen në arratiakë të jetës së vërtetë, megjithatë, herë-herë Zyloja thotë disa të vërteta lakonike dhe të befta, që ai i quan "ese" roman: *“Ese nr. 4, Shpifje do të thotë: peshku i vogël e ha të madhin; Ese nr. 5, Konservator: peshk i konservuar në kuti. Liberal: peshk në det, por që zihet në rrjetë dhe përfundon në kuti konsërve; Ese nr. 7, Burokrat: cjan që ha letër, por që nuk përjashtohet rasti të hajë edhe veshë”*.

“Nostalgjia” e zyrës së dikurshme me atë të sotmen, mbeten një imazh metaforik për ndryshim edhe pse pikat e takimit i kanë lënë në përsëritje teksa mediton për leximin dhe rileximin e romanit të Agollit. Në rrugëtimin tonë zyrtar, në përditshmërinë tonë, përditë takojmë dhe ndeshemi me tipa të tillë kombëtarë dhe ndërkombëtarë. Dualiteti Zylo-Demkë të përzgjon nga gjumi i një mijëvjeçari të ri sërish vicioz. Një gjë mund të thuhet me siguri: ata përsëri janë bashkë. Kanë ekzistuar nga koha e Kafkës, Kamysë, për të vijuar sërishmi rrugëtimin në epokën tonë moderne. Romani frymëzuar nga një muzë universale vesi, zbret në diskursin kritik dhe politik të interpretimit. As shteti, por as individi nuk e dinë tashmë ta përcaktojnë fatin e njëritjetrit se çfarë konkretisht do të duhet të ndodhë nesër për turmën dhe grupe të caktuara njerëzish që përbëjnë imazhin e zyrës dhe zyrtarit të saj.

Ata, individ që kryesisht bëjnë “politikë” kanë përcaktuar vetëm fatet e tyre, por jo dhe fatet e përgjithshme. Këtu është thelbi që i ka errur të gjithë, edhe po të dojë ndokush i vetëm ta ndryshojë, nuk mundet. Sot, shteti zyrtar dhe politika janë larg nocioneve shteti i së drejtës, dhe politikë demokratike që zgjidh nyjet gordiane ekonomike e sociale të qytetarit... Fenomenologjia është studimi i strukturave të përvojës burokratike vicioze, së bashku me kushtet përkatëse të përvojës të termit zyrtar në përgjithësi. Sërish, duke u ndërlidhur me fenomenologjinë dhe funksionimin e shtetit nga politkberja e një grup individësh që njohjet i kanë për përfitim të interesave vetjake, lirshëm mund të vërejmë se qeverisja e tyre me shtetin nuk trajton fenomenet, por çështjet personale. Ndërkohë që flasim për fenomene zyrtarësh në kohë reale, kuptojmë hapur se Zylo dhe Demkat në të gjitha shtetet ballkanike janë ngatërruar në lidhje me inkuadrimin e mirëfilltë shtetëror. Shtetet ballkanike janë pothuaj pranë ngërçit politik, ndërsa zbatueshmëria e plotë e ligjeve vazhdon të prodhojë burokratë pambarimisht; ndërkaq, lajthitjet e ligjeve nga ana e zyrtarit shtetëror përdhos shoqërinë, qytetarin... Për të mbetur sërish skllav të fajësisë kolektive, fenomen refren, denoncuar kohë më parë nga Kafka, Kamyja deri diku edhe Dino Buxati e për t’u përshëndetur te Agolli, si një ves që karrigia ia shton zyrtarit koherent. Romani satirik

“Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo” është udhërrëfyes përtej fenomenit burokrat në realitetin e përbotshëm, sigurisht për ta bërë qytetarin dhe shoqërinë edhe më të mirë.

“Zyrtari i vërtetë, sipas profesionit që ka, nuk duhet të merret aspak me politikë, por duhet të administrojë portofolin e tij, para së gjithash në mënyrë të paanshme. (“Sine ira et studio”, “Pa zemërim dhe entuziazëm”), duhet ta bëjë ai punën e vet. Nderi i zyrtarit është zotësia, kur me gjithë përfytyrimet e tij eprori këmbëngul në një urdhër që atij i duket i gabueshëm, por që ai e kryen me ndërgjegje dhe përpikmëri në përgjegjësinë e urdhërdhënësit, sikur të ishte bindja e tij personale. Pa këtë disiplinë morale dhe vetmohim do të shkatërrohej i gjithë aparati. Natyrat moraliste të zyrtarëve janë të këqija: para së gjithash në kuptimin politik të fjalës të papërgjegjshme dhe në këtë kontekst: janë politikanët moralistë: të atillë që ne për fat të keq i kemi pasur nëpër pozitat udhëheqëse: është pra ajo që ne e quajmë sundimi i zyrtarëve; dhe me të vërtetë nuk bie asnjë njollë në nderin e nëpunësit tonë, kur ne këtë politikisht, parë nga prespektiva e suksesit, i nxjerrim në shesh të metat e këtij sistemi” thotë Max Veber.

Për të gjitha të vërtetat që përcjell, shoky Zylo është prespektiva e një romani satirik jo të izoluar, por të mendjes së hapur dhe vetëkorrigjimit në kohë.

Bibliografi

D. Agolli, *Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo*”, vepra letrare 6, Shtëpia Botuese” Naim Frashëri”, Tiranë 1981, f. 116-117.

M. Veber, *Politika si profesion*, Shtëpia Botuese “Asdreni”, Shkup 2006, f. 38-40; 75-80.

T. Bilton, K. Bonnett, P. Jones, D. Skinner, M. Stanworth, A. Webster, *Introductory sociology*, (Max Veber-Postmodernity: A new phase of capitalism), Macmillan, Press LTD, London 2005, pg. 611-612.

B. Budini, *Dritëroi rrëfen aventurat e Zylos*, Gazeta “Shekulli”, 17 shtator 2000, f. 23.

Dr. ANYLA SARAÇI (MAXHE)

NUANCAT LOKALE PËRMES ANTROPONIMISË NË PROZËN E DRITËRO AGOLLIT

Emri, si dukuri etnokulturore, paraqitet në forma dhe kuetime të llojlojshme duke mbartur në vetvete më shumë se përfaqësimin e një njeriu të veçantë. Siç vë në dukje dhe Mark Krasniqi: “...mund të themi se emrat, deri–diku, luajnë, rolin e dokumenteve historike, në bazë të të cilave mund të konstatohen ecuritë shoqërore e kulture të një vendi”¹².

Siç dihet, historia e emrave të njerëzve është një pjesë e vetë historisë dhe e gjuhës së kombeve që u përkasin. Çdo popull a komb ka historinë e vet, kulturën e vet dhe, për pasojë, ka fondin e vet të emrave vetjakë, që e dallon nga popujt dhe kombet e tjera. Gjithashtu, çdo popull ka në historinë, në kulturën dhe në fondin e vet të veçantë të emrave vetjakë edhe ato elemente shprehëse të përbashkëta me shumë popuj e kombe të tjera, të përfuara si pasojë e bashkëmarrëdhënieve në periudha të ndryshme të historisë. Shtresëzimi kohor dhe përdorimi i emrave vetjakë janë reflekse që shpjegohen përmes kronologjisë së vetë historisë dhe të gjuhës së popullit tonë.¹³ Këtë rol të rëndësishëm luajnë dhe emrat e personazheve të letërsisë.

Në prozën e D. Agollit një pjesë e personazheve janë lehtësisht të identifikueshëm që kur njihesh me emrin e tyre. Larmia e personazheve të tij portretizohet në një masë të madhe nga emrat e tyre.

Nga ana tjetër, pjesa më e madhe e tyre na tingëllojnë çuditshëm, jashtë karakterit dhe temperamentit që shfaqin në marrëdhënie me veten a personazhe të tjerë. “Nëse do të përdornim një emërtim të parapëlqyer të vetë autorit, D. Agolli ka krijuar në prozën e tij kryesisht “njerëz të krisur” në vend të “njeriut ëngjëllor”; njerëz me prirje përparimtare sipas kohës kur jetuan, por njëherësh dhe me mosbindje ndaj skemës: të sunduar nga fryma e mirësisë, por pa “mospërkryerjen e kulluar dogmatike”¹⁴. Kjo vërejtje e hollë e studiuesit Sh.Sinani mëshirohet më së miri në emrat e këtyre njerëzve të krisur si Cute Babulja, Sherif Abeceja, Rrapo Tëbani, Mato Gruda. Përbërja tingullore e emrave dhe trajtat e shkurtuara të tyre paraqiten si tingëllime të

¹² M. Krasniqi, *Gjurmë dhe gjurmime*, Studime etnografike, SHB “8 Nëntori”, 1979, f. 100.

¹³ P. Daka, *Mbi disa veçori të formimit të emrave vetjakë në gjuhën shqipe*, nr. 3, 1970, f. 138.

¹⁴ Sh. Sinani, *Njeriu dhe dukuria atipike në veprën e D. Agollit*, “Për letërsinë shqipe të shekullit të 20-të”, Shtëpia botuese “Naimi”, Tiranë, 2010, f. 271.

një gjuhe të veçantë, të ashpër, që bart mbi vete rrudha, ballë të lartë, mbi fytyra si copa shkëmbinjsh të maleve që rrethojnë fshatrat e tyre.

“Njerëzit e krisur”, këta njerëz që kanë brenda vetes prapësi, trille nga më të çuditshmet, po aq sa dhe vlera cilësore, sipas studiuesit Sh. Sinani janë aq sunduese në në prozën e D. Agollit, saqë mund të mendohet se autori i ka quajtur kështu qëllimisht për t’i mbrojtur nga kritika dhe që lexuesit të jenë të paralajmëruar që të mos i presin ndryshe, brenda kornizës, sepse fundja të tillë janë, të krisur, të pabindur, me kufizime e dobësi.¹⁵ Përfshirja në një e anës së ndritshme dhe asaj të errët, i klasifikon si karaktere ku ndërthuren prirja e pohimit dhe hija e egërsisë.

Po aq interesante janë “njerëzit e zakonshëm” të përfaqësuar përmes zbulime emrash që i përshtaten mjedisit ku jetojnë (qytetit, fshatit, institucionit, shtëpisë) dhe që në tingëllimin antroponimik paraqiten sipas kësaj përkatësie: Zylo e Demkë janë një binom i pandashëm, secili me tepritë dhe frikën e vet, secili me të ngjashmit dhe të vetmit e llojit të tyre. Sot shumë njerëz thirren Zylo e po aq të tjerë Demkë. Po aq lehtë dallohet njeriu i mirë, Telo, njerëz të ligj si Kiço Pela, Petrika Kaleshi, Mitro Karapataqi, të përfaqësuar nga emra tipikë të qytetit të Korçës, që në përfytyrimin njerëzor sjellin ca njerëz të veshur mirë, por çuditërisht me buzë të holla, të cilat i lëpijnë vazhdimisht, që kanë një fytyrë pa ngjyrë e të akullt. E kështu mund të dallohen lehtësisht njerëzit e vegjël meskinë, të përkëdhelur nga fati, ziliqarë për fatin e të tjerëve si Jani, Meropi, Marika, Petrika Kaleshi, Kiço Pela

Në periudha të ndryshme emrat vetjakë japin dëshmi të qarta të jetës ekonomike, shoqërore e kulturore të një vendi të caktuar. Por, më shumë gjurmë kanë lënë në ato shoqëri ku jeta patriarkale ka rrënjësuar thellë në ndërgjegjen e bashkësisë besimin se emri i njeriut nuk e identifikon atë vetëm nga pikëpamja fizike. Në këto shoqëri emri ka përfaqësuar një identitet shpirtëror, që lidhet ngushtë me besimin fetar, me mënyrën e jetesës, me klasën shoqërore, me ndikimin e bestytnive në periudha të caktuara.

Emri, në traditën e popullit tonë, është i lidhur ngushtë me këto dukuri. E. Çabej ka vënë në dukje se: “*Emrat vetjakë, duke përfshirë aty emrat e viseve e të njerëzve, si një pjesë të thuash e pashkruar e leksikut të gjuhës, janë caktuar të zëvendësojnë deri diku dokumentet e shkrimit, që mungojnë kryekrejt për kohën para shekullit XV.*”¹⁶

¹⁵ Po aty.

¹⁶ E. Çabej, *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, I, Tiranë, 1982, f. 43.

Nga kjo pikëpamje emrat e personazheve të D.Agollit përmbajnë një etnografizëm të theksuar. Ky etnografizëm lidhet ngushtë sidomos me traditën fetare të vendosjes së emrit. Shkrimtari njih mjaft mirë traditën bektashiane të vendosjes dhe ripërtëritjes së emrit dhe kjo shprehet mjaft qartë në përshkrimin e ceremonisë së vendosjes së emrit të Xhelo Marës nga babai i teqesë, duke na dhënë në këtë mënyrë të dhëna antropologjike. Mjedisi atipik në romanin “Njeriu me top”, përveç etnografizmit të theksuar, krijohet dhe në mënyrën se si është ndërtuar familja e madhe e Fizëve, në të cilën “babai i madh” ngjan më shumë me një kryegjysh bektashian se sa me një patriark kanuni¹⁷. Më mirë se kushdo e vërtetojnë emrat e vëllezërve Fizi (Fahremudinaliu) apo mënyra se si plaku i Fizëve i identifikon stërnipërit me anë të emrit të tyre vetjak të përforcuar me anë të emrave të baballarëve dhe gjyshërve të tyre. Kjo mënyrë vjen si rrjedhim i lidhjes tipike patriarkale, duke u konkretizuar në formën e një “gjendjeje civile familjare”.

Nga ana tjetër, haku i Mato Grudës lahet duke sjellë në kujtesë emrat e fisit të vvarë, emra që në traditën e përgjithshme shqiptare, të krahinës nga ka ardhur autori ripërtërihen te fëmijët e pasardhësit e brezave të tjerë.

Nga pikëpamja fjalëformuese, pjesa më e madhe e shkurtimeve të emrave vijnë si rrjedhim i shkurtimeve të pjesës së dytë të emrit të plotë, duke i shtuar një prapashtesë me funksion thirrori (Zylo, Xhelo, Lilo, Braho). Shkurtime të tillë emrash, janë tipikë në krahinën e Devollit dhe shqiptimi i tyre karakterizohet nga zgjatja e zanores fundore -o pikërisht për t’i dhënë këtë funksion.

Sigurisht që në të gjithë prozën e Agolli mbizotërojnë zbulimet e emrave me anë të prapashtesave zvogëluese tipike për të folmet lindore të toskërishtes veriore, -*kë* e -*çkë*. Por nuancat kuptimore në zanafillë kanë humbur dhe emrat e personazheve të Agollit me këto prapashtesa kanë fituar nuance tallëse e përçmuese, duke krijuar personazhe në thelb groteskë. Çiftet e personazheve komike në letërsinë botërore janë të njohura, ky komizëm buron dhe nga vendosja e emrave të personazheve. Zylo, si një shkurtime emri të jep përshtypjen e një njeriu që pavarësisht përpjekjeve për modernizim, mbetet i papërshtatshëm me realitetin, nuk i përshtatet veshja, e folura. Në të kundërt Demka, si antroponim i zbuluar me një nga prapashtesat kryesore zvogëluese të Korçës e Devollit mbetet gjithmonë i vogël dhe në hije. Vetë emri i tij, i krijuar

¹⁷ Sh. Sinani, *Njeriu dhe dukuria atipike në veprën e d. Agollit*, “Për letërsinë shqipe të shekullit të 20-të”, Shtëpia botuese “Naimi”, Tiranë, 2010, f. 273.

ndoshta si bashkim elementesh semantike me kuptim të kundërt krijon paradoksin e këtij personazhi. Zbunimi Bamkë, pavarësisht kapadaillëkut dhe egërsisë që shfaq si personazh, bart ngarkesën e frikës para komandatit të tij.

Nga pikëpamja gjinore D Agolli i mbetet besnik krahinës së tij. Personazhet meshkuj identifikohen me emër dhe mbiemër, si përfaqësues të familjes, si njerëz me status më të lartë, më të fortë dhe më me pushtet se gratë (Xhelo Mara, Memo Kovaçi, Rrapo Tëbani, Hodo Allamani, Mato Gruda). Gratë janë ndihmëse, në shërbim të burrave, nënat e fëmijëve dhe kujdestaret e shtëpisë, si rrjedhim ato janë vetëm emra të thjeshtë, shumë herë përfaqësohen si përkatësi e burrit (Shabanicë). Në ndryshim nga pjesa më e madhe e këtyre personazheve, statusi i grave të moshuara, sidomos atyre që kanë kaluar dhe fatkeqësi të rënda, merr një drejtim tjetër. Ato fitojnë një lloj respekti dhe statusin e burrave, si rrjedhim antroponimet e tyre nuk shkurtohen, por respektohen kryesisht nëpërmjet ndajshtimeve fisnore (hallë Esmaja, gjyshe Nafija, nëna Dafina).

Emrat tipikë me prejardhje greke, të përdorur rëndom në qytetin e Korçës, por dhe në krahinat përreth saj si: Kristinë, Anthulla, Meropi, Marika etj., janë personalizuar në personazhe grash me tipare të ashtuquajtura “mikroborgjeze”, si përfaqësuese të rehatisë personale e familjare, i të qenit zbukurim i burrit, “guguftuja” e tij.

Shkrimtari zgjeron gjeografinë e personazheve të tij. Ai i ka shpërndarë anekënd nëpër Shqipëri. Megjithatë, në një masë të madhe ai ruan lidhjet e vendlindjen. Xhelo Mara, i cili nga pikëpamja e anroponimit është shumë i papërcaktueshëm, vjen nga vendlindja dhe ruan lidhjet me anë të Marikës, gruas së tij të bukur.

Tregues i statusit shoqëror dhe ekonomik të idesë së rehatisë, egoizmit, komoditetit, zgjuarësisë përbën dhe përfaqësimi përmes llojshmërisë së patronimisë. Patronimet e personazheve në prozën e Agollit janë mbështetur kryesisht:

- në fjalë të leksikut të përditshëm që përdoret në Devoll që lidhen me emra të përgjithshëm që përfaqësojnë cilësi unike, nofka që lidhen me këto cilësi dhe fjalë të formuara prej tyre me anë prapashtesash (Bregu, Çakërri, Këmbora, Kaleshi, Dynjaja, Çobani, Vorbulla, Avazi, Adashi, Byluku, Pela, Qilimi, Qyllollari);
- në emra që lidhen me toponime (Nemërçka, Borova, Protopapa);
- në emra të pamotivuar nga pikëpamja semantike, por me ngarkesë të dallueshme emocionale (Karapataqi, Babulja, Pinxho).

Në analizën që i bën ligjërimin poetik të D. Agollit, Gj. Shkurtaç thekson se: *“Ai është nga ata që, teorikisht dhe praktikisht, mëton për një gjuhë letrare të njësuar, por kërkon që ajo që të jetë kurdoherë e njomë, e freskët, e re, apo e përtëritur në mënyrë origjinale, e pasur me të gjitha ngjyresat e vlefshme popullore, e pastër, por sigurisht jo “e lëpirë”*.¹⁸

Kjo bën që përkatësia gjeografike e personazheve të tij të jetë e lidhur në radhë të parë me njohjen e nevojës së thellë të mjedisit ku lindin, rriten dhe e kalojnë jetën dhe bashkë me mjedisin, përmes emrave të tyre, të vijnë aromata e veçanta të vendlindjes.

¹⁸ Gj. Shkurtaç, *Dukuri dhe risi të ligjërimin poetik*, Peshë e fjalës shqipe, UFO University press, Tiranë 2009, f. 134.

Msc. NELI NAÇO

REFLEKSIONE MBI VËLLIMIN “PELEGRINI I VONUAR”

“Pelegriini i vonuar” është një nga veprat më të arrira të poezisë shqipe dhe një nga vëllimet poetikë që zhvillon një hap cilësor brenda krijimtarisë së Dritëro Agollit. Vëllimi shënon një pikë strategjike në rivlerësimin e veprës së Agollit sepse shfaq karakteristika të reja që janë produkt i lirisë krijuese, por pa ndryshuar thelbin lirik të krijimtarisë së tij.

I botuar më 1993 vëllimi përbëhet nga tre cikle, shenja të një emocionaliteti ripërtëritës që do të realizojë poeti. Këto tre cikle shenja emërtohen me titujt: *Dhimbjet e karvanit*, *Psherëtimat e vjeshtës* dhe *Tingujt e maleve*. Dy ciklet e para shenjojnë aspekte të dhimbjes e trishtimit të unit poetic, ndërsa cikli i tretë shenjon një lloj zbuluese çliruese për unin. Në pasthënien e vëllimit të titulluar *Urata e vargjeve* poeti pohon: “Boshti rreth të cilit vërtitet materiali i librit “Pelegriini i vonuar” është ai i iluzioneve dhe deziluzioneve, i tragjedisë së një utopie dhe të një ëndrre.”¹⁹ Udha, simboli kryesor i jetës dhe shtegtimit jetësor, është rivlerësuar, nuk është më ajo që të shpie diku drejt finales, por është ajo ku *uni* ngatërrohet dhe humbet duke prodhuar dhimbje. Dhimbja për idealin e vrarë, për iluzionin e humbur, dhimbja që buron prej zhgënjimit, prej mosplotësimit të ëndrrës është burimi kryesor për krijimin e veprës së artit.

Në vargje të tëra ne ndeshim poetin si meditues në brendësinë e së ashtuquajturës “vetmi ekzistenciale”. Pelegriini që ka humbur karvanin është i vetmuar, është i izoluar në një lloj labirinti pa mure, siç e quan Borges-i në një nga prozat e tij; i vetmuari në poezinë *Tryeza rri* i vetëm dhe nuk gjen ngushëllim prej asgjëje; në poezinë *Një shkrepse* kërkohet me ngulm një dritë që të thyejë errësirën, ndërsa tek poezia *Errësira* ankthi e pushton poetin në çdo gjymtyrë e pjesë të trupit.

Poezitë e mësipërme janë rezultat i kondensimit poetik të autorit. Tendencë që nisat dhe shkon drejt krijimit të disa ambienteve, hapësirave dhe vizioneve quasi surreale, por me një poetikë të realizuar gati-gati ekspresioniste. Agolli tregon se aftësitë e tij poetike mund të shkojnë edhe më në skaj të figurativitetit. Në dy poezi shumë të dallueshme të vëllimit ku, nga meditimi shkohet drejt elementëve të dallueshëm grafikë dhe koloristikë, poezia ka shkuar drejt

¹⁹ D. Agolli, *Pelegriini i vonuar*, Qendra botuese ekonomike “Progresi”, Tiranë, 1993, f. 259.

ekspresionit dhe surealizmit të vizionit. E thjeshtë dhe ritmike gjuhësisht poezia është bërë e komplikuar vizualisht dhe më goditëse.

Shumë ujë gri, shumë qiej gri,

Gri në dritare, gri në vetmi,

Ikin lejlekët larg në arrati,

*Shumë ujë gri, shumë qiej gri.*²⁰

Vizualizimi i grisë është thujse verbues. Ndërsa në një poezi tjetër:

Një sy mes fletëve të pemës,

Një sy pas palltos së udhëtarit,

Një sy pas çelësit të derës,

*Një sy në grykën e tymtarit;*²¹

Syri është mjeti kryesor për të shprehur ekspresionin gjuhësor dhe pavarësisht se në numrin njëjës ideja e shumësisë është e riprodhuar plot ekspresion. Këto poezi janë produkt i çasteve të meditimit më të thellë kur mendimi poetik fillon të marrë një forcë sintetizuese dhe një hermetizëm të lehtë, por shumë domethënës. Tek Agolli asnjëherë nuk kemi hermetizëm si një formë që do ta dominojë poezinë e tij. Këto poezi shfaqen si dukuri thujse të natyrshme brenda dhjetëra poezive të tjera që reflektojnë karakteristikat e poezisë më të hershme të Agollit, por edhe risi të pafund brenda stilit të tij.

Në një pohim tjetër mjaft të rëndësishëm dhe zbulues për poezinë e vëllimit “Pelegri i vonuar” ai shprehet: “Pjesa më e madhe e vargjeve të këtij libri nuk është shkruar për qëllime botimi, por për vete. Ato janë bashkëbisedim me një njeri të fshehtë në vetmi, bashkëbisedim me tryezën dhe me muret në netët pa gjumë, kur asnjëri nuk të rri mbi kokë dhe nuk të shqetëson. Nata është për filozofinë dhe poezinë, pasi të fut në mistere dhe ti përpiqesh t’i zbulosh, të shtyn të meditosh për fshehtësitë e jetës dhe të vdekjes, të kërkosh harmoninë e sendeve dhe dukurive.”²²

Ky pohim i vetë poetit se poezia është shkruar për vete është i rëndësishëm për të kuptuar se sa larg është ai nga çdo ideologji, mendim ose ndikim politik. Poezia e vëllimit “Pelegri i vonuar” merr shkas dhe buron nga liria si nënshtresë, si substrat dhe gjenerues i mendimit të pakufizuar. Ajo që është artikuluar për vete, është e lirë nga censura e mendimit politik, nga

²⁰ D. Agolli, *Pelegri i vonuar*, Qendra botuese ekonomike “Progresi”, Tiranë, 1993, f. 11.

²¹ Po aty, f. 143.

²² Po aty, f. 259.

censura e tjetrit apo superegoja po të shpreheshim me gjuhën e Frojd-it, por edhe e lirë nga censura e vetes apo egoja. Liria si nënshtresë është ushqimi më i mirë për poezinë, ajo nuk është t'i këndosh lirisë si në rastin kur nuk e ke, apo si në rastin kur e kërkon lirinë, por poezia është vetë liria.

Prej kësaj lirie poetike në vëllimin “Pelegrini” buron edhe një lloj rihumanizimi reflektiv i poetit. Marrëdhënia mes njeriut dhe Perëndisë është e tillë ajo shpreh një gjendje ekstreme emocionale e përdëllimi. Të dallueshme janë poezitë *Perëndisë*, *Vdiq një njeri i vetmuar*, *Kishat e shembura* etj. Është i rihumanizuar edhe qëndrimi i poetit në poezinë *Kujtime*, ku bindja ose ideali politik i poetit nuk është ai që dominon qenien, por poetizohet paralelisht besimi i gjyshit dhe bindja politike e poetit.

Poezia e “Pelegrinit të vonuar” shfaq refleksione mbi njeriun, ekzistencën, qenien dhe ontologjinë e saj, rikthime në kohë dhe përçapje përpara saj, meditime të çuditshme mbi të shkuarën dhe të ardhmen, një qasje ndaj besimit, pa e kthyer poetin në një besimtar, por më shumë një qenie të përqendruar që hulumton për të dhe më në fund zëri i poetit shfaq urtinë e tij si një zë filozofik që përpiqet të përçojë mesazhin e tij poetik tek të tjerët.

Një zë kryesor në vëllimin “Pelegrini i vonuar” është poezia e shkurtër. Është një poezi që merr shkas nga realiteti, kujtimet a vëzhgimet dhe që në mënyrë të koncentruar është e orientuar drejt një mendimi a përsiatjeje filozofike. Reduktimi i poezisë drejt një meditimi minimalist, vizatimi a përshkrimi me pak fjalë të idesë nuk do të thotë se poezia ka mbaruar bashkë me leximin. Në fund të leximit ka filluar që kjo poezi e shkurtër e minimalizuar të gjenerojë mendim të ri, përsiatje, dhe të ushtrojë presion mbi trurin mendimtar. Është filozofia e urtisë. Shpeshherë kjo poezi ka si burim trishtimin, kujtimin, mendimin për të nesërmen e zyrtë, emocionin që të ngjallin objektet dhe përmes koncentrimin ka fituar magji, thellësi, ekspresivitet. Shorti vetanak i poetit përcillet tek lexuesi me gjithë emocionin e tij. Jo rrallë poezia e Agollit është ironike, një ironi e fshehur ose e hapur, por thellësisht reflektuese dhe ripërtëritëse, tipike e një roli emancipues që thuhet përherë e ka pasur poezia, por që gjithmonë e ka pasur poezia e Agollit.

Ndonjëherë poezia të kujton përroin e mendimeve të lira thjesht rrjedh si një meditim duke krijuar një formë cirkulare as rrethore dhe fundi i saj sikur të le të mendosh që mendimi poetik do të rifillojë të përsëritet nga e para dhe kështu do të rrjedhë përsëri. Endja e mendimit në to përkon me imazhin poetik që krijohet. Do të përmendja këtu poezitë *Dyert*, *Ç'të bësh*, *Pritja e diçkaje*, etj.

Ndonjëherë poezia e “Pelegrinit” të kujton shumë natyrshëm një frazë që është përdorur më së shumti për poezinë e poetit amerikan Robert Frost dhe që është sintagma “simbolizëm i natyrshëm” Një simbolizëm që buron nga natyra ose dukuri natyrore, por që në mendjen e lexuesit mbetet për një kohë të gjatë si një motiv që nuk do të thotë vetëm natyrë, por fsheh një mendim më të thellë. Në poezitë me motiv vjeshtë si Perëndim vjeshte ndihet një lloj i këtij simbolizmi i natyrshëm që sikur do të thotë diçka më tepër.

Marrëdhënia e jetës më vdekjen temë e përjetshme e poezisë, e pandashme, “jetë e vdekje përqaftuar” po të përdorim një sintagmë të Lasgush Poradecit duket se i qëndron për shtat edhe këtij vëllimi. Edhe pse i trajtuar më parë në forma të ndryshme prej Agollit, jeta dhe vdekja brenda vëllimit “Pelegrini i vonuar” krijojnë një dominante të mendimit estetik. Agolli nuk e trajton këtë marrëdhënie si një proces filozofik, por si diçka konkrete e kapshme. Sidoqoftë marrëdhënia e jetës me vdekjen është një marrëdhënie që e shqetëson çdo shpirt poetik, por që e qetëson më pas ideja e mbijetesës përmes krijimit sugjeruar në krijime më të hershme të autorit. Sipas Bashkim Kyçukut, kur flet për një krijim më të hershëm të autorit: “Përjetësia përftohet nëpërmjet “ringjalljes” apo nëpërmjet pavdekësisë, të simbolizuar në trajtën e ngrirë të veprës krijuese, të bëmave historike, të kujtesës e dhimbjes të të gjallëve për të ndjerët”²³ Edhe në poezinë e “Pelegrinit” ky qëndrim, ndonëse nuk është i artikuluar kaq shkoqur, është përsëri i ndjeshëm

Dy ciklet e para poetike të vëllimit “Pelegrini i vonuar” mbyllen me poezi me forcë të madhe jetësore. Cikli i parë përfundon me baladën *Kali* dhe i dyti me poezinë *Trëndafilat e turkeshës*, poezi që sikur tensionojnë konfliktin dramatik jetë - vdekje.

Nga nuancat e forta dramatike të ciklit *Dhimbjet e karvanit*, nga trishtimi që mbulon *Psherëtimat e vjeshtës*, cikli i tretë *Tingujt e maleve*, që përziën krijime të autorit me krijime popullore ku autori ka ndërhyrë minimalisht tendenca e vëllimit shkon drejt qetësisë, ritmet mbizotëruese që mbeten janë ato folklorike duke dëshmuar se poezia kërkon vetvetishëm kthimin në origjinë dhe kjo është edhe qetësimi i poetit. Janë poezi me bazë ritmin muzikor dhe ku motivi është një ripërsëritje ritmike e organizuar me një eufoni të rrjedhshme. Rikthimi i poetit tek poezia popullore e mirëorganizuar sipas tij është krejt qetësues dhe organik.

Me poezinë e vëllimit “Pelegrini i vonuar” fillon një poezi e re e Agollit që do të pasohet edhe në vëllimet “Lypësi i kohës” dhe “Vjen njeriu i çuditshëm” ku koha ka reflektuar tiparet e

²³ B. Kyçuku, Pashënie tek Dritëro Agolli, *Lutjet e kambanës*, Toena, Tiranë, 1998, f 348.

reja të saj. Buzë lunit të kohës të pasqyruar kemi, njëlloj si Herakliti, një Dritëro që është i njëjtë, por edhe nuk është i njëjti me figurën e pasqyruar si thotë një poezi e njohur e Borges.

Literatura:

D. Agolli, *Pelegriini i vonuar*, Qendra botuese ekonomike “Progresi”, Tiranë, 1993.

D. Agolli, *Lutjet e kabanës*, Toena, Tiranë, 1998.

ANDON ANDONI

BALTA E POEZISË SE DRITEROIT, E ËMBËL SI MJALTA E NAIMIT

Në referimin tim, me rastin e tetëdhjetë vjetorit të poetit dhe shkrimtarit Dritëro Agollit, jo pa shkak vendosa të sjell për të pranishmit në këtë ceremoni fort të bukur, një gjë tjetër apo ndryshe nga të pozuarit e gjërave për letërsinë dhe poezinë e Dritëroit, duke u shtyrë më konkretisht në ato marrëdhënie që poeti dhe shkrimtari vendosi me bashkëfshatarët e tij dhe këta të fundit me poetin duke kujtuar reflekset, sjelljet, dukuritë dhe mbivendosjet e tyre tek njëri tjetri për një kohë relativisht të gjatë.

Jo fort akademik, kumtimi ynë do të synojë të hedhë dritë në dy plane kryesore të kësaj marrëdhëniejeje, në atë se sa ajo ndikoi në letërsinë e Dritëroit dhe se si ky komunitet bashkëfshatarësh, e mori dhe mbarti me vet, edhe ndër gjenerata letërsinë e këtij poeti të tokës, siç e ka quajtur kritika, të baltës së Devollit, më së pari duke frymëzuar dhe ushqyer me atë ndjenjë të pangopësisë breza devollinjsh dhe jo vetëm. Kjo marrëdhënie e ndërsjellë me siguri ka lënë gjurmë edhe në formimin e tij letrar dhe padyshim hije në veprën poetike dhe të prozë që nga libri i parë “Në rrugë dola”, 1958 dhe deri tek “Pelegrin i vonuar”. Madje duke lënë gjurmë dhe në formimin e tij edhe jashtë letrat, thënë më ndryshe, duke i vënë mbi shpinë poetit “torbën më baltë” me aq krenari, sedër dhe gaz sa që e mban mrekullisht edhe sot e gjithë ditën në tetëdhjetëvjetorin e tij të lindjes dhe do ta mbajë kështu edhe në njëqindvjetor.

Në tërë këtë vështrim panoramik edhe të këtyre ditëve jetuar me ditëlindjen e tetëdhjetë të Dritëroit dhe e përcjellë prej gjithkujt përmes mediave, televizioneve, konferencave shkencore, deri tek kjo e sotmja me titullin e larte Doctor Honoris Causa të universitetit Fan Noli, takimeve me njerëzit e afërt dhe personalitete e shoqërisë, na vjen në mend një pyetje retorike që bën studiuesit Robert Elsie: “A nuk qënka ngopur lexuesi me Dritëro Agollin? Dhe përgjigjet; “Jo, e vërteta është se lexuesit nuk janë ngopur me Dritëro Agollin, dhe ende presin prej tij. Dritëro Agollit, prozator dhe poet i tokës është një zë i rrallë humanizmi dhe sinqeriteti në letrat shqiptare. Ai është një poet, që ka mundur t’i mbesë besnik vetvetes dhe lexuesit të tij”.

Duke u nisur nga sentence e fundit e Robert Elsie, që t’i mbetesh besnik vetvetes dhe lexuesit tënd duhet me patjetër të kesh një lidhje të fortë shpirtërore me të, kesh qafime dhe tokje duarsh sa më të përditësuar, të kesh frymën bashkuar me ta në gëzime dhe hallë në festa dhe derte. Të kesh me ta bashkuar zërin e arsyes, të kesh me ta të përbashkët këngën dhe vallen.

Dhe të gjitha këto Dritero Agolli i ka mbajtur në afri gjatë gjithë kohërave me njerëzit e tokës së tij, të vendlindjes, të Devollit. Është ky përkushtim dhe angazhim tërësor me vendlindjen, me psikologjinë e trevës, me karakteristikat e veçanta dhe të papërsëritshme që i kanë dhënë kaq shumë origjinalitet krijimtarisë së tij, që i kanë dhënë humanizmin dhe gjerësinë e shpirtit të spikatur të devolliut, ku “nuk ka asnjë rresht që shkrimtari të mos e ketë jetuar vetë”

Kjo afri e ndershmëri duket se është e gjendur në vendlindjen e poetit në Menkulas dhe në fshatrat përreth, në Devollin mbarë. Kjo do të thotë ta shohësh tjetrin ballazi. Do të thotë ta shohësh në sy jetën dhe tokën. Të mësosh prej saj dhe ta latosh atë për ta bërë më të bukur e më të begatë me mjete e tua të punës, me fjalën e hedhur në kartë.

Poezia dhe letërsia e Dritëroit janë ura lidhëse me lexuesin bashkëkohës dhe bashkëfshatar. Kështu sipas Aristotelit poezia është një imitim i natyrës dhe se sipas Horacit, detyra e saj është që të pëlqehet e të japë mësim. Në këtë këndvështrim, marrëdhëniet me botën pra gjenden si në anën e autorit, i cili njihet dhe duhet të njohë realitetet e botës për të mundur që “t’i imitojë ato”, ashtu dhe në anën e lexuesve dhe të auditorëve që do të mundën sigurisht të të gjejnë kënaqësi aty, por prej nga edhe nxjerrin mësim.

Kjo kënaqësi është e lidhur më së pari me vete ndjesitë e një grupi të madh perceptimesh, shqisore dhe ndjesore, që lexuesi bashkëqytetas gjen tek krijimi.

Në mënyrë fare të natyrshme, udha, bregu, selishta, shelgu dhe zogjtë janë të identifikuar me ato të vete lexuesit në vendlindje Devoll. Imazhi i këtij lexuesi, madje edhe i atij të ndodhur në hulline e pritjes, kalon natyrshëm prej leximit tek realitete pozante të tyre, në fshat, në arën ku ka mbjelle dhe korrur, në udhën ku shkel çdo ditë dhe i flladitur nga era e tij, cangonjarka sa letrare aq dhe si materie.

Lexues te tillë që nga xha, Rizai, i ati e deri tek më të rinjtë si Sami Begolli, Destani Danglli, Ideali Kadia, Avniu, Bardhylli dhe shumë të tjerë, bënë të mundur që të lartojnë krenarisht letërsinë dhe emrin e poetit ndër kohëra. Jo vetëm se ia u diktonte krijimi si i tillë, por se edhe kontaktet me vete poetin ishin të përhershme dhe të shpeshta me njerëzit e vendlindjes. Takime jashtë të gjitha protokolleve dhe ceremonive zyrtare. Të thjeshta dhe të drejtpërdrejta.

Kujtoj një rast të kahershëm, kur poeti i ndodhur në vendlindje, Menkulas, dhe tek po gatitej të nisej për në kryeqytet, i afrohet një fshatar nga Dobranji, dhe i kërkon ta marrë në makinë. Dhe ...në vendin e parë të veturës së Lidhjes me shofer Spiron, ulet Bajrami.

Këto janë detaje që flasin për një ulje këmbëkryq të poetit me njerëzit e tokës dhe të mallit. Vetë antropologjia e personazheve të prozës dhe protagonistëve të poezisë të bën të besosh se devollinjtë janë të kudondodhur dhe të shkrirë në një, në krijimet e Agollit. Ata devollin për të cilët ai ka folur jo vetëm përmes poezisë me një konsiderate dhe respekt të përkorë. Njerëz që punojnë shumë, që hanë shumë dhe që kanë këmbën e madhe.

Por këto raporte të mirë vendosura mes tij dhe bashkëfshatarëve, nuk mund të konceptohen pa një frymë të përhershme, prej vëzhguesish të hollë poetik, nisur që nga fëmijëria. Në një nga intervistat e tij fare pak të njohura, për vetë faktin se u botua në një organ modest shtypi, në maj të 2003 do të shkruante: “Edhe në krijimtarinë time vitet e fëmijërisë kanë ndikuar shumë. Mbresat, kujtimet e ngjarjeve, sjellja ndërmend e peizazheve dhe në përgjithësi e natyrës, asnjë lexim libri nuk mi ka zëvendësuar. Fëmijëria ime ka rrjedhur në fshat. Çdo pëllëmbë toke e fshatit, e çdo metër e rrugicave dhe e mureve të shtëpive, më vijnë në mend edhe sot që jam shtatëdhjet vjeç. Unë i njihja shtëpitë e fshatit edhe pas erës që mbanin odat dhe ashefët. Për shembull shtëpitë e mëhallës së prindërve të mi, vinin erë të pjekur në qebap, në lagjen fqinjë ishte shtëpia e xha Batos, që vinte erë qepë dhe raki kumbllë. Të gjithë njerëzit vini erë qepë, edhe xha Batoja me gruan dhe nënë e tij gjyshe Xhikon. Po unë i dalloja shtëpitë e fshatit edhe nga zakonet, nga veset, huqet dhe këngët”. Të gjitha këto për një njeri të zakonshëm duken si gjëra të vogla dhe pa peshë, por për një shkrimtar janë shumë të rëndësishme. Pa këto ndjesi dhe elemente të mëvonshme nuk ka arkitekturë veprë.”

Këto pohime të vetë shkrimtarit janë një dëshmi e gjallë të atyre marrëdhënieve që kanë ekzistuar përherë mes tij dhe njerëzve të vendlindjes. Mes mjediseve të kësaj vendlindjeje dhe poezisë dhe letërsisë së krijuar në këto më shumë se gjysmëshekulli.

Kurrë nuk mund të jesh i madh në art po nuk solle ato çka ke përjetuar me gjithë thellësinë e karakteristikave të shpirtit.

Diku poeti shprehet se unë kam model Naimin. Ai është për mua më i njerëzishmi nga gjithë njerëzit dhe me shpirt poetik nga gjithë shpirtrat e poetëve. Ky njeri më ka ndjekur që nga fëmijëria dhe deri më sot.

Dhe në paradigmë të të gjithë jetës dhe veprës së të dyve, qëndron padyshim më e bukura, më e shtrenjta, toka, balta, tek arti i Naimi më e ëmbël se mjalta, tek poezia e Dritëroit e rëndë, e ëmbël dhe e florinjtë.

ILIR SHYTA

...EDHE QENTË ENDACAKË JANË TË LIRË, PO KUR BASHKOHEN KAFSHOJNË NJËRI-TJETRIN!

Intervistë me shkrimtarin Dritëro Agolli

Si po kaloni në Pogradec?

Shumë mirë! Unë e dua shumë Pogradecin! Pogradeci bashkë me liqenin e tij është një nga mrekullitë e vendit tonë, ku njerëzit gjejnë një prehje të plotë, jo vetëm inaktive, prehje vetëm për t'u shlodhur, por edhe një prehje tjetër që aktivizon imagjinatën, frymëzimin, aktivizon një dashuri të pakufishme, për vendin, për njerëzit, për vetë jetën, madje për të ardhmen. Është një vend me ujë, me lule, me zogj, që siç thosh Lasgush Poradeci, veçanërisht kur vjen mbrëmja...

(reciton vargje të Lasgushit)

...Në katund kërcet një portë, në liqer hesht një lopatë

Një shqiponjë e arratisur fluturon në Mal të Thatë

Futet zemra djalosshare mun në fund të shpirtit t'im...

Tërë fisi, tërë jeta, ra u dergj e zuri gjumi

Zotëroj më katër anë errësira

Po tashi?

Duke nisur udhëtimin mes për mes nër Shqipëri

Drini plak e i përrallshëm, po mburon prej Shëndaumi.

Z. Agolli, me sa di unë, ju nuk i jeni ndarë Pogradecit. Keni kaluar muajin e mjaltit këtu me bashkëshorten tuaj Sadien, ndërsa sërish në moshë të thyer, ju jeni i pranguar nga Pogradeci?

Po këtu, 41 vjet më parë, kur jam martuar, kam ardhur këtu dhe kam bërë siç i thonë muajin e mjaltit. Tashi mua me duket një kohë e largët, por dhe e afërt. Atëherë unë isha i ri (kur je i ri, të duket si një gjë krejt e zakonshme), një diçka që gjithnjë e ke me vete, edhe kur të shkosh diku të duket sikur e mban në xhep këtë gjë, por kur kalon koha, si tashi që unë jam 75 vjet, të hip një mall i madh që atëherë dhe thërret ky vend. O njeri që ke kaluar këtë kohë të rinisë, hajde dhe një herë tjetër këtu. Dhe unë disa herë kam ardhur për të pushuar, tre-katër vjet me radhë. Por ka edhe diçka tjetër më të largët akoma. Unë kam qenë këtu më 1946. Mësoja në shkollën unike të

Bilishtit. Shkollë qytetare ishte dhe kisha një shok të ngushtë këtu Niko Nikollën. Tani ai ka vdekur. Mund të them që ishte shoku im më i ngushtë, por edhe një nga njerëzit që nuk jam shkëputur gjithë jetën. Unë kam pasur edhe shokë të tjerë, por disa janë larguar për arsye të ndryshme, por me Niko Nikollën kam qenë shok deri sa vdiq.

Në '46-ën erdhëm ne nga shkolla e Bilishtit, këtu në shkollën e Pogradecit. U takuam, u miqësuam dhe që atëherë mbetëm shokë të ngushtë. U lamë edhe në liqen.

Kështu me Pogradecin, kam një lidhje të drejtpërdrejtë, kurse në lexime jam njohur ndofta kohë më parë kur isha ne fshatin Menkulas, nxënës shkolle. Mua më pëlqente Lasgushi, më pëlqente shumë Mitrush Kuteli. Madje po të tregoj një gjë, që do të duket çudi. Unë një libër të Mitrush Kutelit "Ago Jakupi" e kam blerë në Bilisht. Librin e kishte një njeri. Atëherë nuk kishte shumë lekë, në vitet '44-'45 edhe munda të gjeja një mënyrë për ta blerë. Më dha im atë një torbë me fasule dhe e kam blerë librin kështu me fasule. Domethënë ishte si një gjellë. Pra lidhjet e mia janë të hershme me Pogradecin. Unë atë kohë i mësoja përmendësh vjershat e Lasgushit si fjala vjen "Ikja e shtërgut".

(reciton përsëri vargje të Lasgushit)

...fluturoi dhe shtërgu i fundit

Madhështor me shpirt të gjorë...

E bukur shumë. Kështu jam i lidhur shumë me Pogradecin. Këto 3-4 vjetët e fundit të pleqërisë kam ardhur këtu, kam takuar edhe shokë plot, jo vetëm të mitë, por edhe të gruas sime, Sadijes. Ajo ka pasur këtu shumë shoqe si Vaskë Burnazin, Meri Lalajin, Tuke Minarollin...

Ju pak më parë thatë se Pogradeci është okazion frymëzimi? Keni hedhur ndonjë varg në letër këto kohë në Pogradec, ose ndonjë rresht në prozën tuaj gjigande...?

Kam shkruar një vjershë, që tani se mbaj mend t'ua them. Me tepër mbaj mend poezitë e të tjerëve se sa të miat. Shkruaj për këtë liqen duke e marrë si personazh dhe Lasgush Pogradecin dhe të tjerë, si njerëz që kërkojnë të bukurën në këtë liqen, prej të cilit dalin edhe legjendat. Më duket e kam botuar në librin tim "Gëdhin dhe ngriset". Është një vjershë e gjatë për këtë.

Kam shkruar më parë për Mokrën, për Maro Potkozhanin, për Meken, për Muharrem dhe Rreshit Çollakun...

Edhe tani kam diçka në dorë në lëmin e poezisë, sepse Pogradeci është një vend që të frymëzon, që të jep mundësi të madhe dhe të ngacmon trurin...

Në fakt një gjë më nevrikos, kur vijnë këtu shpesh njerëz, qoftë gazetarë, njerëz të politikës, apo të shoqërisë. Menjëherë vënë re e thonë që atje panë ca plehra, panë ca ndotësira. Nuk shohin fjala vjen në paln të parë këto bukurira... Është njëlloj si i jep një njeriu të lexojë një tregim që i pëlqen dhe të thotë, po këtë presje nuk e ke vënë mirë, domethënë nuk shikon të përgjithshmen, të bukurën. Unë e kuptoj që ka edhe plot mangësira... Po kjo është në të gjithë jetën tonë. Unë në radhë të parë shikoj bukurinë e këtij liqeni, nuk shoh papastërtirat. Kur merret gjithë shtypi do të thonë, ç'të vëmë atje? Para katër ditëve isha me një gazetar nga Danimarka. Ishte një miku im i vjetër. Kish ardhur te ne, në Pogradec. Më mori një intervistë për Pogradecin, vendin dhe problemet politike. Ai erdhi të rrinte për pak këtu s'e do të shkonte në Berat, por i pëlqeu aq shumë sa fjeti këtu. E qirasa edhe me raki e verë buti.

(Ishte me të shoqen).

E pyeta, -Si të duket këtu?

Edhe im shoq mos rrinte, -më tha ajo, unë do të rrija vetëm dhe do e dërgoja atë në Berat.

Domethënë e kam fjalën që Pogradeci është një vend i bukur, është mëkat që t'i bëjmë me zor disa njolla. Sot në mëngjes unë preva pak veshin këtu. Kush e di si e preva, po më doli edhe pak gjak duke u ruar. Ndofta mu drodh dora dhe i thashë Sadies, mos e kam gabim që kam prerë veshin. Ndoshta s'është gjak. Mos është vera e Ciles që po del nga veshi?

Jo, është gjak, tha ajo.

Jo moj i thashë është vera e Ciles, se çdo ajo makina që ruhem, të vejë te veshi...

Pra, e kam fjalën është një bukuri e madhe këtu dhe të mos themi gjëra që janë tepër të vogla.

Z. Agolli si e keni njohur zonjën tuaj, që mbani në krah prej 41-vjetësh?

Po Sadija ka qenë shumë e bukur atëherë, edhe tani është shumë simpatike nga kjo anë. (Sadija qesh)

Kjo, ishte studente dhe unë gazetar, si ju tani në televizion. Isha i ri dhe punoja te gazeta "Zëri i Popullit". Vija në universitet bashkë me një shok dhe bënim biseda për letërsinë dhe recitonim vjersha. Në atë kohë, në vitet '63-'64-'65-së këto bënim mbrëmje në universitet, siç bënim ne atje në Rusi, sepse unë kam mbaruar studimet në Petërburg. Dhe unë kërceja, loja me Sadien. Nuk kërceja mirë. Ndërsa i shkelja shumë herë këmbën Sadijes, i thoja më fal.

Kjo më thonte (drejtohet nga Sadija), mos më shkelësh ndonjë gjë tjetër, po këmbën mirë. Dhe qeshnim të dy. Kështu lindi njohja jonë, pastaj u dashuruam dhe kemi mbetur të dashuruar edhe

tani. Sadija më pëlqente shumë edhe pse e kisha hundën e madhe. Ziheshim ndonjëherë shumë pak.

Z. Agolli, vitet '90 e këtej i keni etiketuar “shkërdhatokraci”. I mbeteni sërish këtij mendimi?

Ka periudha të ndryshme. Një periudhë mund të jetë siç e kam thenë unë përpara, një tjetër jo. Nga 91-shi e deri tani kemi një ashpërsim të madh të luftës politike. Asnjëra forcë nuk gjen një pikë të përbashkët. Të gjitha janë në ekstrem të tyre. Edhe një gjë që është e vlefshme për një forcë politike reale, tjetra (forca politike) nuk e pranon. Fjala vjen janë bërë rrugë, autostrada..., në këto tetë vjet, por forca tjetër s'i pranon. S'është bërë gjë thotë. Fjala vjen në '92-'93-shin, kohë kur bë ndryshimi politik, forca tjetër që është sot në opozitë, nuk i pranoi ndryshimet e bëra. U dhanë shtëpitë, apartamentet, u bë privatizimi... Kjo meritë nuk i jepet PD-së...

Ose liria e mediave. E kam fjalën që ndryshe duhet ta mendojmë këtë gjë dhe ndryshe duhet të luftojnë këto forca politike. Ato duhet të mendojnë me alternativa. Cila është më e mira për ta çuar vendin përpara... dhe të mos i përvetësojnë gjërat dhe të thonë: Atë që e bëj unë, nuk e bën dot ti. Ne bëjmë kaq dhe ti ke bërë kaq...

Ky mbetet një nga problemet tona më të mëdha të pluralizmit. Ende nuk e kemi kulturën e demokracisë. Kulturën që të jemi edhe tolerantë, edhe xhentilë, sidomos kur ndërrojmë qeveritë. Të shkojë tjetri dhe t'i japë dorën, bravo të qoftë, tani ti fitove. Jemi si kalorësit e 500-600 vjetëve të mesjetës, që edhe bënin duel, edhe i jepnin dorën njëri-tjetrit.

A mendoni se duhet të ndryshojnë figurat e politikës. Në këto vjet ato si sollën asgjë të re këtij vendi?

Kjo varet edhe nga shoqëria jonë, nga pjekuria e saj. Ajo e ka në dorë përderisa votohet një personalitet politik. Atij s'ke si t'i thuash demode. Duhet të edukohet gjithë shoqëria që të arrihet kjo. Me një fjalë duhet të arrijmë në kuptimin që politika të mos jetë organizim i urrejtjes, por organizimi i dashurisë së njerëzve me njëri-tjetrin. Kurse ne po vazhdojmë që politikën ta kemi organizim të urrejtjes. Nga kjo duhet të heqim dorë.

Etika e ngjarjeve të fundit në parlament, si u përtyp në mendjen tuaj?

Shiko si është puna? Po ta kini vënë re në parlament opozita është vënë në tabelën e qitjes, në poligon. Ju jeni të poshtër, ju jeni të korruptuar, të atillë, të këtillë...

Maxhoranca e ka vetëm tabelë qitjeje. Bam-bam, apo jo? Dhe këta ç'bënë një ditë... U inatosën dhe u hodhën mbi këta që qëllonin. Faji i kujt mbetet?

Mua s'më pëlqen të bëhet kështu, por them shkaqet janë të zakonshme, domethënë duhet që dy forca të mos arrijnë gjer këtu. Maxhoranca është si plaku i shtëpisë, duhet t'i këshillojë të vegjlit, kurse kjo s'e luan këtë gjë dhe ndodhin pastaj ato që ndodhin. Kur ndodh kështu nuk është vetëm faji i njerit, është edhe i të tjerëve. Fjala vjen, themi liri-demokraci, por liria ka edhe një kuptim tjetër. Edhe qentë endacakë janë të lirë, po kur bashkohen kafshojnë njëri-tjetrin. Ndaj duhet ta mendojmë mirë edhe lirinë.

Z. Agolli, ju e takoni ende kryeministrin aktual Berisha?

E takoj. E kam takuar para dy-tre muajve. Këtë e bëj me sinqeritet, nuk ju vë rëndësi dasive politike. Shikoj njohjen, miqësinë. Nuk jam inatçor, që të them meqë më kritikoi një njeri dhe tani s'duhet t'i flas unë. Nuk kam të tillë paragjykim.

Në kaç muaj qeverisjeje të PD-së, çfarë note do t'i vinit kryeministrit?

Ky është një problem i vështirë. Berisha duhet të punojë më ndryshe, Jo kështu. Kryeministri ka rolin e tij dhe s'duhet të merret me gjëra si një gjyqtar, një prokuror, si një njeri që është përherë në opozitë..., për shembull këtu t'i kam dosjet, këtu të bëj hatanë... Kryeministri është i të gjithë shqiptarëve. I thotë fjala vjen kryetarit, Edi Ramës gojëprishur. Duhet të ndryshojë. Gjithë premtimet duhet t'i bëjë tamam, ose më mirë mos premtu. Gjithmonë duhet të jemi të matur në premtime, sepse nuk e ke pronën tënde dhe të thuash do të jap kaç, po premtove duhet të mendohesh mirë. Fjala vjen thotë në Durrës, do të ndërtoj një impiant të madh për çkripëzimin e detit. Kjo s'është bërë as në Japoni, as në Amerikë, domethënë fantashkencë apo jo. Pra, bëj premtime por, mos u jep një publicitet kaç të madh atyre. Çdo mbledhje e qeverisë bëhet me gjyq publik. Ti bëje dhe mos u fry. Është njëlloj siç ha bukë... O vëllezër unë po ha bukë! Ha bukë dhe mos bëj fjalë...

Ju Pogradecin e merrni me vete, ndoshta të shishja e rakisë që ju japin miqtë?

Unë i marr me vete gjithmonë ato që më japin. Më pëlqen shumë edhe vera e butit, edhe rakia e Pogradecin, veçanërisht perla dhe muskati janë gjërat më të bukura për dollira, për shëndete, që të kërkosh shëndetin e tjetrit apo jo...

Unë kam qenë në Itali për të kuruar një sëmundje të mushkërive dhe kur ika mora ca raki, dhe verë për t'ia dhënë doktorit që më kuroi (italian ky shumë i zoti, kishte mbaruar studimet në Amerikë). Një moment i thashë pak i ndrojtur... Vallë do t'i pranonte mendova... të kam sjellë ca verë dhe pak raki...

-A i pranoni këto që po ju sjell, se mos quhet korrupsion?

Ai më tha, po të kesh edhe ndonjë gjë tjetër ma jep. Dhe unë pogradecarëve ju them, po të keni edhe ndonjë gjë tjetër ma jepni. Domethënë në kuptimin e miqësisë, kjo. Edhe mjeku italian kishte sa të deshte, po për humanizëm dhe miqësi tha atë që tha...

Kështu meqë i kam miq të mirë pogradecarët, unë do rri edhe ca këtu, deri në fund të gushtit.

Faleminderit!

(Gusht, 2008)

**Kjo interviste është marrë për televizionin SOT7*